



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 28 TETOR DHE 17 NËNTOR 2016**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 28. OKTOBRA I 17. NOVEMBRA 2016. GODINE**

**TETOR/NËNTOR - OKTOBAR/NOVEMBAR
2016**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
4. Propozim-Deklarata e Kuvendit të Republikës së Kosovës adresuar Unionit Evropian për liberalizimin e vizave,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për procedurën përmbartimore,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-119 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-043 për faljen e borxheve publike,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-110 për kamatë-vonesat në transaksionet tregtare,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-024 për Shërbimin Mjekësor Emergjent,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-066 për profesionet e rregulluara në Republikën e Kosovës,
10. Emërimi i anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave,
11. Zgjedhja e 1 (një) anëtari të Këshillit Prokurorial të Kosovës,
12. Zgjedhja e kryesuesit të Komisionit Shqyrtues në Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit,
13. Zgjedhja e zëvendës drejtorit të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit (votim i fshehtë),
14. Zgjedhja e 1 (një) anëtari të Bordit të Komisionit të Pavarur për Medie,
15. Formimi i Komisionit ad hoc për për zgjedhjen e 1 (një) anëtari në Bordin e Ankesave të Komisionit të Pavarur për Medie,
16. Formimi i Komisionit Hetimor Parlamentar, sipas kërkesës së deputetes Shqipe Pantina, mbështetur edhe nga 8 (tetë) deputetë të tjerë nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” lidhur me Radiotelevizionin e Kosovës,
17. Debati parlamentar sipas kërkesës së deputetes Margarita Kadriu-Ukelli, mbështetur edhe nga 9 (nëntë) deputet tjerë nënshkrues lidhur me detyrimet e mundshme financiare të Kosovës për pretendimet e kompanive që kanë ushtruar padi në Gjykatën Ndërkombëtare të Arbitrazhit.

Dnevni red

1. Vreme za izjave van dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Predlog-Deklaracije Skupštine Republike Kosova adresovana Evropskoj uniji o liberalizaciji viza,
5. Prvo razmatranje N/zakona br. 05/L-118 o izmenama i dopunama Zakona br. 04/L-139 o izvršnom postupku,
6. Prvo razmatranje N/zakona br. 05/L-119 o izmenama i dopunama Zakona br. 05/L-043 o otpisu javnih dugova,
7. Drugo razmatranje N/zakona br. 05/L-110 o zateznim kamatama u trgovačkim transakcijama,
8. Drugo razmatranje N/zakona br. 05/L-024 o emergentnoj medicinskoj službi,
9. Drugo razmatranje N/zakona br. 05/L-066 o regulisanim profesijama u Republici Kosova,
10. Imenovanje članova borda Regulativnog autoriteta za železnice,
11. Izbor 1 (jednog) člana Tužilačkog saveta Kosova,
12. Izbor predsedavajućeg Komisije za razmatranje u Regulatornom autoritetu za usluge vode,
13. Izbor zamenika direktora Regulatornog autoriteta za usluge vode,
14. Izbor jednog (1) člana borda Nezavisne komisije za medije,
15. Osnivanje ad-hoc komisije za izbor jednog (1) člana u bordu za žalbe Nezavisne komisije za medije,
16. Osnivanje Ad hoc parlamentarne komisije, prema zahtevu poslanice Shqipe Pantina, podržan od osam (8) ostalih poslanika PG Pokerta Vetëvendosje, u vezi Radio televizije Kosova,
17. Parlamentarna rasprava prema zahtevu poslanice Margarita Kadriu-Ukelli, podržan i od 9 (devet) ostalih poslanika potpisnika, u vezi mogućih finansijskih obavezivanjima Kosova, prema zahtevu kompanija koje su podnele žalbu pri Međunarodnom sudu arbitraže.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 24 tetor 2016.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri 30 minuta, diskutimi në emër të grupit parlamentar zgjat deri në pesë minuta, ndërsa diskutimi i deputetit deri në tre minuta.

Deputetët e paraqitur për diskutim duhet të deklarohen se në çfarë cilësie e kërkojnë fjalën. Selviqe Halimi e ka fjalën.

SELVIQE HALIMI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ministra,

Unë sot e ngre një çështje që ka të bëjë me Ministrinë e Drejtësisë, përkatësisht Qeverinë e Kosovës.

Sipas informacioneve nga ministrja e Drejtësisë, është duke u bërë plotësim-ndryshimi i pakos së ligjeve të sistemit të drejtësisë. Në kuadër të kësaj është duke u bërë edhe plotësim-ndryshimi i Ligjit për sanksionet penale.

Unë kërkoj që në kuadër të këtij plotësim-ndryshimi të bëhet harmonizimi i vuajtjes së dënimit për veprat penale me standardet e BE-së dhe dita për vuajtjen e dënimit të përllogaritet jo siç është tash, por konform standardeve të BE-së që lëviz: një ditë përllogaritet me 1,33 deri në 1,5, që do të thotë se 24-orëshi në dënim duhet të llogaritet plus 1 plus 1/3, apo plus 1 plus 1,5.

Po që se Ministria e Drejtësisë nuk e merr për bazë këtë - të bëjë harmonizimin e Ligjit për sanksionet penale me standarde të BE-së, na mbetet neve si deputetë që me iniciativë ta bëjmë harmonizimin e këtij ligji.

Nuk ka justifikim nga Qeveria, përkatësisht Ministria për mosharmonizim, sepse jemi në fazën kur kërkohet plotësim-ndryshimi i ligjeve dhe harmonizimi me standardet e BE-së dhe harmonizimi i ligjeve duhet të bëhet edhe atëherë kur u shkon për shtati të dënuarve për vepra penale, sepse kështu vepron e gjithë bota demokratike. Faleminderit!

KRYETARI: Regjia, Doruntina Maloku e ka fjalën.

DORUNTINË MALOKU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Përfaqësues të medieve,

Shumë pak prej nesh, megjithëse jetojmë në këtë vend kaq të vogël, do të merrnim vesh për korrupsionin, krimin dhe për gjithë atë që ndodh jashtë shtëpive tona, e që më pas t'u kërkonim llogari institucioneve relevante pa informacione që i plasojnë mediet.

Të gjithë ne kemi nevojë për lajme të shpejta, të sakta, të pavarura dhe të besueshme. Por, krejt këto janë të pamundshme pa lirinë e medias.

Megjithatë, mediet dhe gazetarët në Kosovë, në veçanti ata hulumtues, shpeshherë vazhdojnë të kërcënohen, të shantazhohen apo të jenë pre e censurës së drejtpërdrejtë, apo të tërthortë.

Ende ka përpjekje të vazhdueshme nga grupet të ndryshme të interesit, apo grupe mafioze që gazetarëve, sidomos atyre hulumtues që t'u mbyllet goja për shkak se ata prezantojnë apo denoncojnë nënshkrimet apo emisionet e tyre, aferat e ndryshme korruptive, apo dukuri që grupeve të ndryshme nuk u shkojnë përshtati.

Gazetarët në Kosovës, pavarësisht se të gjithë ne pretendojmë që jetojmë në një shtet ligjor, vazhdojnë të ankohen për presionin që u bëhet në rastet kur ata publikojnë të dhëna që prekin interesat individuale, apo të grupeve të caktuara.

Si fëmija i një gazetari të vrarë dhe si një gazetarë që kam shërbyer më se 12 vjet në një medium në Kosovë, u bëj thirrje të gjitha institucioneve relevante që t'u qëndrojnë në krahë gazetarëve, xhiruesve, fotoreporterëve, autorëve të emisioneve dhe dokumentarëve, të cilët shpeshherë ndodhen para presionit për shkak se përpiqen të publikojnë fakte të vërteta, intervista dhe pamje, që shpeshherë jo të gjithëve na pëlqejnë.

E inkurajoj Prokurorinë e Shtetit që me rastet e kërcënimit të gazetarëve të merret me prioritet të lartë, si dhe ta informojë publikun për hapat e ndërmarrë, sepse ngufatja e lirisë së shprehjes dhe medias është ngufatje e demokracisë edhe ashtu të brishtë në Kosovë. Edhe ata që kanë dhënë shumë për lirinë e këtij vendi duhet ta dinë se gazetarët e ushtrojnë një liri themelore, që është pjesë e Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, e që thotë: "Cilido e ka të drejtën ndaj lirisë së mendimit dhe shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë për të pasur mendime pa ndërhyrje prej ndokujt, si dhe për të kërkuar, marrë dhe përcjellë informacion dhe ide nëpërmjet çfarëdolloj medie dhe pavarësisht prej kufijve". Faleminderit!

KRYETARI: Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Qytetarë shumë të respektuar të Republikës së Kosovës,

Kjo që ndodhi në përfundim të seancës që filloi dje është e papranueshme dhe e patolerueshme. Pra, këto standarde të dyfishta që i përdor Kadri Veseli, në raport me deputetët edhe varësisht preferencave të tij për tekstet që kërkohen të votohen, janë asgjë tjetër, përveç se në njërën anë shkelje e të drejtave bazike të deputetëve, por në anën tjetër, për rastin konkret, edhe frikë absolute që ai ka.

Sepse, rezoluta që u propozua nga Lëvizja “Vetëvendosje”, e që besa pikat e saj janë propozuar dje edhe këtu në seancë, por edhe në grupin punues për hartimin e rezolutës, nuk është asgjë e re për deputetët e këtij Kuvendit të Republikës së Kosovës, ose thënë më saktë nuk është aspak më e re se rezoluta që u votua, sepse edhe kjo rezoluta që u votua është shkruar mbrëmë. Nuk është që është propozuar kur është kërkuar seanca e jashtëzakonshme dhe në këtë drejtim, pra Kadri Veseli qartë u frikësua që ta votojë këtë rezolutë, sepse janë këtu disa ndërkombëtarë që shikojnë dhe natyrisht ky para ndërkombëtarëve e ndërron mendjen në moment.

Është e pavërtetët ajo që u tha këtu që me këtë rezolutë po duam ta ndërrojmë Kushtetutën. Kjo rezolutë pati për qëllim që ta shprehë vullnetin e Kuvendit për ndryshim të Kushtetutës, e jo ta zëvendësojë procedurën për ndryshim të Kushtetutës. Procedura për ndryshim të Kushtetutës është e qartë, është e shkruar e zeza në të bardhë. Mirëpo, Kuvendi mund ta shprehë vullnetin nëse janë deputetët dakord me votë që po duhet të ndryshohet Kushtetuta e Republikës së Kosovës, që në këtë të futet Ushtria Çlirimtare e Kosovës si vlerë dhe si histori. Po, Kadri Veseli tha jo nuk bën kjo të futet në Kushtetutë, edhe pse një numër i deputetëve e shprehën qëndrimin që janë dakord ta bëjnë një gjë të tillë, pra jo ta bëjmë në seancën e sotme, por që sot ta shprehim vullnetin për një gjë të tillë.

Po, natyrisht çka të presim prej këtij njeriu? Ju e patë mbrëmë. Ajo që bëri ky mbrëmë duke e keqpërdorur foltoren e kryetarit të Kuvendit është skandaloze. Mbrëmë Kadri Veseli u kërcënua publikisht, i kërcënoi deputetët e Lëvizjes “Vetëvendosje” publikisht me jetë. Kush e ka dëgjuar me vëmendje, kjo ndodhi mbrëmë. Tha “ishalla nuk vetëvriteni”. Çka i bie kjo?

Ju kujtohet në muajt tetor, nëntor, e dhjetor veçanërisht të vitit të kaluar, kur thoshte që ju po e përjashtoni veten nga seancat dhe pastaj pas këtij “vetëpërjashtimi” të proklamuar nga Kadri Veseli, e thirri Policinë dhe na nxorën nga salla e Kuvendit me dhunë, apo jo, sigurimi i Kuvendit. Tash, kjo vetëvrasja që e tha mbrëmë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Vetëm pak! Regjia, se më mbytën duke thënë se po e shkeli Rregulloren, e këta qysh po u konvenon. Çka po i jepni zor, ngadalë, dëgjo! Po, a donë ta respektojmë Rregulloren?

E kalove. Është shkelje e Rregullores. A e shkele Rregulloren? Vazhdoja regjia, le të flasë, avash, por më thoni mos e shkel Rregulloren. Le të flasë!

VISAR YMERI: Pyetja ime ishte kështu? Për vetëvrasjen kë do ta angazhosh, se për “vetëpërkrahimin” e angazhove Policinë. Tash cili është agjenti që ekzekuton vetëvrasjen në këtë rast? Çfarë vetëvrasje është kjo? Jo, duhet të përgjigjesh, se e ke thanë vetë. Edhe nuk ishte kjo diçka në afekt. Këtë e pamë të gjithë mbrëmë.

Pra, seanca e djeshme ishte thirrur për ta sulmuar Lëvizjen “Vetëvendosje” me paramendim dhe ky kërcënim i Kadri Veselit pastaj për vetëvrasje ishte me paramendim. Çfarë vetëvrasje, si Dino Asanaj? A është kjo vetëvrasje që e proklamove dje? Po të kishte pasur këtu prokurori edhe gjyqësi të pavarur, ky sot do të ishte duke u marrë në pyetje, e jo këtu. Por, meqenëse nuk ka, meqenëse klani “Pronto” e kontrollon gjyqësinë, e klanin “Pronto” e kontrollon ky, atëherë natyrisht që ky sot këtu vjen dhe shitet prapë si kryetar i Kuvendit, pasi kërcënon me jetë.

Por, ne po ia themi një gjë Kadri Veselit dhe juve të tjerëve. Këta mekanizma, këto kërcënime, mbase edhe ju kanë ndezur diku, por me neve nuk kryejnë punë. Nuk mund të na dilni kurrë, sado që kërcënoni. Pra, po ju them edhe një herë - pushka top ju bëftë, se as nuk ju frikësohemi e as nuk ju respektojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Te çështja e preambulës së Kushtetutës, do të kthehem edhe një herë. Shumë kisha dashur, më vjen mirë kur Visari, dashnor kaq i madh i UÇK-së e do më shumë se unë. Por, kisha pasur dëshirë iniciativën e tij dhe ta votojmë në Kuvendin e Republikës së Kosovës që ta futim në preambulë të Kushtetutës. Për tjerat, është mirë t’i dëgjojë kryeprokurori dhe... këta trima... Kush e do fjalën tash?

Teuta Haxhiu, në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, kërkoj falje se nuk e kam vërejtur.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Në emër të Grupit Parlamentar e shprehim edhe një herë shqetësimin tonë lidhur me moszgjidhjen e statusit të punëtorëve të arsimit shqip në Republikën e Kosovës në periudhën 1990-1999.

Edhe pse sistemi paralel i Republikës së Kosovës në dekadën e viteve të ‘90-ta, kur ishim nën regjimin serb është pjesë shumë e rëndësishme e rezistencës deri në vetëmohim, sot asgjë nuk po bëhet për atë gjeneratë të punëtorëve, si në arsim, shëndetësi, shërbime publike, punonjës, edhe privatë, po ashtu edhe për minatorët, të cilit ishin larguar dhunshëm nga gjiganti “Trepça” vetëm pse kishin rezistuar për Kosovën Republikë.

Gjatë asaj kohe, të gjithë po mundoheshim të kontribuonim, të jepnim diçka për ta garantuar vazhdimësinë e jetës publike. Të gjitha këto kategori e kanë mbajtur gjallë funksionimin e shtetit tonë, duke mos u përlur para regjimit të Milosheviqit, veçanërisht në arsimin shqip dhe shëndetësia.

Njerëzit i dhanë shtëpitë e tyre dhe çfarëdo hapësire që kishin për të garantuar që arsimi shqip dhe ambulancat mjekësore të vazhdonin në ato kushte çfarë ishin.

Të dy ju partitë në pushtet sot, PDK-ja dhe LDK-ja, keni marrë çdo herë nga ata, por kur nuk ua kthyet. Një herë e një kohë, kryeministri i sotëm, Isa Mustafa, nëpërmjet bonove, por edhe pa to hiç, ua merrte një pjesë të të ardhurave për 3% e famshëm, që asnjëherë nuk u hetua hollësisht.

Sot, ky kryeministër nuk po bën asgjë për ta, ndërsa PDK-ja e kishte nënshkruar edhe një memorandum mirëkuptimi, besoj u kujtohet të gjithë deputetëve, por edhe qytetarëve. Sa për medie, atëherë kryeministri Thaçi, tash president, pra u premtoi gjitha këtyre kategorive se do të nxjerrë edhe ligje, të cilat do t'i rregulloj. Këtë nuk e bërë asnjëherë dhe nuk e ndërmori asnjë iniciativë.

Unë sot para vetes, sikur besoj që secili nga deputetët i ka disa kërkesa që u janë drejtuar pra deputetëve nga sindikatat e ndryshme, për shembull nga Federata Sindikale e ish-Policisë së Kosovës me kërkesën ose propozimin për nismën legjislative për ndryshimin dhe plotësimin e nenit 8, paragrafi 6 të Ligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti, Ligji numër 04/L-131.

Gjithashtu prapë e kemi edhe kërkesën nga Sindikata e Administratës Publike të Kosovës me emërimin SAPK gjithashtu, pra për të njëjtën gjë, për nismën legjislative për plotësim-ndryshimin e këtij ligji.

Por, unë para vetes gjithashtu e kam marrë pra procesverbalin e mbledhjes së mbajtur në Kuvendin e Republikës së Kosovës më 11 dhe 18 prill 2013, në pikën e rendit të ditës, pikën 6 pra, debat parlamentar lidhur me statusin e pazgjidhur të punëtorëve të arsimit shqip në Republikën e Kosovës - pra, në këtë periudhë '90-'99, sipas Grupit Parlamentar të LDK-së dhe rekomandimeve të Komisionit për Arsim, pjesë e së cilës isha edhe unë.

Më thoni që po ta lexosh se çfarë kanë thënë në atë kohë vetëm shefat e grupeve parlamentare, më vjen keq që për pak kohë, por e di që kryetari ma lejon ta lexoj se çfarë tha shefi, e përjashtoj në këtë rast normalisht në emër të Komisionit ka folur atëherë kryetari i Komisionit Idriz Vehapi, që i rekomandon pra Kuvendit që personelit të punësuar në këtë periudhë, deri në vitin shkollor '98-'99 t'i njihet përvoja e punës. Por, po flas edhe për Arsim Bajramin, aktualisht ministër i Arsimit, i cili në atë kohë, pra në prill 2013, theksoi në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

Tha se periudha '90-'98-'99 është një periudhë kur populli u homogjenizua nëpërmjet shkollës, nëpërmjet arsimit dhe arsimit e tregoi vitalitetin e mbijetesës në kushte, kur popullit të Kosovës i kanosej një shfarosje dhe kudo që të shkruhet në mënyrë neutrale historia e re e Kosovës nga historianët realë kjo periudhë është një periudhë shumë e ndritur, një periudhë kur shkolla e mbijetoi dhunën dhe kur populli u homogjenizua në idetë e Republikës së Kosovës, në idetë e një shteti të ardhshëm, i cili po lindte. Në vazhdimësi, ai tha: “Ne jo vetëm se e përkrahim pa asnjë dilemë”, por e dha edhe një rekomandim. Të njëjtën gjë...

(Ndërprerje nga regjia)

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti.)

KRYESUESI: Kryeje, veç të lutem, t'i zbatojmë këto rregulla!

TEUTA HAXHIU: Gjithashtu fjalë miradije plot kishte edhe Ismet Beqiri në kuadër të Grupit Parlamentar të LDK-së, e sot as ministri i Arsimit nuk bërë asgjë, por në fund me gjithë ato fjalë të Grupit Parlamentar të LDK-së nuk e morën asnjë iniciativë.

Në fund po i lexoj vetëm rekomandimet e asaj periudhe.

Dy të parat, pra besoj që secili i ka, por rekomandimin e tretë po e lexoj, për shkak të kohës, sepse u ndërrua tani kryetari, dhe nënkryetari është pak më jo tolerant.

Rekomandimi i tretë thotë: “Qeveria e Republikës së Kosovës ta hartojë këtë ligj, pra Ligjin për t’ua njohur përvojën e punës këtyre punëtorëve të arsimit, të cilët dhanë gjithçka në afatin kohor prej tre muajsh, dhe ta procedojë për miratim në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Prill 2013”. Sot jemi në muajin dhjetor, kanë kaluar tre vjet e tre muaj, asnjë ndihmë, asnjë nismë prej asnjë prej grupeve parlamentare, as LDK-së, as PDK-së, po as kryeministrit Isa Mustafë. Ndalni korrupsionin, ju tregoj edhe mënyrën se si mund ta realizojmë këtë ligj, jo vetëm ta bëjmë si ligj, por ta bëjmë të zbatueshëm. Korrupsionin dhe luksin, duke bërë meremetime sikur ka ndodhur edhe në objektin tonë, që unë kisha propozuar që kati i dytë i objektit ku ne jemi sot të ishte më mirë repart gjinekologjik, atje ku lindin fëmijët, ku lindin jetë të reja, se sa ne që s’kemi pasur fare nevojë për këto meremetime dhe ta ndalim korrupsionin që çdo ditë, pra në çdo institucion që jepen qindra-mijëra euro, e ato pas një apo dy vjetësh dëmtohen dhe i mbetet faji kompanisë.

Kompania nuk ka faj, ngase i kërkohet korrupsion dhe i jepet kompanisë që e jep çmimin më të vogël, në fakt në minimum, duke kërkuar ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Për “Nismën” janë dy deputetë, kush flet në emër të Grupit Parlamentar “Nisma”?
Valdete Bajrami.

VALDETE BAJRAMI: Faleminderit kryesues,

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Javën që e lamë pas kishte disa ngjarje, të cilat ne si opozitë qysh më herët edhe i kemi pritur, por edhe po ndodhin tashmë.

E kam fjalën për deklaratat kundërthënëse të këtij koalicioni apo përçarjen, sepse po shihet qartë se keni shumë mospajtime dhe shpresojmë t’i pranoni gabimet dhe të zhbllokoni të ardhmen e shtetit dhe të qytetarëve me shkuarjen në zgjedhje të parakohshme sa më parë.

Kjo për faktin se që nga ardhja juaj në qeverisje, pos gjashtë temave, të cilat do t’i përmend me radhë, nuk ishin në gjendje të merreshit me përgjegjësitë dhe obligimet që i keni marrë si qeveritarë dhe këtë e di që vazhdimisht e ka përmendure dhe kryeministri që opozita e ka penguar që ai të jetë i suksesshëm ose Kabineti i tij. Vetë mosprania e ministrave e dëshmon se sa të dështuar jeni, prandaj, nuk keni çka ta fajësoni opozitën. Temat, me të cilat jemi marrë gjatë këtyre viteve kanë qenë: Gjykata Speciale, të cilën e votuat ju. Demarkacioni me Malin e Zi, e që doli të jetë i gabuar dhe që doli të jetë një marrëveshje, e cila po ashtu do t’i humbë territor vendit tonë, mbi 8 mijë e 200 hektarë. Asociacioni i komunave me shumicë serbe, i cili po ashtu doli të jetë në kundërshtim me aktin më të lartë të shtetit, moskrijimi i ushtrisë, kjo për faktin se FSK-ja po e paguan çmimin e pazareve tuaja me Listën Serbe. Mosliberalizimi i vizave dhe mosluftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Ju që nga ardhja në krye të Qeverisë nuk jeni marrë me asgjë tjetër, pos tri temave që tashmë i ceka. Ju nuk ishit dhe nuk jeni në gjendje të mbani as një për qind të premtimeve, për të cilat jeni zotuar para qytetarëve gjatë fushatës. Ju që nga ardhja në pushtet të vetmin veprim që e keni bërë ka qenë marrëveshja e koalicionit tuaj për ndarjen e bordeve, agjencive dhe të gjitha institucioneve, të cilat do të duhej të ishin të pavarura, e që ju i keni bërë institucione të PDK-së dhe LDK-së.

Në vend që të merreshit me gjithë ministratë dhe të kërkonit nga ministrat që të punohet për të mirën e qytetarëve, ju keni krijuar ministri së koti dhe kjo u dëshmua tashmë. Ju, jo që doni të formatizoni Qeverinë, por ju keni rritur edhe përbërjen e tyre. Ju lutem, merreni një dikaster ku mund të thuash se ka bërë apo ka plotësuar ndonjë premtim që është bërë gjatë fushatës nga PDK dhe LDK. Dështime në shëndetësi, rasti shumë i njohur “stendat” tashmë, mosrealizimi i premtimeve për shërbimet shëndetësore, e tjera, e tjera.

Është shumë e turpshme kur edhe në ditët e sotme pacientët e Republikës së Kosovës, të cilët vuajnë nga kanceri, nuk e kanë barin bazë, i cili është i domosdoshëm. Si vendi më i vogël në rajon, por edhe në Evropë, edhe si shteti më i varfër keni bërë Qeverinë më të madhe, një qeveri që nuk ka as më të voglën përgjegjësi për shpenzimin e parasë publike. Pos që jeni qeveria më e madhe dhe më e dëmshme deri më tani që ka pasur shteti ynë, ju keni krijuar poste mbi bazën e pazareve të bëra mes jush vetëm e vetëm t'i rehatoni bashkëpartiakët, apo edhe njerëzit, të cilët janë bërë deputetë me votën e qytetarëve dhe pastaj e kanë shitur dhe po e shesin veten për të përfituar ose për vete, ose për bizneset e tyre.

Kjo tashmë është dëshmuar dhe kjo po duket që po pranohet si diçka normale, e që në fakt do të duhej të ishte e papranueshme. Kjo dukuri është tepër e dëmshme, sepse po i kushton buxhetit dhe po i kushton vetë jetës së qytetarëve. Pazaret, të cilat tashmë i dimë që i keni bërë, janë të dukshme, por pse shkoni deri në atë masë dhe të emëroni zëvendësministra e zëvendëskryeministra kot së koti që as edhe vetë ju nuk e dini nga sa i keni, sepse është e sigurt që secila ministri minimum i ka 2 zëvendësministra.

Ka raste kur zëvendësministrat nga ata janë edhe të emëruar në bordet e pavarura, si për shembull rasti i zotit Hasan Hasani, si kryesues i Bordit të ujësjellësit "Higjiena" në Prizren. Dikush nga ju a mund të na sqarojë neve, por edhe qytetarëve se çfarë përgjegjësie kanë ata njerëz në pozita, të cilat ju i keni krijuar apo ndoshta do të ishte më korrekte që nga vetë zëvendësministrat të na përgjigjen se a e dinë se çfarë detyrash kanë dhe obligimesh.

Është e kotë të mbahen konferenca e përvjetorë të gjykatave apo institucioneve të drejtësisë, sepse është e dëshmuar tashmë edhe më herët se të gjitha institucionet e pavarura janë në shërbim të këtij koalicioni PDK-LDK-Lista Serbe, dhe assesit në shërbim të qytetarëve, aq më pak në ndërtimin e një të ardhme më të mirë për shtetin tonë. E kam thënë edhe më parë se kot e keni t'i mbuloni dështimet tuaja me konferenca, ku po aty nuk i pranoni edhe pyetjet e gazetarëve, prandaj prapë po ju them që bëni mirë sa më parë të dakordoheni që qytetarëve t'u ofroni zgjedhje të parakohshme, sepse e ardhmja e vendit është shumë më e rëndësishme se sa ulëset tuaja dhe mandatet tona.

Sinqerisht, po më vjen keq që kryetari i Kuvendit e lëshoi ulësen e tij, pasi që është edhe kryetar i PDK-së, mirëpo do të dëshiroja të ishte ai këtu dhe t'i them se ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Pesë minuta kaluan, përfundoje, të lutem!

VALDETE BAJRAMI: A ia vlen më të dilet në atë foltore duke e parë mosseriozitetin e kësaj Qeverie. Nuk ka asnjë ditë pos zgjedhjes së presidentit kur e kemi pasur kur ka qenë Kabineti

qeveritar i kompletuar, këtu shihet interesimi dhe serioziteti i kësaj Qeverie. Prandaj, është mirë sa më parë që ta marrin atë vendim, të cilin javën e kaluar zoti Veseli e propozoi që të shkohet në zgjedhje të parakohshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! I kemi edhe pesë minuta, në emër të grupeve nuk ka të tjerë. E ka fjalën Elmi Reçica.

ELMI REÇICA: I nderuar nënkryetar i Kuvendit,

Të nderuar ministra,

Deputetë të respektuar,

Qytetarë të nderuar të këtij vendi,

Fundi i debatit të mbrëmshëm pati një rrjedhje çfarë e patë, arsyeja dhe shkaku ishte shumë i qartë. Në vend se shefi i Grupit Parlamentar të diskutojë për rezolutën, e mori fjalën që do të duhej ta thoshte kryetari i Lëvizjes “Vetëvendosje”, i cili nuk e pati guximin, zoti Visar Ymeri. Ai e ka kërkuar njëherë fjalën, pastaj e ka tërhequr. Dhe filloi të lexojë këtu deklarata duke i nxjerrë fjalitë me pincetë dhe duke tentuar të shkaktojë atë çfarë e shkaktoi.

Visari doli nga këtu, pse nuk doli Visar Ymeri ta lexojë atë çfarë e lexoi? Pse e obligoi Glaukun? Për shkak se Glauku e ka një bagazh familjar kombëtar?! Apo për çfarë arsye. Të lutem, Albin, dëgjomë, të lutem. E pyes Visar Ymerin, ka jetuar në Londër, a ka dhënë ndonjë cent për 3%-shin, nga i cili janë mbajtur institucionet tona? A ka marrë pjesë në ndonjë demonstratë që ju e keni bërë kryetar tash? Ju që thirreni dhe quheni Lëvizje “Vetëvendosje” dhe patriotike. A ka dhënë ndonjë cent për fondin “Vendlindja thërret”? Që të na shesë mend neve këtu për patriotizëm dhe e futni në zjarr njeriun, familja e të cilit ka vuajtur për shumë kohë për këtë ditë dhe për këtë moment.

Kjo është pafytyrësi dhe sot e tha atë që e tha “Gebelsi juaj” për kryetarin e Kuvendit. Ai mbrëmë një minutë përpara, sigurisht ai paska sugjeruar çka të shkruajë. Përsërite 100 herë një gënjeshtër dhe pastaj ajo do të shndërrohet e vërtetë, nuk janë në rregull këto veprime që po i bëni, Albin, nuk është në rregull. Po e tensiononi situatën dhe po i futni dhe jo vetëm njëherë, njerëzit i keni futur aty ku nuk duhet të futen, pikërisht njerëzit që kanë dhënë shumë për këtë vend dhe për këtë liri dhe pavarësi. Përgjegjësia është juaja, nuk është, edhe njëherë po e them, nuk është në rregull mënyra qysh po veproni dhe po e tensiononi situatën. Ne biseduam dje për atë rezolutë dhe nuk u dakorduam, por megjithatë ishte një rezolutë më e mirë të votohej nga të gjithë, nëse jemi të interesuar të gjithë t’ju ndihmojmë atyre njerëzve, por nëse po luajmë lojëra politike nuk është mirë. Nuk është mirë nga këtu të akuzoni njeriun që me minutazh u mbështet më shumë se të gjithë të tjerëve. Duhet pak respekt dhe pak korrektësi, jashtë politikës.

Po flasim si institucionalistë, këtë desha ta them dhe vërtet ju bëj ftesë që së paku për minimum çështjeve të jemi bashkë. Faleminderit!

KRYESUESI: Shpejtim Bulliqi e ka fjalën. Shpejtim, ti je i fundit, tre minuta, më shumë s'i ke.

SHPEJTIM BULLIQI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Çështjen që desha ta ngre sot si problem lidhet me 54 kryefamiljarë të njësisë punuese "Ndërtimtaria" në kuadër të KEK-ut.

Faktikisht këtë shkresë besoj që e kanë marrë të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës, sepse ata u janë drejtuar të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës dhe unë pata edhe rastin të diskutoj me ta. Më thanë që është një kërkesë, e cila faktikisht është e njohur për të gjitha institucionet e Kosovës, për faktin që këta njerëz nëpër faza të ndryshme dhe periudha të ndryshme kohore, janë lëvizur prej një pozicioni në pozicion si ndërmarrje, si njësi në suaza të KEK-ut dhe këto kanë filluar qysh në vitin 2006, duke i shndërruar në shoqëri aksionare dhjetë njësi të KEK-ut dhe nga këto dhjetë njësi, faktikisht tri njësi veç kanë marrë statusin e punës, kanë kryer të gjitha veprimet e veta. Ndërsa, të tjerat kanë mbetur jashtë loje dhe faktikisht gjendja e këtyre njerëzve edhe këtyre kryefamiljarëve sot është jashtëzakonisht e vështirë, për arsye se të gjithë këta njerëz faktikisht kanë mbetur rrugës dhe familjet e tyre kanë mbetur pa asnjë burim të të ardhurave për familjarët e tyre.

Prandaj, do të kërkoja nga këtu, nga ministri i Zhvillimit Ekonomik, zoti Stavileci, që ta marrë dhe ta trajtojë me seriozitet çështjen e këtyre punëtorëve dhe njëkohësisht do të kërkoj edhe nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut i Parlamentit të Kosovës që më seriozisht të merret dhe të shqyrtojë ankesat e të gjithë këtyre punëtorëve, për shkak të gjendjes së vështirë materiale të këtyre njerëzve dhe të kryefamiljarëve të tyre, të cilat janë bërë si rezultat i strategjive të gabuara të bëra nga ana e KEK-ut. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës.

Pritni, kujt ia ka përmendur emrin?! Albinin a ia ke përmendur emrin, nëse ia ka përmendur emrin e ka të drejtën e një replike, megjithëse ju e dini që s'është për replikë. Replika, dy minuta. Pasi po doni dialogë, bëjeni, por unë po ju them do t'ua ndërpres, më andej s'shkojmë. Dy minuta!

ALBIN KURTI: Së pari, Visar Ymeri është kryetar i Lëvizjes "Vetëvendosje" në shkurtin e vitit 2015, kështu ka vendosur anëtarësia e Lëvizjes "Vetëvendosje" me zgjedhje të lira dhe demokratike, një anëtar, një votë dhe ne nuk jemi në feudalizëm që dikush të bëhet kryetar apo diçka tjetër varësisht prej babait apo gjyshit.

Dhe, Visar Ymeri është një person edhe i ditur, edhe i mençur, edhe i guximshëm edhe trim, dhe kjo është arsyeja pse është kryetar i Lëvizjes "Vetëvendosje". Anëtarësia e ka bërë të tillë, nuk të frikësohet Visar Ymeri, as mënyrën, as sot, asnjë ditë, askujt. Nuk frikësohet. Ajo çfarë tha

deputeti Elmi Reçica sot, i bie që po të ishte Visar Ymeri mbrëmë në foltore, atëherë ka pasur të goditet, po paska qenë Glauk Konjufca dhe nuk paska marrë goditje. Dhe, tjetra, tha që të mos i futni njerëzit në zjarr, për çfarë zjarri deputet Reçica e keni fjalën?!

Për çfarë zjarri? Unë s'po shoh zjarr, nuk e kam të qartë për çfarë zjarri e pate fjalën, ose për çfarë vetëvrasje e pati fjalën kryetari i Kuvendit? Unë nuk po i kuptoj këto fjalë. Unë jam duke u frikësuar vetëm prej zjarrit të "Zajednicës" dhe demarkacionit, prandaj kam përdorur tymin e gazit lotsjellës. Unë veç këtë hall kam, ju e keni fjalën për një zjarr tjetër, unë s'po e di për çfarë zjarri e keni fjalën!

Për çfarë vetëvrasje ka folur kryetari i Kuvendit? Kë po e kërcënon ai? Por, siç tha Visar Ymeri, nuk ua kemi as frikën, as respektin. Unë e di që kjo mund të jetë e vështirë për juve, por nuk ua kemi as frikën e as respektin. Unë mbrëmë kam thënë, le të bëhemi bashkë kundër aspiratave të Serbisë, edhe brenda Kuvendit edhe jashtë Kuvendit dhe pyka që e kemi në Kuvend është pykë e Serbisë me qëndrime të kundërta...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Ju lutem! Ju e dini, sikur unë, sipas rregullave çfarë pike është kjo, e dini të gjithë. Vetë po e hani kohën e krejt çka mbetet po thoni "ana, ana", një gjysmë ore është. E dyta, e dini që s'ka replika, po keni qejf të bëni replika. E ka një minutë replikë, edhe një herë Elmi Reçica.

ELMI REÇICA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Na të gjithë e dimë që në pikën e parë, jashtë rendit të ditës, nuk ka të drejtë replike, absolutisht, mirëpo unë po i përgjigjem zotit Kurti.

Kuptimi i fjalës "në zjarr" ka shumë kuptime. Unë flas për zjarrin politik. Për zjarre të tjera flasim institucionet e tjera, ku i keni futur njerëzit e dëshmorëve, ju personalisht. Unë flas këtu për zjarrin politik dhe e di saktë që Visar Ymeri e ka kërkuar fjalën dhe e ka tërhequr, pse? Pse diskutimet kanë përfunduar dhe nëse kanë përfunduar diskutimet, ka qenë dashur të diskutohet vetëm për rezolutën, jo të lexohet deklarata çfarë ka thënë Sami Lushtaku.

Nëse vërtet jeni të interesuar për të kontribuar për këtë vend, është e vërtetë që ka hyrë pyka e Serbisë, por nuk është vetëm kjo çka po thua ti, këqyri njerëzit e tu që i ke përreth, jo Albulenën...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Kalojmë në pikën e dytë:

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti Mytaher Haskuka, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

MYTAHER HASKUKA: Faleminderit, kryesues!

Zakonisht gjithmonë kur po ka pyetje, kryeministri nuk është këtu, s'po di qysh do t'ia bëjmë me këto pyetje, por unë do ta lexoj pyetjen, në mënyrë që ndoshta përgjigjet me shkrim.

Çështja: Më 5 shkurt 2015 Kuvendi i Republikës së Kosovës e miratoi rezolutën për pengimin e migrimit ilegal të qytetarëve të Kosovës. Ka kaluar më shumë se një vit e gjysmë nga dita kur Kuvendi miratoi në konsultim të gjitha grupeve parlamentare dhe me shumicë votash rezolutën për pengimin e migrimit ilegal të qytetarëve të Kosovës që ishte edhe eksodi më i madh i qytetarëve që nga përfundimi i luftës në Kosovë.

Rezoluta nr. 05 R-01 ka 17 pika, si detyra për Qeverinë. Ato do të duhej të ishin të zbatuara nga Qeveria si masa konkrete për të parandaluar braktisjen e vendit nga qytetarët dhe të rinjtë e Kosovës. Pyetja për kryeministrin: Çka ka bërë Qeveria në implementimin e 17 pikave të rezolutës kundër migrimit? Nga 17 rekomandime të Rezolutës së Kuvendit të Kosovës, sa prej tyre janë zbatuar nga Qeveria? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Teuta Haxhiu, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

TEUTA HAXHIU: Nuk çuditem pse kryeministri Mustafa nuk është këtu, por do të dëshiroja që ai të jetë në vend dhe ta kryejë misionin çfarë e ka, por realisht ka dalë tash, e ka parë po më duket që sa më shpejt që të shkojmë në zgjedhje është më mirë. Ka filluar edhe ai të bëjë fushatë, e nuk po i sheh njerëzit e Qeverisë që po punojnë kundër shtetësisë së Kosovës, kundër parasë që po u jepet vetë atyre, pra vartësve të tij kudo nëpër botë.

Pyetja ime për kryeministrin Mustafa, se e di që nuk është, por le ta dëgjojë dhe kërkoj me shkrim të më kthejë përgjigje: në fjalën e tij pra, në seancën që diskutuam herën e fundit, ai tha që ne jemi të gatshëm, kur unë diskutova për çështjen e mosrespektimit të rezolutave të Kuvendit, ai tha që ne i respektojmë plotësisht rezolutat e Kuvendit, vetëm ato që bien ndesh me ligjet e Kosovës nuk i respektojmë.

Andaj, pyetja ime është: Le të më tregojë cila, saktë, cila nga rezolutat e nxjerra në Kuvendin e Republikës së Kosovës bie ndesh me ligjet e Republikës së Kosovës? Ngase nëse vërtet ka ndodhur kjo, atëherë ai po e nënçmon gjithë Kuvendin, të gjitha grupet parlamentare, sepse e dimë që secila rezolutë bëhet duke u mbledhur para së gjithash shefat e grupeve parlamentare apo përfaqësuesit e grupeve parlamentare dhe nëse vërtet të gjitha grupet parlamentare janë aq të

padijshëm sa pretendon kryeministri Mustafa, ai duhet të tregojë saktë se cila rezolutë ka rënë ndesh me ligjet e Kosovës? Kërkoj përgjigje me shkrim.

KRYESUESI: Faleminderit! Edhe njëherë po ju sjell në vëmendje, kjo pikë e rendit të ditës i ka 60 minuta, kaq do të zgjasë, ka 37 pyetje. Unë do të lexoj sipas rendit të paraqitjes, ta dini që pas një ore kryhet kjo punë.

Kështu që të mos bëjmë diskutime të kota, sepse janë rregulla, unë s'i kam vënë, i keni vënë vetë. Shkojmë tutje, deputetja Teuta Haxhiu, pyetje për ministrin Abrashi.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit! Besoj që e shfrytëzova kohën dhe mundësinë çfarë e kam, nënkryetar. Pyetja ime për zotin ministër Abrashi është pikërisht për pensionet që ai po pretendon që po bën rritje, por në fakt, po ua ndal pensionet njerëzve që kanë moshën, që ato janë pensione që u takojnë në bazë të moshës, pra duke i bërë 65 vjet.

Ato janë pensione që u takojnë dhe nuk mund të bëjë ai rritje të pensionit duke u ndalur pensionin familjeve të dëshmorëve, dhe duhet ta dijë se thirrja për rritje të pensioneve dhe kamuflimi që po bën ministri duke i mashtruar para opinionit, në realitet kjo po shkon në dëm të familjeve të dëshmorëve, duke ua ndalur pensionet që u takojnë. Janë familje të dëshmorëve dhe me to nuk mbahet një person, por mbahet një familje e një dëshmori.

Në qoftë se pensioni i familjes së dëshmorit preket, çka atëherë duhet të bëhet në këtë shtet? Pra, pensionet e pleqërisë janë pensione që u takojnë në bazë të moshës mbi 65 vjet, kurse pensionet e familjeve të dëshmorëve, mbajtësi i familjes së dëshmorit nuk mban vetëm vetveten, por mban edhe jetimët, të cilët kanë mbetur nga dëshmori që e ka dhënë jetën për lirinë e Kosovës.

Kjo është një padrejtësi e madhe që po bëhet, këtë e bëjnë vetëm njerëzit që vërtet nuk shohin aspak në interes të qytetarëve, andaj mos u thirrni në rritje të pensioneve duke ua marrë kafshatën e gojës atyre që e meritojnë. Ndani dhe mos i përgjithësoni gjërat: familjet dhe pensionet e familjeve të dëshmorëve, të martirëve nuk guxojnë të preken. Prandaj, urgjentisht...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Deputeti Pal Lekaj, s'është këtu. Deputetja Margarita Kadriu-Ukelli, pyetje për ministrin Blerand Stavileci.

MARGARITA KADRIU-UKELLI: Si duket sot prapë ministri nuk është këtu, por unë do ta lexoj pyetjen dhe pasi që edhe sot e kemi në rend ditës këtë çështje pres nga ministri që ta japë përgjigjen me shkrim.

Ne, faktikisht u informuam përmes një gazete gjermane se “Axos Capital” po kërkon nga Kosova hiq më pak se 390 milionë euro. Pra, rrezikojmë të humbim afro 400 milionë euro, për një proces të përcjellë me dyshime, akuza e plot prapaskena. Një gjë e tillë për Republikën e brishtë do të ishte një goditje dhe tronditje e tmerrshme financiare, pres që ministri të kthejë përgjigje se a e ka analizuar se kush në ministrinë që ai e udhëheq ka qenë përgjegjës dhe duhet të japë përgjegjësi për rrezikun e humbjes edhe të gati 400 milionë euro të tatim paguesve kosovar.

Çka tash nëse Kosova e humb kontekstin si në rastin e tenderit të pasaportave dhe detyrohet të paguajë hiq më pak se edhe 390 milionë euro, pa përfshirë këtu edhe shërbimet e avokatisë, një shumë, pra, tepër e madhe dhe e papërbalueshme për buxhetin e Kosovës. Kush është personi përgjegjës juridikisht për këtë, ku qëndron baza e padisë së “Axos”-it dhe kë e ka angazhuar për mbrojtje Qeveria dhe sa para e ka kontraktuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Donika Kadaaj-Bujupi, pyetje për ministrin Blerand Stavileci.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Është problem të bësh pyetje kur s’janë këtu dhe asnjëherë s’po marrim përgjigje. Por, megjithatë duke marrë parasysh që bëhet fjalë për punëtorët e KEDS-it, për të cilët ne kemi ngritur këtë pyetje edhe dy javët e kaluara, por s’kemi marrë përgjigje, po e përsëris dhe po pres që të më përgjigjet me shkrim brenda kësaj jave, eventualisht javën që vjen.

Në vitin 2012 kontrata për shitjen e distribucionit të KEK-ut u realizua për 26.3 milionë euro. Atë kohë u premtua se do të investohen rreth 300 milionë euro dhe se nuk do të ketë largim të punëtorëve. Ky premtim u pati bërë nga ish-ministri i Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqaj dhe ish-kryeministri Hashim Thaçi, tash i ashtuquajtur president i Kosovës. Ajo çka po ndodh në këto tre vjetët e fundit është se nuk janë investuar 300 milionë, por janë larguar 300 punëtorë nga puna dhe së fundi në këta dy muajt e fundit, 100 të fundit.

Dje kanë protestuar përsëri dhe problemeve të tyre u është shtuar edhe një padrejtësi e radhës, do të thotë fillimisht është shkelur Ligji i punës, kurse më pas pikërisht Inspektorati i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale ka shfuqizuar vendimin e KEDS-it, duke e konsideruar si të papranueshëm dhe të jashtëligjshëm, ka kërkuar që këta punëtorë të kthehen në punë. Ajo çka po ndodh është se punëtorët janë në rrugë, do të thotë mbi 300 punëtorë janë në rrugë, ndërkohë që Qeveria në pyetjet tona të ngritura tani e sa kohë, se cilat masa po i ndërmerr që të zbatojë ligjin dhe të parandalojë KEDS-in që përmes kësaj shkelje flagrante të largojë 300 punëtorë dhe rrjedhimisht të rrezikojë 300 familje, ne nuk po marrim përgjigje.

Ndoshta, edhe ministri Abdullahu, pasi është në mesin e ministrave këtu të vetëm, të cilët po përfaqësojnë sot, mund të na japë një përgjigje...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Lahi Brahimaj, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

LAHI BRAHIMAJ: Faleminderit, kryesues!

Unë këtë pyetje e kam bërë para më shumë se tri javësh për kryeministrin e Kosovës në lidhje me aeroportin e Gjakovës, por si duket kryeministri është futur në panik dhe s'po ka kohë të vijë dhe të na i kthejë përgjigjet këtu, shpresoj që një ditë do të na i kthejë me shkrim.

Pyetja është për aeroportin e Gjakovës se që nga përfundimi i luftës në Kosovë deri në vitin 2014, ku edhe mori statusin e ndërmarrjes publike, ky aeroport administrohej nga KFOR-i italian. Aty janë bërë edhe miliona investime, sipas të gjitha informacioneve. Tani këto ditë është mbyllur totalisht ky aeroport, jam në dijeni se kryeministri, bashkë me ministrin e Financave, i ndan do para sa për rojat e objektit që të mos vidhet dhe të mos plaçkitet, sikur janë plaçkitur të gjitha objektet publike. Pyetja është kështu se çka do të bëjë Qeveria, apo çka do të ndërmarrë që ky aeroport të ketë një zgjidhje afatgjate?

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Time Kadrijaj, pyetje për ministrin Memli Krasniqi.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Po më vjen keq që ministri nuk është, pyetja ka të bëjë me benefitet që duhet t'u japin bujqve dhe e dimë shumë mirë se kur është në pyetje përkrahja e bujqve dhe subvencionet, se si po shkon kjo punë. Gjithmonë po shkon me të njohshëm dhe në baza partiake. Bile-bile kemi raste ku po ndahen subvencione edhe për njerëzit që kurrë nuk janë marrë me bujqësi, në vend që ato subvencione të shkojnë në ato treva ku vërtet merret me bujqësi dhe u duhen ato subvencione.

Nuk është mirë që bujqit anekënd Kosovës t'i vizitojmë veç kur kemi zgjedhje dhe t'ju premtojmë subvencione, në mënyrë që t'u marrim votën e tyre, por t'i përkrahim edhe kur nuk ka zgjedhje. Pyetja ka qenë se tash është sezoni i vjeshtës dhe bujqit i mbjellin ato produktet për vitin e ardhshëm, ndërsa ata kanë ankesa se ende nuk i kanë marrë subvencionet dhe pyetja konkrete ka qenë se kur do t'i marrin këto subvencione?

KRYESUESI: Deputete, nëse do të përgjigjet ministri Hoti, ky është në gjendje të përgjigjet. A do? Urdhëro!

MINISTRI ABDULLAH HOTI: Më lejoni t'ju informoj që subvencionet dhe grantet për pjesën e bujqësisë janë ndarë sipas buxhetit dhe në çdo muaj kemi në dispozicion për të bërë pagesat.

Këtë vit janë 47 milionë euro që pritet të paguhen, arsyetja pse nuk janë bërë pagesat deri tash është vonesat që ka Ministria e Bujqësisë në trajtimin e shumë lëndëve që ka pranuar. Unë ju

garantoj që mjetet janë në dispozicion dhe shpresoj që Ministria e Bujqësisë do të arrijë që deri në fund të vitit t'i trajtojë të gjitha kërkesat që i ka në shqyrtim dhe të përmbyllim programin e granteve dhe subvencioneve për bujqësi ashtu siç është planifikuar në fillim të vitit.

Përndryshe, unë ju kërkoj edhe njëherë që po mundohemi të kemi vëmendjen maksimale që të përfitojnë bujqit që janë duke u marrë me bujqësi. Nëse keni raste konkrete që dikush i ka marrë subvencionet që nuk e meriton, që nuk merret me atë, ju kisha lutur të flisni me emra konkretë kush janë ata persona dhe shihni mandej masat që do t'i ndërmarrim. Por, nëse lëshojmë kështu akuza veç në ajër, besoj që nuk na kontribuojnë të zgjidhim problemin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputete, ke pyetje shtesë?

TIME KADRIJAJ: Për neve është me rëndësi që këto subvencione të shkojnë në vendin e caktuar dhe te njerëzit vërtet që merren me bujqësi, në mënyrë që ta përkrahim atë kategori.

Nuk po them me regjione të ndahen ose në një komunë ose në një komunë tjetër, sepse cilido bujk që ndihmohet, në cilindo qytet të Kosovës për neve është e mirë, por problemi është se bujqit janë ankuar pse s'po ndahen në rregull, ka vonesa në subvencione, ju e sqaruat se ka vonesa, por ministër, a është vonë, sepse është një afat kohor kur duhet të mbillen dhe nëse kalon ajo periudhë kohore, nuk ka ndonjë rëndësi të madhe nëse u ndahen ato subvencione bujqve ose s'u ndahen. Sepse, ju e dini se disa të mbjella e kanë kohën e caktuar kur duhet të mbillen në mënyrë që të ketë sukses dhe rezultat ajo mbjellje.

Përndryshe, nëse nuk ndahen me kohë dhe nuk fillon mbjellja me kohë, atëherë çfarë vlere ka ndarja e subvencioneve.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti LahiBrahimaj, pyetje për ministrin Skënder Hyseni.

LAHI BRAHIMAJ: Faleminderit, kryesues!

Edhe këtë pyetje ia kam parashtruar para tri javësh ministrit dhe deri sot nuk ka gjetur kohën për të na kthyer përgjigje.

Është çështja për policin, zotin Nehat Thaçi, i cili është arrestuar dhe akoma është aktuale. Ne çdo ditë nëpër medie dëgjojmë se do të lirohet sot, do të lirohet nesër. Do të dëshironim të na sqarojë ministri çka kanë vepruar, çfarë masash kanë ndërmarrë për lirimin e zotit Nehat Thaçi. Faleminderit!

KRYESUESI: Deputeti Pal Lekaj, pyetje për ministrin Hoti. Pal Lekaj s'është, ministri është.

Deputeti Slavko Simiq, pyetje për ministrin Hoti. Deputeti s'është. Ministri është. Deputeti Rrustem Berisha, pyetje për ministrin Blerand Stavileci.

RRUSTEM BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Unë e kam paraparë një pyetje për ministrin Stavileci, e kam parashtruar më 4 tetor, që nga ajo datë nuk kam përgjigje. Nuk e di arsyen, por po pres herën tjetër. Pyetja ime ka të bëjë me veprimtarinë e operatorëve ilegalë dhe shpresoj që do ta marr përgjigjen me shkrim.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Haxhi Shala, pyetje për ministrin Kujtim Shala.

HAXHI SHALA: Faleminderit, kryesues!

Unë e kam një pyetje për ministrin e Kulturës, por s'qenka këtu, por sidoqoftë unë po e lexoj, ndoshta marr përgjigje me shkrim ose në seancën tjetër.

Çështja është te palestra sportive e financuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit që ka filluar para shtatë vjetëve, për arsye banale ende nuk është funksionalizuar, edhe pse ka qenë në prag të përfundimit. Të rinjtë shtimjanë, edhe pse këtu kemi deputetë shtimjanë, por kanë për t'u marrë me çështje më madhore dhe nuk shkojnë te palestra e tyre. Rinia shtimjane, e cila edhe në kushte shumë më të vështira ka treguar rezultate kulminante në sporte e sidomos, në sportin e hendbollit. Nuk e ka merituar që ky objekt të mbetet si një përmendore e braktisur. Objekti ka filluar të shkatërrohet, si brenda ashtu edhe jashtë, ende pa përfunduar.

Pyetja për ministrin është: Kush është dashur të mbyllë këtë kontratë të palestrave dhe të bëhet përfundimi i palestrës? Cila Qeveri ka qenë përgjegjëse për përfundimin e kësaj kontrate, ajo e Thaçit apo e Mustafës? Dhe, kur saktësisht do të përfundojë kjo palestër? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Visar Ymeri, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

VISAR YMERY: Faleminderit!

Para se të kaloj te pyetja, unë nuk isha më herët në sallë dhe e pash që Elmi Reçica ishte marrë me baballarë e me bagazh patriotik... e kështu me radhë. Unë veç një pyetje të shkurtë e kam për të. A e njeh Enver Maxhunin ti? A e di që është baba i Shpend Maxhunit?

Enver Maxhuni prej vitit 1980 e tutje ka qenë bashkë me UDB-në dhe ka qenë komandant në stacionin policor në Vushtri.

KRYESUESI: Kjo nuk është në rend dite.

VISAR YMERY: Tash, ju, ti personalisht dhe qeveria jote, e bëni Shpend Maxhunin drejtor të Policisë së Kosovës dy herë, në dy mandate, herën e dytë kundërligjshëm. Dhe, çka po bën

Shpend Maxhuni tash? A është duke e vazhduar rrugën e babës së vet? Duke montuar raste policore kundër të rinjve shqiptarë duke i akuzuar për terrorizëm. A është kjo vazhdimësi? E vrasjen e Selver Haradinajt asnjëherë s'ka guxuar ta quajë terroriste, apo jo?

KRYESUESI: Zoti deputet, kjo nuk është në rend dite! Zoti deputet, s'është në rend dite!

VISAR YMERI: Jo, jo, le të përgjigjet, se po thotë ju keni aty "udb-asha". I keni mbushur institucionet me "udb-asha".

Pyetjen kujt t'ia shtroj, kryesues? S'është kryeministri këtu, kujt t'ia drejtoj? A ta thërras në telefon?

KRYESUESI: Shiko, mos më... Unë po e drejtoj seancën edhe s'është në këtë rast punë imja a mungojnë ata që bëjnë pyetje a këta që japin. Nuk jam gjykatës këtu. Po ua jap fjalën, e lexoni ose s'e lexoni.

VISAR YMERI: E di! As, s'po them që je gjykatës, veç po të them që pyetjen s'kam kujt t'ia shtroj, se nuk është këtu.

KRYESUESI: Shkojmë tutje. O zotëri! Po, e ndërpreva unë. Jo, jo, unë muskuj këtu s'përdori. Unë i thash, je jashtë rendit të ditës, nuk e kam ndërmend me u shty me ju. Nuk shtyhem me ju unë. A po doni ta ndal mbledhjen? Nëse do, e ndal. Çka po do? Urdhëro, një minutë nëse të duhet. Nuk po zgjidhni kurrgjë. E ke një minutë, por nuk zgjidh gjë. Po e do një minutë, jepja një minutë Reçicës e nëse doni ne e mbarojmë rubrikën, si të doni. Po mos, se veç po e humbni kohën!

ELMI REÇICA: I nderuar dhe i respektuar nënkryetar i Kuvendit, Nuk kam çfarë të them unë për rregulloren, se e di më mirë se të gjithë ne, por në pyetje parlamentare nuk jam unë pjesë e ministrisë, të më parashtrohen mua pyetje.

KRYESUESI: Është e vërtetë!

ELMI REÇICA: A po, pra?

KRYESUESI: Po!

ELMI REÇICA: Kjo po dua të jetë. Nëse më ka parashtuar pyetje, unë po i përgjigjem.

Është e vërtetë, që baba i Shpend Maxhunit ka qenë inspektor i Shërbimit të Sigurimit Shtetëror. Mirëpo, Shpend Maxhuni ka qenë ushtar i UÇK-së, e para.

E dyta, Shpend Maxhunin s'e kam zgjedhur unë. Dihen procedurat ligjore, si është zgjedhur, në çfarë konditash është zgjedhur. Dhe, nuk është korrekte duke e ditur ata saktësisht se si zgjidhet, me çfarë procedure. Dhe e treta, Shpend Maxhuni është treguar drejtor i suksesshëm dhe këtë s'po e vlerësoj unë, e kanë vlerësuar qytetarët dhe të gjitha institucionet që e përcjellin Policinë e Kosovës.

Të tjerat, veç...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Më duket se e sqarove atë çfarë kërkoi ky. Kalojmë në tjetrën. Deputeti Driton Çausi, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

DRITON ÇAUSHI: Në rregull! Megjithëse, një pyetje e ngjashme u shtrua pak më herët, konsideroj se është e rëndësishme të përsëritet një çështje e tillë.

Fjala është për Aeroportin e Gjakovës, i cili, fatkeqësisht, ka shërbyer deri më tani si një mjet për të fituar zgjedhje, por ka ngelur, siç e dimë të gjithë. Do përpiqem shkurtimisht të bëj një përshkrim të rrjedhës së ngjarjeve.

Më datë 28 mars të vitit 2014 kjo ndërmarrje publike u themelua nga Qeveria e Kosovës dhe prej themelimit ju deshën më shumë se dy vjet kohë për emërimin e anëtarëve të bordit.

Më 6 shtator ministri i Financave, Abdullah Hoti, kishte deklaruar se Aeroporti i Gjakovës po shkon drejt funksionalizimit si aeroport civil dhe për ushtrinë e ardhshme të Kosovës.

Pyetja parlamentare është: Ka mbi tre vjet qysh se çështja e Aeroportit të Gjakovës shfrytëzohet për qëllime elektorale, që nga zgjedhjet lokale në Gjakovë, në vitin 2013, në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2014 e deri më sot.

Qytetarët e Kosovës e sidomos, ata të komunës së Gjakovës, duhet të dinë nga ata politikanë që e premtuan hapjen e Aeroportit të Gjakovës, zhvillimin ekonomik dhe hapjen e vendeve të punës, e duke e ditur se kontrata për koncesionimin e Aeroportit të Prishtinës kufizonte fluturimet civile në aeroportet tjera se cila është e vërteta për Aeroportin e Gjakovës dhe premtimet që vijnë bashkë me të. Është e papërgjegjshme, se si për gjithë këto vjet kjo çështje manipulohet dhe keqpërdoret nga të gjithë ata që e shfrytëzuan këtë në fushata elektorale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sërish Driton Çausi, pyetje për ministrin Skender Hyseni.

DRITON ÇAUSHI: Me gjithë papërgjegjësinë evidente të shumicës së ministrave, duke mos marrë pjesë dhe të mos përgjigjen në pyetje, për hir të rëndësisë së çështjes më duhet ta shtroj këtë pyetje dhe përderisa po flitet për sukseset e Policisë së Kosovës dhe të Shpend Maxhunit, më 29 shkurt të vitit 2016 Organizata për të Drejtat e Njeriut Amnesty International i është drejtuar ministrit Hyseni me një letër të gjatë, ku ka shprehur shqetësimin lidhur me përdorimin e tepruar dhe abuziv të forcës nga pjesëtarët e forcave të Policisë së Kosovës, përfshirë edhe anëtarët e Njësitit Special gjatë një operacioni për të arrestuar deputetin e Kuvendit të Kosovës, Albin Kurtin, në zyrat e Lëvizjes “Vetëvendosje” më 28 nëntor të vitit 2015.

Unë besoj që nuk ka qytetar që nuk është shokuar me një rast të tillë të paprecedent të një ndërhyrjeje brutale të paparë ndonjëherë në Republikën e Kosovës, me njësitë antiterroriste, në zyrat e subjektit më të madh opozitar dhe ende nuk kemi asnjë përgjegjësi të dhënë për këtë skandal dhe ato që rrodhën pas saj, pra për një vit përndjekje të aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”, e cila po vazhdon ende sot me montimin e rasteve për terrorizëm.

Pyetja për ministrin është, se çka ka ndërmarrë pas kësaj letre në lidhje me kërkesat dhe problemet e shtruara në letrën e Amnesty International.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Ganimete Musliu, pyetje për ministrin Skender Hyseni.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Prej dje kam bërë potpuri pyetjesh, por pa përgjigje e po e shoh që edhe sot bëj pyetje, por s’do të marr përgjigje.

Megjithatë, unë do t’i ruaj pyetjet për Skender Hysenin, se janë pyetje të cilat nuk e humbin aktualitetin dhe thjesht, në këtë potpurinë e pyetjeve të mija kisha pasur edhe një pyetje shumë, shumë të shkurtër. Desha ta marr shumë seriozisht atë propozimin e Albin Kurtit, kur tha të kthehemi në ’98-ën. Veç desha ta di a ka thënë në ’98-ën në Drenicë, a ’98-ën në Prishtinë, se s’e kisha të qartë. Faleminderit!

KRYESUESI: Kjo s’është pyetje. Edhe ti kalove prej rendit të ditës. Deputeti Zafir Berisha, pyetje për ministrin Skender Hyseni.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Meqë, nuk kam kujt me ia bë pyetjen unë do të flas, do ta shfrytëzoj këtë dyminutësh për një çështje shumë shqetësuese, e cila është ngritur disa herë në seancë. Edhe nga disa parafolës u potencua, se një grup mafiozë turko-kosovar e ka privatizuar distribuimin e energjisë elektrike, që quhet KEDS. Dhe, sot ai grup mafiozë i cili menaxhon me një pasuri kombëtare është duke i larguar qindra punëtorë nga puna dhe për këtë çështje unë mendoj se meqë, kontrata atëherë ka

qenë e fshehtë, a ka kush në këtë shtet që ta dijë se si qëndron puna e kontratës së shitjes së pasurisë kombëtare një grupi mafiozë?

E them “mafiozë” sepse këta kanë filluar ta teprojnë. Rajone të tëra me ditë të tëra janë pa energji elektrike. E keqja qëndron në atë, se këta mashtrues shpeshherë na thërrasin që të na paralajmërojnë, jo shpeshherë, po çdo ditë, se ka intervenime në përmirësimin e rrjetit. Intervenime për çdo ditë nuk mund të ketë dhe qytetarët janë interesuar, se a del dikush vërtet për të intervenuar në rregullimin e rrjetit. Asnjëherë nuk ndodh.

Pra, këta mashtrues energjinë e shesin për hesapet e tyre, ndërsa qytetarët e rajoneve të ndryshme i lënë pa energji elektrike. Unë vi nga Prizreni, ku përpos rajonit kah vi unë, Vërrini, po edhe nga Drinia, edhe Podrimja e Zhupa janë pa energji. Por, në gjendje tepër të mjerueshme është edhe komuna e Drenasit, ku dega jonë edhe ka ngritur një shqetësim, sepse trafoja e energjisë elektrike është brenda një fabrike që është privatizuar. Tash, KEK-u duhet shpjeguar nëse është fab...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Aida Dërguti, pyetje për ministrin Skënder Hyseni.

AIDA DËRGUTI: Meqë, ministri nuk është këtu, unë kërkoj që pyetja ime të bartet për seancën e ardhshme. Po ashtu, edhe pyetje tjetër që e kam për ministrin e Shëndetësisë, se edhe ai nuk gjendet këtu, edhe ajo le të bartet për seancën e ardhshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Deputetja Donika Kadaaj-Bujupi, pyetje për kryeministrin Isa Mustafë.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Kryesues, definitivisht i ka humbur kuptimi edhe seancave edhe pyetjeve parlamentare, përderisa në vazhdimësi është Qeveria e cila nuk vjen të japë përgjigje. Është neni 97 i Kushtetutës, që obligon Qeverinë e Republikës së Kosovës të vijë në Parlament dhe t’u përgjigjet pyetjeve të deputetëve.

Unë nuk do ta bëj pyetjen, por kam një pyetje dhe kërkesë tjetër për kryeministrin dhe Qeverinë. Në seancën e radhës kërkojmë me shkrim të na njoftojë për arsyet e mungesave të vazhdueshme. Nëse po e bojkoton Kuvendin, dihet se shkojmë në një proces të rilegjitimitimit dhe e mbyllim këtë çështje, nëse ka probleme tjera, s’mund ta bartë presionin, s’mund të japë përgjigje, s’ka asnjë gatishmëri të japë llogari për problemet që lidhen me mosveprimet e tij, atëherë prapë duhet të japë dorëheqje. Kjo kështu është krejt e pakuptimtë.

Ne thërrasim seanca, mbajmë seanca, Qeveria nuk është këtu. Kosova është republikë parlamentare dhe kjo është shkelje e Kushtetutës, çfarë po bën Qeveria.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Bislim Zogaj, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

BISLIM ZOGAJ: Edhe pse mendoj se pyetja është aktuale, megjithatë po shfrytëzoj rastin që ndoshta në seancën tjetër do të jetë këtu kryeministri për ta pyetur.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Ismajl Kurteshi, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

ISMAJL KURTESHI: I nderuar kryesues,
Në secilën shkollë të mesme të Kosovës nxënësit që i bëjnë 30 mungesa të paarsyeshme përjashtohen. Isa Mustafa deri tash i ka mbi 60 mungesa dhe ky Kuvend nuk po ndërmerr asnjë masë.

I propozoj Kuvendit që, ose ta përjashtojmë ose parapërjashtim, së paku, ta çojmë Isa Mustafën, se vërtet nuk ka kuptim kështu të luajë me një institucion, që po e quajmë më të lartin. Megjithatë, unë po e lexoj pyetjen, se unë e di që edhe herën tjetër ai nuk vjen.

Këshilltari komunal në Kuvendin e Komunës së Gjilanit, Sërgjan Mitroviq, më 11 dhjetor të vitit 2015...

KRYESUESI: Zotërinj deputetë, në vendet tuaja! Mos u varni atje, në vendet tuaja.

ISMAJL KURTESHI: ...është emëruar nga kryeministri i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, kryetari organit të përkohshëm në komunën e Gjilanit. Neni 3, paragrafi 2 i Ligjit për zgjedhjet lokale uandalon anëtarëve të kuvendeve komunale të jenë anëtarë të ndonjë organi të zgjedhur. Në bazë të kësaj dispozite ligjore për zgjedhjet lokale, Kuvendi Komunal i Gjilanit më 29 shkurt të vitit 2016 e ka përjashtuar zotin Mitroviq nga seanca me arsyetimin se i njëjti është emëruar kryetar komune, si strukturë paralele nga Qeveria e Serbisë.

Ministria e Pushtetit Lokal, kjo e jona, e Kosovës, në shkresën e 16 marsit të vitit 2016, në lidhje me këtë rast, përveç tjerash shkruan: “Lidhur me marrjen e veprimeve për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit të Komunës, zotit Mitroviq, tejkalon autorizimet e komunës”, do të thotë Komuna e Gjilanit i ka tejkalar. Kuvendi Komunal i Gjilanit përsëri e ka përjashtuar zotin Mitroviq nga seanca e mbajtur më 29 shtator 2016 dhe...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Po s’je i dhjetë sekondave ti, se dy minuta i more. Hajde, bëje atë pyetje ose lëre.

ISMAJL KURTESHI: Numëroj sekondat!

...dëshmi se ka dhënë dorëheqje nga strukturat paralele serbe në institucionet e Serbisë. Mitrovici ka deklaruar po atë ditë, se nuk e ka ndërmend të bëjë dorëheqje. Pyetjen e bëj herën tjetër.

KRYESUESI: Deputeti Ismajl Kurteshi, pyetje për ministrin Skender Hyseni. Dy minuta janë për ta bërë pyetjen.

ISMAJL KURTESHI: Një minutë e pesëdhjetë, hiqja ato dhjetë sekonda tash.

Zoti ministër,

Dhjetëra, mijëra shqiptarë të Luginës së Preshevës të dëbuar nga pushteti i Serbisë në vitin 2001 jetojnë në Kosovë pa status të rregulluar. Të njëjtit janë hequr nga evidenca e institucioneve të Serbisë dhe atje nuk mund të nxjerrin dokumente të identifikimit dhe udhëtimit, kurse kusht i Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës për dhënien e lejes për qëndrim të përkohshëm është pikërisht letërnjoftimi i Serbisë. Për kthimin e të dëbuarve në shtëpitë e tyre, duhet përkrahje institucionale e Kosovës.

Me përgjigjen e Ministrisë së Punëve të Brendshme drejtuar zyrës për Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, në gusht të këtij viti, lidhur me lejen e qëndrimit, përveç tjerash thuhet: “është paraparë një nen për shtetasit e huaj, ku kanë të drejtë të aplikojnë për leje qëndrimi të përkohshëm për qëllime tjera, ku kemi paraparë që në këtë kategori të hyjnë edhe shqiptarët e Luginës së Preshevës, të cilët dëshmojnë se jetojnë në Kosovë nga viti ‘99.

Zoti ministër,

Shqiptarët e Luginës kanë shumë probleme me administratën e Ministrisë suaj, që i pengon ata t’i realizojnë të drejtat më elementare të njeriut, siç është e drejta për shkollim, shërbime shëndetësore, sociale, e tjera... Si dhe kur do ta zgjidhni këtë problem të këtyre qytetarëve.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Shukrije Bytyqi, pyetje për ministrin Imet Rrahmani.

SHUKRIJE BYTQI: Faleminderit, kryesues!

Unë pyetjen do ta bëj, se e kam dërguar më 27 shtator, kështu që nëse ne i presim ministrat, ata asnjëherë s’janë këtu. Më duket se janë bërë razi të shkojnë në shtëpi.

Institucionet e Republikës së Kosovës akreditojnë programe, që mandej të rinjtë që studiojnë në ato programe nuk kanë edhe ku të shkojnë. Edhe që shëndetësia nuk është prioritet për këtë Qeveri është vërejtur çdo ditë e më shumë, ku studentët e drejtimit bio-kimi, kimi organike me biokimi dhe drejtimit bachelor biokimiko-fiziologjik me vite të tëra bredhin nëpër institucione për të kërkuar një përgjigje për të drejtën e atyre që nëpër konkurset kanë të drejtë të punojnë.

Si është e mundur që tërë kohën të flitet për reforma në shëndetësi e në realitet, qytetarët çdo ditë kërkojnë të marrin rezultate nga laboratorët, analiza të gjakut në Shkup, Tiranë e shtete tjera. duke e ditur se në shtetet e Bashkimit Evropian është e lejuar që këto drejtime të punojnë në laboratore biokimike. Prej janarit të vitit 2016 ne jemi duke insistuar që të marrim përgjigje nga ministri i Shëndetësisë.

Ministër, edhe sa kohë duhet pritur për të marrë një përgjigje nga ju?

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Shukrije Bytyqi, pyetja për ministrin sërish. Ke pyetje të dytë apo çka është kjo? Edhe një herë për ministrin Rrahmani, që s'është këtu.

SHUKRIJE BYTYÇI: Kjo pyetje tjetër është aktuale ende dhe do ta lë për seancën tjetër. Shpresoj që të jetë këtu! Pasi që ka të bëjë për specialistët që tani i janë nënshtruar konkursit në Ministrinë e Shëndetësisë.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Besa Baftija, pyetje për ministrin Rrahmani.

BESA BAFTIJA: Faleminderit, nënkryetar!

U bënë shumë kritika në lidhje me ministrat që nuk janë prezentë. Unë do të them të vërtetën, se ministri Rrahmani është përgjigjur pyetjeve, mirëpo si duket kësaj radhe ka hezituuar të vijë, për arsye se këtë pyetje që do ta parashtrij tash e kemi diskutuar në Ministri me ministrin dhe nuk ka pasur përgjigje apo nuk donte që të bëjë zgjidhje.

Prandaj, çështja ime ka të bëjë me ndarjen e specializimeve, ku dihet se Ministria e Shëndetësisë ka publikuar listat e mjekëve që kanë fituar të drejtën e specializimit, ku ka pasur shumë ankesa nga ana e atyre që nuk kanë përfituar specializimet.

Ky grup i mjekëve pretendon se ka pasur shumë parregullsi në përzgjedhjen e kandidatëve. Këto brenga këta i kanë shprehur duke protestuar para ministrisë, mirëpo ata nuk kanë pasur mundësi të takohen me asnjë zyrtar nga Ministria dhe në mungesë të përgjigjes ata u janë drejtuar anëtarëve të Komisionit Parlamentar, ku në detaje kanë dhënë argumente të mjaftueshme, se ky proces në tërësi është i para-porositur dhe i gatuar me objektiva politike dhe plotësisht nepotike.

Prandaj, pyetja ime ka qenë: A ka ndërmarrë diçka ministri në këtë drejtim, që të zbardhet e vërteta, sa u përket këtyre manipulimeve që janë bërë në këtë konkurs dhe, nëse po, a do të anulohet konkursin dhe të shpallet konkurs i ri për specializime? Faleminderit!

KRYESUESI: Përsëri deputetja Besa Baftija, pyetja sërish për Imet Rrahmanin.

BESA BAFTIJA: Faleminderit, nënkryetar!

Nga stopimi i lëshimit të certifikatave mjekësore nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, sipas statistikave, të hyrat në qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare nëpër tërë Kosovën kanë rënë për tre-katërfish, pasi tani këto certifikata ekskluzivisht lëshohen nga institucionet private shëndetësore.

Edhe pse, jeni pro konceptit të mjekësisë familjare, do të duhej të gjeni një zgjidhje që specialistët e nevojshëm për lëshimin e këtyre certifikatave të jenë prezentë në qendrat e mjekësisë familjare, në mënyrë që mjetet të inkasohen në institucionet publike, mjete të cilat do të zhvillojnë akoma më shumë shëndetësinë publike dhe shërbimet ndaj qytetarëve. Kjo zgjidhje do të mund të bëhej, ose përmes lejimit të punësimit të këtyre specialistëve, ose përmes ndonjë vendimi nga Udhëzimi Administrativ nga Ministria e Shëndetësisë, ku do të lidhej marrëveshje bashkëpunimi me institucionet dytësore dhe tretësore publike, në mënyrë që certifikatat të lëshohen nga institucionet publike shëndetësore, të cilat do të jenë më të besueshme, pasi që lëshohen nga institucionet publike, por do të shërbenin edhe si mekanizëm i rritjes së inkasimi të mjeteve të domosdoshme për shërbime cilësore në institucionet publike shëndetësore.

Pyetja është: A do të ndërmarrë diçka Ministria e Shëndetësisë, konkretisht ministri Rrahmani, në këtë drejtim, në mënyrë që certifikatat mjekësore për patentë shoferë dhe për diçka tjetër të lëshohen nga institucionet publike shëndetësore? Faleminderit!

KRESUESI: Edhe ty faleminderit! Blerta Deliu-Kodra s'është, i ka dy pyetje. Visar Ymeri, pyetje për ministrin Arban Abrashi.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Meqenëse, edhe ministri nuk është këtu, por unë sigurisht që po e lexoj pyetjen, sepse besoj që herën e ardhshme do t'i përgjigjet. Ka të bëjë me të gjeturat e raportit të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm me titull "Siguria në punë e punonjësve në sektorin e ndërtimtarisë", në të cilin shihet se është rritur numri i aksidenteve të rënda të punëtorët që janë të punësuar në sektorin e ndërtimtarisë.

Inspektimi dhe monitorimi i zbatimit të legjislacionit që mbulon këtë sektor është në kuadër të ministrisë, që e udhëheq ministri Abrashi. Dhe, pyetja ime është, që të na tregojë për numrin e saktë të këtyre aksidenteve dhe për atë se çfarë ka ndërmarrë ministria përmes Inspektoratit në lidhje me këto çështje, që është goxha alarmante dhe shqetësuese?

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Sali Salihu, nuk është këtu. Mytaher Haskuka, pyetje për ministrin Abdullah Hoti.

MYTAHER HASKUKA: Faleminderit, kryesues!

Zoti ministër,

Vitin e kaluar unë pata parashtruar një pyetje lidhur me zbatimin e Ligjit 03/L-179 për Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës, specifikisht sipas nenit 14 - Burimet financiare, pika 1 po e citoj ligjin. “Për realizimin e detyrave dhe obligimeve të përcaktuara me këtë ligj Kryqi i Kuq i Kosovës siguron mjete financiare nga...”, ndër të tjera thotë: “... pika 1.7 sigurimi i obligueshëm i automjeteve 1% nga bruto primi i vlerës së sigurimit të automjetit.” 6 vjet që ky ligj nuk implementohet. Ju vitin e kaluar patët deklaruar që Qeveria nuk ka kompetenca, por më vonë unë e shikova dhe e pamë se Ministria e Shëndetësisë është mbikëqyrëse e zbatimit të Ligjit për Kryqin e Kuq.

Në anën tjetër, sipas Ligjit mbi Bankën Qendrore të Kosovës, neni 32 thotë që ministria ka të drejtë të kërkojë nga BQK-ja përshkrimin e rrjedhave financiare, prandaj Ministria e Financave ka kompetenca ndaj BQK-së dhe mund të kërkojë nga Banka Qendrore e Kosovës, t’i kushtëzojë kompanitë e sigurimeve që të implementojnë ligjin, pra të ndajnë 1% të bruto-primit nga sigurimi i automjeteve.

Një vit pasi që u qartësua se Ministria e Financave ka kompetenca ndaj BQK-së, çka ka ndërmarrë Qeveria dhe ministria për zbatimin e dispozitave ligjore për financimin e Kryqit të Kuq të Republikës së Kosovës? Faleminderit!

KRYESUESI: Urdhëroni, ministri Hoti!

MINISTRI ABDULLAH HOTI: I nderuar deputet,

Unë fillimisht ju njoftoj, se kjo pyetje nuk ka arritur tek ne, por megjithatë unë po përgjigjem tash.

Ministria e Financave nuk ka asnjë kompetencë mbi Bankën Qendrore, është institucion komplet i pavarur. Pyetje e njëjtë pak a shumë u shtrua edhe vitin që shkoi. Unë do ju përgjigjem me shkrim, në detaje, në pyetjen e juaj së shpejti, sapo ta pranoj në zyrën time. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Abdyl Ymeri, pyetje për ministrin Lutfi Zharku.

LUTFI ZHARKU: Po e lë unë për herën tjetër.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Albulena Haxhiu, pyetje për ministren, Dhurata Hoxha.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Duke pasur parasysh faktin, që Komisioni për Legjislacion është mbikëqyrës për Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale, shumë të burgosur, ndoshta jo më shumë se dy javë, më kanë kontaktuar në mënyrë që të më ankohen për dhunën psikike dhe fizike në Qendrën Korrektuese të Prizrenit. Ka të bëjë me dhunën psikike dhe fizike ndaj komunitetit rom.

Këtë pyetje parlamentare jam munduar që ta bëj edhe diskutim në mbledhjen e Komisionit për Legjislacion, ku ishte e ftuar ministrja e Drejtësisë. Aty, në bazë të informacioneve, ministrja tha se nuk ka informacione për diçka të tillë. Po ashtu, edhe drejtori i burgjeve tha njësoj, por më thanë po ashtu, që do të informohen në qoftë se ka ndodhur diçka e tillë.

Të njëjtin shqetësim e parashtroi edhe deputeti Danush Ademi. Kështu që, unë po pres nga Ministria e Drejtësisë raport me shkrim në lidhje me shqetësimet dhe ankesat e të paraburgosurve në Qendrën Korrektuese të Prizrenit, por që besoj se janë të shfaqura edhe në qendrat tjera korrektuese, sidomos komuniteti rom dhe të tjerët. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Deputeti Rrustem Berisha, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

RRUSTEM BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Pyetja ime për kryeministrin ka të bëjë me Komisionin Qeveritar për Verifikimin e Statusit të Veteranëve dhe të Invalidëve, që i ka skaduar mandati më 24 maj. Sekretaria ka qenë pjesë e këtij komisioni dhe thjesht, pyetja ka pasur të bëjë me çështjen, se kur do të fillojë punën kjo sekretari, sepse kanë mbetur edhe shumë punë pa u bërë. Ka të bëjë me certifikimin e listave përfundimtare.

Unë shpresoj, se në mbledhjen e ardhshme kryeministri do të na përgjigjet në këtë pyetje.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Aida Dërguti, pyetje për ministrin Imet Rrahmani.

AIDA DËRGUTI: Kryesues, thash edhe më herët, për shkak se mund të kem edhe pyetje shtesë gjatë përgjigjes së ministrit, unë kërkoj që pyetja ime të bartet për seancën e radhës.

KRYESUESI: Atëherë, pyetjet e deputetëve që nuk marrin përgjigje në dy seanca plenare do të publikohen në revistën e Kuvendit dhe në faqen zyrtare elektronike të Kuvendit.

Presim që deputetët të vendosen në sallë.

Në sallë kemi 62 deputetë. Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme

Pyes nëse keni vërejtje për procesverbalet e seancave plenare, të mbajtura më 7, 8, 11 dhe 12 tetor 2016?

Atëherë, konstatoj se Kuvendi i miraton procesverbalet e seancave plenare të mbajtura më 7, 8, 11 dhe 12 tetor 2016.

Kalojmë në pikën e katërt.

Urdhëro, zoti Pajaziti, kryetar i Grupit Parlamentar të PDK-së.

ZENUN PAJAZITI: Unë propozoj që pika 5 e rendit të ditës - Shqyrtimi i parë i projektligjit për ndryshim-plotësimin e Ligjit për procedurën përmbartimore të hiqet nga rendi i ditës për seancën e sotme dhe të mbahet në seancën e radhës.

Kam një kërkesë prej ministres, e cila sot kishte angazhime jashtë dhe u lut që kjo pikë të shtyhet për seancën tjetër, kur do të jetë edhe ajo. Kërkoj mirëkuptim dhe mbështetje prej deputetëve.

KRYESUESI: Atëherë, kërkoj një votim formal për pikën e 5-të të rendit të ditës, shqyrtimi i parë i projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurat përmbartimore, siç e paraqiti shefi i Grupit Parlamentar të PDK-së, meqë ministrja s'mund të jetë këtu sot, propozon që të shtyhet për një mbledhje tjetër.

Kush është për? Faleminderit! Kundër? Abstenime? Me shumicë pranohet ky ndryshim në rend të ditës.

Atëherë, vijojmë me rendin e ditës sipas asaj që keni marrë në ftesë:

4. Propozim-deklarata e Kuvendit të Republikës së Kosovës adresuar Unionit Evropian për liberalizimin e vizave

Komisioni për Punë të Jashtme ka parashtruar propozim-deklaratë për liberalizimin e vizave të qytetarëve tanë në Zonën e Shëngen-it. Komisioni i ka propozuar Kryesisë së Kuvendit, që tekstin e propozuar ta harmonizojë me propozimet e paraqitura nga grupet parlamentare AAK dhe "Nisma".

Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e mbajtur më 24 tetor 2016 vendosi që ta radhisë në seancë plenare, të formohet një grup i punës nga të gjitha grupet parlamentare për harmonizimin e tekstit të përbashkët të Kuvendit.

Fjalën e merr kryetari i Komisionit për Punë të Jashtme, Reçica.

ELMI REÇICA: Faleminderit, zoti nënkryetar!
Përshëndetje kryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Të respektuar deputetë,

Desha paraprakisht një historik të shkurtër rreth kësaj çështjeje. Komisioni Parlamentar për Punë të Jashtme, me ftesë të kryetarit të Kuvendit, më 18. 10. 2016 ka mbajtur një takim të përbashkët lidhur me diplomacinë parlamentare, me ç’ rast u diskutua edhe për mundësinë e avancimit të statusit tonë në sferën e integritimeve evropiane.

Nga ky takim i përbashkët erdhëm në përfundim që të nxjerrim një deklaratë të përbashkët lidhur me liberalizimin e vizave për qytetarët tanë.

Draft-deklarata është diskutuar në mbledhjen e radhës së komisionit, të mbajtur më 21.10.2016, me ç’ rast anëtarët e komisionit, përfaqësuesit e grupeve parlamentare AAK, “Vetëvendosje” dhe Nismës kanë pasur vërejtjet e tyre për plotësimin e ndryshimin e kësaj draft-deklarate.

Në pamundësi të miratimit me konsensus të plotë në komision të kësaj draft-deklarate, komisioni ka vendosur që t’ia përcjellë Kryesisë së Kuvendit draft-deklaratën dhe propozimet nga grupet parlamentare për harmonizim, me qëllim të arritjes së një drafti të konsoliduar, i cili më pas do t’i përcillet Kuvendit për miratim.

Meqë kjo nuk ka ndodhur, e ne kemi pasur një projekt që pas miratimit të kësaj draft-deklarate të krijojmë grupe të përbashkëta nga të gjitha partitë, dhe pozitë e opozitë, por edhe nga komunitetet joshumicë dhe të dalim nëpër qendra të vendosjes, në mënyrë që të dëshmojmë se jemi unikë sa i përket liberalizimit të vizave, së pari dhe e dyta, të dëshmojmë se rreth demarkacionit që është një nga kushtet dhe kriteret për liberalizim do të punojmë dhe angazhohemi që t’i tejkalojmë ato ndasi çfarë janë tash. Kjo është bërë me qëllimin më të mirë për t’i arritur afatet e fundit për liberalizim.

Mendoj se Komisioni Parlamentar për Punë të Jashtme e ka pasur një angazhim në këtë drejtim dhe angazhimi ka qenë konkret dhe shumë i fuqishëm, mirëpo gjatë debatit ne nuk kemi mundur të merremi vesh.

Unë do ta lexoj deklaratën fillestare, e pastaj sigurisht që do të diskutohet edhe nga grupet e tjera parlamentare, por mendoj se brendapërbrenda kësaj deklarate, e cila është draft-deklaratë, faktikisht, përmban të gjitha ato që janë qëndrime të partive politike dhe tash i ftoj të gjitha grupet parlamentare dhe të gjithë deputetët ta votojmë sot në mënyrë unanime këtë deklaratë dhe pastaj Komisioni Parlamentar për Punë të Jashtme, në bashkëveprim me Kryesinë e Kuvendit dhe shefat e grupeve parlamentare, për të krijuar grupe të tilla që gjatë javës së ardhshme të dalin nëpër qendra të vendosjes dhe ta prezantojnë këtë unitet tonin sa i përket liberalizimit të vizave.

Pra, nëse më lejohet, unë do ta lexoj këtë draft-deklaratë:

DRAFT - DEKLARATË

Ne deputetët e Republikës së Kosovës, të përkushtuar për integrimin e vendit tonë në Bashkimin Evropian, përmes fuqizimit të demokracisë, sundimit të ligjit, lirive dhe të drejtave të njeriut, të përkushtuar për fqinjësi të mirë paqe, stabilitet dhe bashkëpunim të mirë me Malin e Zi dhe shtetet fqinje, pavarësisht dallimeve që kanë mbi mënyrën e shënimit të kufirit në mes të Kosovës dhe Malit të Zi koalicioni qeverisës dhe opozita, qëndrojmë të bashkuar në qëllimin që ky proces të përmbillet sa më shpejt që është e mundur.

Duke marrë për bazë këtë konsensus parimor, ne si përfaqësues të popullit kërkojmë mirëkuptimin e vendeve të Bashkimit Evropian që qytetarëve të Kosovës t'u njihet e drejta e lëvizjes së lirë në Zonën Shengen.

Ju njoftojmë se institucionet e Kosovës i kanë përmbushur të gjitha kriteret e kërkuara që dalin nga udhërrëfytyrja për liberalizimin e vizave.

Kjo është pjesë e kësaj draft-deklarate dhe unë mendoj që edhe deputetët dhe qytetarët ta vlerësojnë, sepse i përmban të gjitha ato çfarë janë dallime brendapërbrenda nesh, e njëkohësisht bën ftesë që ne të jemi unikë sa i përket liberalizimit të vizave. Faleminderit, i nderuar kryetar!

KRYETARI: Faleminderit! Për një qëndrim nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, a e dëshironi fjalën? Fjalën e ka Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryetar!

Pa dyshim se procesi i liberalizimit të vizave është një prej synimeve kryesore të vendit, është një prej agjendave, me të cilave institucionet e Kosovës për vite me radhë kanë punuar. S'ka pasur ndoshta një agjendë tjetër përveç kësaj që ka mobilizuar institucionet që qoftë edhe në mënyrë të njëanshme të përpilojnë plane për t'i plotësuar kriteret teknike sa i përket procesit të liberalizimit të vizave. Prej vitesh ky proces ka qenë dhe mbetet në agjendën tonë, jo vetëm si shtet, por edhe si shoqëri, dhe për shkak të interesimit të gjeneratës së re që t'i kenë vizat dhe të lëvizin lirshëm nëpër vende të BE-së.

Ne e kemi thënë disa herë që në mënyrë të padrejtë kemi mbetur të izoluar, por duhet të dimë se procesi i liberalizimit të vizave është një proces në të cilin krejt Evropa Juglindore ka kaluar, është një proces, kriteret e të cilit pikë për pikë janë zbatuar nga vendet të cilat kanë aderuar dhe janë bërë pjesë e lëvizjes së lirë.

Te ne ka pasur një histori të veçantë dhe ne duhet të themi, herë pas here e kohë pas kohe ka pasur edhe kritere që kanë pasur ngjyrimet politike ose që mund t'i quajmë kritere politike.

Pa dyshim se edhe kriteret e fundit janë më shumë politike dhe e kanë vështirësuar këtë proces.

Por, ajo që ne duhet të bëjmë është që të shprehim gatishmërinë tonë dhe vullnetin tonë politik, të shprehim unitetin tonë politik, shoqëror, institucional, në mënyrë që të bëjmë hapa dhe të çelim rrugë shtesë sa i përket gatishmërisë më të madhe të shteteve të BE-së që të na i hapin rrugët dhe të na bëjnë pjesë e lëvizjes së lirë.

Është vështirë që kjo të arrihet pa i përmbushur kriteret që ata na i kanë dhënë dhe ne e dimë situatën si e kemi, por kjo deklaratë është një hap tjetër i mirë, një hap tjetër shtesë, një mundësi tjetër shtesë edhe për faktorin politik që të bëhemi bashkë dhe ta çojmë një sinjal, i cili do të mundësojë që në njëfarë mënyre të na e japin një shans ose të hapin rrugën, edhe pse pavarësisht që kjo deklaratë tashmë është bërë si iniciativë e njohur, nuk është se ka tone optimiste, porse nuk është thënë që mund të refuzohet.

Unë sot, në emër të Partisë Demokratike të Kosovës, e mbështes këtë deklaratë dhe i ftoj edhe grupet e tjera dhe deputetët që, të paktën, me këtë deklaratë të tregojmë një mundësi shtesë, një gatishmëri të faktorit politik për sa i përket procesit të liberalizimit të vizave.

Pra, unë në emër të Partisë Demokratike shpreh gatishmërinë edhe të Grupit Parlamentar që të punojmë në të gjitha mënyrat për të krijuar një mundësi të lëvizjes së lirë dhe për të zbatuar gjithçka që është kriter teknik, edhe tjetër, për sa i përket procesit të liberalizimit të vizave dhe me këtë rast shpreh qëndrimin unik të Partisë Demokratike, e po ashtu i ftoj të tjerët që ta votojnë këtë deklaratë. Faleminderit!

KRYETARI: Kryetari i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Për rëndësinë, domosdoshmërinë dhe nevojën e asaj që qytetarët tanë të kenë qarkullim të lirë unë do të zgjas shumë, sepse është një e drejtë që konsiderojmë se është e drejtë elementare në Evropën e bashkuar dhe se është një padrejtësi që fatkeqësisht na është vënë ne.

Ne, siç u tha nga kryetari i komisionit, kemi biseduar në komision dhe ka ardhur deri te ky propozim. Normalisht se ka pasur përpjekje të harmonizohet teksti, mirëpo nuk është arritur dhe ne e kemi këtë draft, e po ashtu janë edhe dy propozime të tjera, të dy grupeve të tjera parlamentare.

Prandaj, ne si grup parlamentar, duke e pasur të qartë se veçmas pika 3 e thotë në mënyrë të qartë se ne kemi dallime në qasjen ose mënyrën e shënimit të kufirit në mes të Malit të Zi dhe Kosovës dhe qartë e thotë se ekzistojnë këto dallime, por po ashtu konsiderojmë si grup

parlamentar se kjo deklaratë është shprehje e vullnetit të mirë si Kuvend, si parti politike, për atë që qytetarët tanë, ose më mirë të thuhet Bashkimi Evropian ta ketë parasysh këtë nevojë imediate të qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe se kjo deklaratë në asnjë mënyrë nuk legjitimon pozicionet që janë të qarta kohë të gjatë mes pozitës dhe opozitës, por është një lloj, edhe një herë po e them, e vullnetit të mirë shprehur me një deklaratë, pavarësisht që e dimë sa mund të ketë fuqi ose a ka fuqi ligjore kjo. E kemi të qartë që është më shumë deklaratë politike dhe vullnetmirë, por ne si Grup Parlamentar do ta mbështesim këtë deklaratë që u lexua nga kryetari i komisionit. Faleminderit!

KRYETARI: Nga Lëvizja “Vetëvendosje”, kush e dëshiron fjalën? Aida Dërguti, nënkryetare, e ka fjalën!

AIDA DËRGUTI: Faleminderit, kryetar!

Po e marr unë fjalën, meqë kam përcjellë edhe punimet në Komisionin për Punë të Jashtme.

Për mua ka qenë pak befasi kur u soll draft-deklarata e përbashkët, sepse tashmë sa muaj ne jemi futur në një proces, pra të gjitha subjektet politike dhe jemi ulur në tryezë, ku po përpiqemi t’i përafrojmë qëndrimet lidhur me një deklaratë të përbashkët sa i përket demarkacionit.

Në këtë tryezë janë po ashtu të pranishëm ambasadorët e vendeve të Kuintit dhe përfaqësuesi i BE-së. Atje kemi një draft tjetër, ku i kemi përafuar qëndrimet dhe në takimin e fundmit ka qenë një çështje shumë e imët për çka nuk u pajtuam, por besoj se duhet të vazhdojmë të punojmë në këtë draftin që e kemi filluar tash e sa muaj dhe të mos dublifikojmë një punë, e cila praktikisht ky drafti që është sjellë në Komisionin e Punëve të Jashtme nuk ka asgjë të përbashkët me këtë pjesën ku ne i kemi përafuar qëndrimet.

E dimë që interes i qytetarëve është liberalizimi i vizave dhe është e padrejtë, sepse ne i kemi përmbushur të gjitha kriteret e udhërrëfyesit për liberalizim të vizave, mirëpo janë dy kushte të tjera, të cilat i janë vënë Kosovës, që lidhet njëra me demarkacionin dhe tjetra me luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionin, e për të cilin kontribut nuk mund të japë opozita, por është Qeveria që do të duhej ta plotësojë këtë kusht. Ndërkohë që kushti tjetër që lidhet me demarkacionin, ne e kemi shprehur gatishmërinë duke u ulur e diskutuar tash e sa muaj.

Prandaj, unë kisha kërkuar që ose të hedhet edhe ky drafti tjetër, ku kemi qëndrime më të përafuara, ose të mos fillojmë një proces të ri me këtë draftin e Komisionit për Punë të Jashtme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Pal Lekaj.

PAL LEKAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Sa i përket liberalizimit të vizave, është një çështje jetike për qytetarët e Kosovës dhe shtetin tonë, sepse jemi vendi i vetëm në rajon që jemi të getoizuar, prandaj edhe kjo iniciativë që të krijojmë një diplomaci parlamentare është e mirë, por e vonuar, sepse unë mendoj se këtu ka dështuar diplomacia e jashtme dhe ka dështuar Qeveria në përmbushjen e kriterëve për liberalizim të vizave.

Kur e them dështimin, është në krimin e organizuar dhe korrupsionin, që ne vetëm kur bisedojmë në sipërfaqe, por s'e luftojmë në mënyrë permanente edhe me ligjet në fuqi.

Ne si Grup Parlamentar është e vërtetë se kemi dhënë kontributin tonë më të mirë të mundshëm që të kemi konsensus, mirëpo fatkeqësisht na është ofruar një deklaratë që nuk i përmbush ato kërkesat e opozitës dhe ne jemi pajtuar me dy versione, në kuptimin që të procedohen në Kuvend. Është një draft-propozim i Aleancës dhe unë mund t'jua lexoj, i cili është i përafërt edhe me atë që po bisedojmë dhe jeni edhe ju si liderë në takimet që udhëhiqen nga Naim Rashiti dhe përfaqësuesit e ambasadave që janë të pranishëm.

Ju e dini qëndrimin e Aleancës, ne nuk mund ta përkrahim propozimin që u dha paraprakisht nga kryetari i Komisionit Parlamentar për Punë të Jashtme.

E kemi propozuar një draft që mund t'ua lexoj.

Në pasuesin e tretë, ku thuhet që ne grupet parlamentare garantojmë se do të japim kontributin tonë në zgjidhjen e këtij kontesti përmes rishikimit e mbi bazën e fakteve dhe argumenteve që janë paraqitur dhe në të njëjtën kohë jemi të përcaktuar që çështja e demarkacionit me Malin e Zi të zgjidhet përmes rrugës politike, diplomatike e ligjore, ku nuk do të dëmtohet integriteti territorial i asnjërit shtet, dhe si përfaqësues të qytetarëve të Kosovës jemi të vendosur që të vazhdojmë angazhimin e plotë institucional për forcimin e rendit dhe ligjit, luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Ndërsa mbetet pasuesi ashtu siç është propozuar nga kryetari i komisionit dhe pasuesi i fundit të tërhiqet krejtësisht.

Vetëm në këtë mënyrë Aleanca mund ta votojë, por nëse nuk pranohen propozimet tona, me keqardhje them se as unë, as grupi s'e ka mandatin që ta votojmë deklaratën që e dha kryetari i komisionit. Faleminderit!

KRYETARI: Zafir Berisha nga "Nisma", të bëhet gati "6+", Qerim Bajrami.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryetar!

Ne po flasim për një çështje tepër të rëndësishme dhe vitale për qytetarët, por forma se si i jemi qasur këtij problemi, nuk po më pëlqen.

Është e vërtetë se ideja ka dalë nga një takim që e kemi pasur si Komision për Politikë të Jashtme, mirëpo tendenca që rolin e opozitës ta minimizojë, për të mos thënë, edhe injoruar, nuk na ka pëlqyer.

Pra, gjatë debatit në komision faktikisht ne kemi dhënë mendimet tona, për të kontribuar në këtë drejtim dhe për të dalë nga një situatë e rëndë, në të cilën e ka futur ky koalicion vendin, por në momentin kur dy subjektet më të mëdha parlamentare kanë insistuar që deklaratës të mos i hiqet asnjë presje e vetme, atëherë ne me të drejtë dyshuam se diçka nuk është në rregull.

Thënë të drejtën, ky paragrafi i fundit, do të thotë kur njoftojmë se institucionet e Kosovës i kanë përmbushur të gjitha kriteret e kështu me radhë, do të thotë është i paqëndrueshëm, sepse po t'i kishim përmbushur të gjitha kriteret, ne edhe s'do të kishim nevojë të bëjmë deklaratë.

Pra, unë mendoj që roli i opozitës në këtë çështje të rëndësishme duhet të jetë i theksuar dhe, sido që të jetë, për këtë çështje ju e dini se skena politika në Kosovë dhe situata në këtë Parlament, do të thotë s' kanë qenë asnjëherë më të acaruara dhe për këtë edhe bashkësia evropiane sigurisht e ka pasur në konsideratë, derisa edhe ka vënë kriterë obligues në njëfarë forme.

Unë mendoj se tema që është trajtuar me muaj të tërë mes liderëve politikë duhet të përfshihet dhe faktikisht në këtë letër, për të cilën pretendojmë se do të ndikojmë. Ne veç e kemi marrë një përgjigje nga përfaqësuesit e BE-së se me deklaratë nuk zgjidhen problemet dhe nuk liberalizohen vizat, por sido që të jetë, nëse bash edhe duhet çuar një letër, unë jam i mendimit që kjo letër të përmbajë materialin të cilin e kanë diskutuar për muaj të tërë liderët politikë dhe për një arsye tepër minore, do të thotë, nuk është nënshkruar dhe ky draft të zëvendësohet me draftin, i cili para disa ditësh është diskutuar mes liderëve, më datë 15 shtator 2016. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nga "6+", zoti Bajrami e ka fjalën.

ĆERIM BAJRAMI: Zahvaljujem se, predsedavajući!

Poštovani poslanici,

Poštovani ministri,

Poštovani građani Kosova,

Nalazimo se dakle pred jednom obavezom ove Skupštine, odnosno poslanika u njoj da bi smo koliko toliko omogućili građanima Kosova da dobiju jedan pozitivan odgovor od institucija Evropske Unije vezano za tako dugo očekivanju liberalizacije viza za sve naše građane, a

pogotovo i za pripadnike nevećinskih zajednica, jer mnogi od njih žive i rade u zemljama Evropske Unije.

Mi smo kao Parlamentarna grupa “6+” uzeli učešće u pripremama ove deklaracije, odnosno izjave i svakako ćemo glasati za nju, i bilo bi jako dobro da se i opozicija pridruži ovoj zajedničkoj izjavi da bi smo kao Parlament izašli veoma ozbiljni i pred građana Kosova, i pred Komisije Evropske Unije i pred svim drugim institucijama u EU i kazali da ćemo taj proces oko demarkacije završiti na institucionalni način.

U svakom slučaju mi ćemo na kraju glasati za ovu izjavu i samo da dodam ono što sam kazao i na Komisiji za spoljne poslove zvanično da svakako su dobre sve inicijative nevladinog sektora i gospodina Naima Rašitija u ovom slučaju, ali želimo da poručimo i sa ove govornice Parlamenta da smo nezadovoljni što predstavnici nevećinskih zajednica ne uzimaju svoje učešće u tim razgovorima, i što nisu do sada pozivani.

Najmanje 9 poslanike ovog Parlamenta pripada nevećinskim zajednicama, i oni na neki način trebaju biti pozvani u tim pregovorima ili razgovorima između predstavnika većinske zajednice. U ovom slučaju ispred Grupe “6+” mi ponovo izražavamo naš protest što se ne pozivamo u tim razgovorima. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Të nderuar kolegë deputetë, po e shohim realisht se kemi vështirësi në arritjen e konsensusit, jo vetëm për këtë çështje, por edhe në shumicën e çështjeve.

Mund të vazhdojmë togfjalëshin e një situate skenar si të djeshmit a të sotmit, i cili është vetëm konfliktuoz, ose e mira është që kjo iniciativë për një deklaratë duhet të shihet vetëm si një mundësi e vogël për liberalizimin e vizave. Prandaj nëse munden grupet parlamentare të harmonizojnë, të heqin të gjitha, ndoshta disa finesa gjuhësore, pra edhe me atë pjesë që opozita do ta fusë demarkacionin dhe gjithsesi duhet rishikuar. Pozita e ka qëndrimin e vet.

Por, sido që të jetë, do të futemi edhe për nja 6 orë diskutime, e këtë duhet ta kemi parasysh dhe në fund, jam i sigurt se vendimmarrja është me paragjykim. Mirëpo, ideja, edhe në grup atë ditë kur kemi qenë ishte që të bëjmë një deklaratë të përbashkët për shkak të liberalizimit të vizave, nëse jeni të pajtimit dhe nëse s’jeni të pajtimit, në fund të fundit, më mirë është të mos futemi edhe një herë në debat të rëndë. Dhe nëse dëshironi vetëm të futemi në debat, ta fjeni njëri-tjetrin, atëherë përgjegjësia është juaja.

(Ndërrhyrje)

Urdhëroni, kryetarët e grupeve parlamentare dhe ju deputetë. Pra, a ka mundësi të vazhdojmë ne me pika të rendit të ditës. Pra, le të tërhiqen kryetarët e grupeve parlamentare dhe, nëse nuk bëhet

një harmonizim i mundshëm, atëherë i kam tri drafte, e nëse dëshironi i vëmë në votim dhe për këtë kryetarët e grupeve parlamentare më tregojnë. Të tria ndaras, një nga një, i plotësojnë kushtet për procedim, ose s'e vëmë asnjërën hiq, sepse edhe ashtu më mirë, s'po merremi vesh dhe le ta marrë vesh çdokush se në këtë Kuvend s'mund të merremi vesh.

Sa i përket takimit të liderëve, të njëjtën situatë e kemi. Është një pikë aty, kemi kërkuar, kam kërkuar edhe unë që të hiqet fare, të mos jetë as shqyrtimi, as rishqyrtimi, por të jetë vetëm marrëveshja në princip, e cila ndonjëherë do të bëhet, të mos paragjykohet. Por, s'po duam të merremi vesh. Njëjtë do të jetë.

Kryetarët e grupeve parlamentare, a pranoni gjysmë ore të dilni, të bisedoni dhe na e sillni një konkluzion, për të cilin do t'u thërras prapë, kurse ne vazhdojmë seancën me pika të rendit të ditës. Kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryetar!

Gjithsesi jemi të gatshëm të japim mundësinë e duhur për harmonizimin e një teksti, por me atë çfarë dëgjuam këtu, shohim se është vështirë.

Ne edhe ashtu i kemi afatet e limituara dhe ne e dimë cili ka qenë edhe qëndrimi i Parlamentit Evropian dhe çfarë është agjenda e tyre.

Kjo deklaratë nuk minimizon rolin e askujt, por me këtë deklaratë të mos mendojmë ne se e eskivojmë as demarkacionin dhe as detyrat që kemi për t'i kryer ne si Kuvend. Nuk e minimizojmë as iniciativën për t'i tubuar liderët dhe të ketë qëndrime të rëndësishme politike edhe për tema të tjera.

Me këtë deklaratë ne vetëm i japim shans vendit tonë që në takimet e radhës të institucioneve të BE-së dhe Parlamentit Evropian të na japin mundësi të tjera për liberalizim të vizave.

Të gjithë ata që mendojnë në agjenda të tjera nuk i ndihmojnë këtij vendi. Boll ka rreth nesh që po mundohen ta qesin shtetin tonë si shtet të dështuar, si është Serbia me tërë forcat e veta.

Prandaj, ju kisha lutur juve që jeni në Parlament këtu, se kjo është minimumi i gjuhës sonë që do të kishim mundur ta përdorim dhe të shprehim një vullnet politik, klasës politike, të institucioneve, të shoqërisë kosovare para BE-së për liberalizim të vizave dhe t'i jepet mundësi rinisë kosovare dhe të tjerëve të lëvizin lirshëm.

Asnjë institucion tjetër dhe asnjë qëndrim tjetër, asnjë lider nuk mund të minimizohet dhe as të pengohet për të pasur agjenda të tjera me këtë deklaratë. Ne jemi të gatshëm prapë të ulemi dhe ta harmonizojmë, por po them ky tekst është i bërë për t'u pranuar dhe për t'u dhënë sinjal

pozitiv të gjithëve dhe të mos i prekim agjendat e veçanta që i kanë edhe liderët, edhe partitë politike. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ismet Beqiri nga Grupi Parlamentar i LDK-së. E kemi qëndrimin e PDK-së që mund të tërhiqen dhe të vazhdojmë seancën tjetër.

ISMET BEQIRI: Zoti kryetar!

Unë e thashë edhe në fjalën tonë se asnjëherë s’e përjashtojmë mundësinë e një teksti unik të deklaratës që do të ishte shumë me rëndësi, pra të unifikuar, nëse është e mundshme.

Unë e respektoj të drejtën e deputetëve të flasin, por është e vërtetë se kjo mund të marrë kohë dhe prapë do të vijmë aty që duhet ulur e ta shqyrtojmë mundësinë e një teksti apo të mbesim pa deklaratë.

Këto janë dy mundësi, prandaj unë edhe po shoh që ka deputetë, të cilët po kërkojnë me reagime, por jemi në rend të ditës, e le të flasin. Pra, si deklaratë është menduar se absolutisht i shpreh qëndrimet qartë dhe pasi po duhet thënë dhe vizatuar se kush është për e kush është kundër demarkacionit në formën që është, atëherë këtu thuhet shumë qartë se qëndrimet dallojnë, por po ashtu e thotë qartë se ne kemi vullnet e gatishmëri që në këtë proces të bëjmë një deklaratë të përbashkët me qëllim që qytetarët tanë... ta marrë sa mund të marrë parasysht Bashkimi Evropian, edhe pse e dimë fuqinë ligjore të kësaj deklarate, përpos se është vullnetmirë.

Pra, sidoqoftë, janë disa deputetë dhe unë më shumë kam qenë ithtar që o të votohen këto deklarata, o të shkohet në harmonizim dhe nëse harmonizohet, e nëse jo, kjo çështje të mbetet, realisht edhe do të mbetet pa u votuar.

KRYETARI: Faleminderit! Glauk Konjufca nga Lëvizja “Vetëvendosje”, apo Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit!

Së pari mendoj që domosdoshmërisht duhet të vazhdojë debati për të gjithë deputetët që duan të flasin për këtë çështje, për deklaratën, dhe në përgjithësi për çështjen, kjo nuk ndalur, sepse Kuvendi, tek e fundit, është vend ku flasim, ku shprehim qëndrimet tona dhe është njëkohësisht mundësi për opinionin publik që ta dëgjojë qëndrimin e të gjithëve sa i përket deklaratës dhe vërejtjeve që kanë për të.

Unë nuk mendoj se Kuvendi është një skutë ku ne mblidhemi fshehtash dhe dakordohemi për një tekst. Pra, duhet të japim mundësi, natyrisht edhe harmonizimit nëse është i mundshëm të tekstit, por ai harmonizim bëhet këtu, duke folur dhe duke dhënë secili propozime që ka për tekstin ose duke shprehur qëndrimin e tij karshi deklaratës.

Kjo deklaratë e propozuar nga Komisioni për Politikë të Jashtme është asgjë. Është bash asgjë.

KRYETARI: Po, ne e morëm qëndrimin e grupit, kalojmë më tutje.

VISAR YMERI: Unë i kam 10 minuta të mundshme të flas dhe mos më ndërhyj kur flas, e kur ta kryej unë, pastaj ti fol.

KRYETARI: Atëherë, regjia ia ndal fjalën! Pal Lekaj e ka fjalën! Është herë e parë dhe po shihet saktësisht se qëllimi është vetëm të krijohet aktrim, me asgjë të mos merremi vesh, vetëm konfliktualitet. Edhe s'e kam ndërmend... Pal Lekaj e ke fjalën. Më falni, është herë e parë që ia ndali fjalën, por realisht po e shoh një lloj arrogance, e cila s'po më pëlqen fort. I kërkoj falje publikut, jo Visarit.

(Reagime)

PAL LEKAJ: Po më çudit fakti sa i përket kërkesës së konsensusit që edhe ne kemi shprehur gatishmërinë sa i përket kësaj deklarate, mirëpo unë nuk di si të shpjegoj. Në njërën anë kërkon konsensus, në tjetrën anë na ofroni draft-deklaratën dhe thoni: ose merreni, ose lëreni!

Nëse doni konsensus, ejani t'i harmonizojmë qëndrimet dhe mos thoni se nuk mund t'ia shtojmë asnjë shkronjë, prandaj kjo është vetëm sa për të bërë politikë këtu në Kuvend dhe jo për të mirën e qytetarëve.

E nëse e keni seriozisht, atëherë pranoni edhe atë që e ofron opozita. Përndryshe, kjo është vetëm sa për të bërë hajgare këtu në Kuvend. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë, Zafir Berisha nga "Nisma". Ne menduam edhe teksti të ndërrohet, të shikohet, nëse mundet për gjysmë ore.

ZAFIR BERISHA: Siç po shihet, ne mund të tërhiqemi për harmonizim, por nuk mund të harmonizohet.

Po llogaris se edhe kjo deklaratë ka ardhur në Kuvend njëjtë si ajo rezoluta e djeshme, me u paraqitur se jemi duke bërë diçka, e në fakt s'jemi duke bërë kurrgjë. Ne e dimë efektin dhe ndikimin e kësaj deklarate, që do të jetë më pak se zero, por dallimet, të cilat na kanë përcjellë tash e sa kohë për çështje shumë jetike për vendin, do të thotë nuk mund të tejkalohen me një deklaratë të kësaj natyre.

Unë besoj se më mirë do të ishte të mos përsëriten skenat e debatit të djeshëm, të mos i përsërisim ato skena jo të këndshme dhe të mos arrijmë asgjë.

Unë mendoj se në momente kur nuk përfilllet qëndrimi i opozitës si diçka jetike në jetën politike dhe institucionale, ne s'kemi çka humbim kohë me këtë deklaratë. Në fakt, edhe Pali e tha. Ne disi, me imponimin e deklaratës po na qitni në pozitë tepër të keqe. Situatën e rëndë në Kosovë e ka sjellë koalicioni dhe për t'u prezantuar koalicioni me një fytyrë tjetër që nuk e ka, karshi edhe faktorit ndërkombëtar, na qesin në pozita të këqija si opozitë për të ripërsëritur të vërtetën e madhe që jemi duke e thënë tash e sa kohë.

Pra, forma në të cilën është duke u zhvilluar debati dhe insistimi për një deklaratë nuk është duke më pëlqyer aspak. Përndryshe, nëse dy partitë e mëdha tërhiqen me mendimin që në komision të imponojnë komplet deklaratën që dikush nga kolegët me të drejtë e pati thënë se kjo me gjasë është vetëm e përkthyer, e s'është e përpiluar nga ta hiç, sepse së paku sa unë e di, Grupi Parlamentar i LDK-së as që e ka dhënë ndonjë mendim, bile të fundit, pas neve dhe opozitës e ka marrë këtë deklaratë.

Pra, mendoj që ne nuk duhet të kapemi këtu për agjenda të tjetërkujt që na imponojnë në komision, por edhe në Kuvend. Faleminderit!

KRYETARI: Qerim Bajrami e ka fjalën. Ne jemi duke folur një herë vetëm për çështjen e qëndrimit të grupeve parlamentare, por a po shkoni në pauzë, apo jo.

(Ndërhyrje)

Hiç mos u frikëso, e nderuar zonja Osmani! Do ta kemi edhe atë, por vetëm pak. A ka mundësi ta marrë fjalën Qerim Bajrami, pastaj Elmi Reçica.

ĆERIM BAJRAMI: Zahvaljujem se predsedavajuću!

Parlamentarna grupa "6+" jeste za konstruktivni prilaz i mislimo da je dobar prijedlog da predstavnici grupa sjednu i pokušaju da ponovo harmonizuju izjavu, da bi smo je na kraju svi izglasali, da ne bude ovde rasprave i prepirke i da samo pogoršamo situaciju, na mestu da je poboljšamo. Znači, ipak mi smo obavezni prema građanima Kosova da odradimo svoj deo posla prema Evropskoj Uniji, a neka oni sude šta smo to uradili i šta nismo. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk kemi kurrfarë qëndrimi konsensual, po shoh. E në qoftë se e merr fjalën Elmi Reçica, vazhdojmë dabin. Jo për debat, sepse një herë fole, folën edhe të gjitha grupet parlamentare dhe nuk kemi nevojë më. E nëse doni debat, tregoni? Pra, le të dihet publikisht se doni debat! Urdhëro, zoti Reçica për fjalë!

ELMI REÇICA: Faleminderit, kryetar!

Veç desha një sqarim, Komisioni Parlamentar për Punë të Jashtme nuk ka dashur ta hedhë në votim, se ka pasur vota për ta mbivotuar, por e dinë edhe zoti Beqiri, edhe gjithë të tjerët që kanë

qenë aty, edhe zoti Berisha. Kemi dashur që kjo çështje të zgjidhet me konsensus, kjo është esenca çfarë po dua të them. Nuk kemi dashur të shkojmë me mbivotim.

KRYETARI: 15 minuta nëse nuk merren vesh, vazhdojmë, ndaras i kemi, të keni parasysh në fund, jo, për korrektësi. Në fund janë dorëzuar tri draft-deklarata, një PDK-LDK dhe “6+”, një e ka Grupi Parlamentar “Nisma” dhe një draft-deklaratë e ka Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

Jo, jo, veç 15 minuta, tani edhe replikë, qysh po shoh përgatituni për debat. 15 minuta. Në qoftë se nuk merren vesh grupet parlamentare, shkojmë në debat, këto draft-rezoluta votohen, këto që i përmenda.

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë, fillojmë vazhdimin e seancës. Aktualisht jemi 71 deputetë në sallë. Besoj kushtet janë për të vazhduar seancën.

Unë ndërkohë gjatë kësaj pauze, të cilën e kemi pasur, nuk ka harmonizim, po shihet më saktë se nuk ka harmonizim të qëndrimeve, aktualisht jemi me dy, vetëm ta sqaroj si është situata për hir të kolegëve deputetë.

Jemi me dy deklarata, të cilat për hir tuajin si deputetë, nuk po flas qëndrim politik aspak, por cilëndo e vejmë në votim nuk ka ndonjë vlerë, për arsye se as kjo e cila është nga tri grupet parlamentare nuk mund të ketë efekt, për arsye se në propozimin e draft-rezolutës së Grupit Parlamentar të PDK edhe LDK-së me “6+” edhe opozita përfshihet, nuk është arritur konsensus dhe, në anën tjetër, kjo të cilën e kanë sjellë tri grupet e tjera parlamentare të partive opozitare e ka një procedurë, e cila pothuajse është në gjendje reale, e cila nuk bën ndonjë efekt, në qoftë se dëshironi ta konsumoni kohën, mund të vazhdojmë.

Unë do t’ua jap fjalën kryetarëve të grupeve parlamentare në qoftë se dëshironi veç për ta konsumuar kohën, atëherë vazhdojmë, por ndonjë efekt nga këto dy projekt-rezoluta nuk do të jetë nga asnjëra.

Urdhëro Elmi Reçica, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit, kryetar!

Unë po flas në emër të Komisionit Parlamentar për Punë të Jashtme.

Përsëritje, zoti ministër,

Përsëritje kolegë të nderuar,

Po shihet që të gjithë jemi të interesuar që ta kem liberalizimin e vizave, po shihet që secili i ka pretendimet e veta dhe i ka idetë e veta, por po shihet që nuk kemi marrëveshje konsensuale për të votuar një rezolutë.

Kështu që unë po flas për pjesën që e propozova si rezolutë. Kërkoj që në bazë të nenit 50.3 të Rregullores që ta tërheq nga diskutimi këtë çështje, e propozoj që të votohet për këtë çështje. Të deklarohen shifat e grupeve parlamentare dhe të gjithë të tjerët. Faleminderit!

KRYETARI: Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Ismet Beqiri, i njëjti propozim.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, kryetari Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryetar!

Ne në pjesën e parë të seancës provuam të arrijmë edhe u tregua qëllimi ynë të bëjmë një dokument, një deklaratë a një rezolutë, bile ka qenë edhe më mirë, më bindëse për Parlamentin Evropian, me një deklaratë e cila tregon një sinjal të përbashkët nga Parlamenti i Kosovës për gatishmërinë që ne të punojmë në drejtim të progresit në liberalizimin e vizave.

Kjo nuk është arritur, tash po shoh te unë një deklaratë që është arritur prej tri partive politike. Është pikërisht ajo që nuk është dashur të ndodhë sot. Sot është dashur ta nxjerrim një dokument të përbashkët.

Po flas në emër të Partisë Demokratike, ne mund ta votojmë deklaratën tonë e ta dërgojmë, por nuk ka kuptim një deklaratë me gjysmë ose me një pjesë, e pjesa tjetër të mos e votojë, aq më tepër me dy deklarata. Kështu që nëse nuk kemi një deklaratë të përbashkët, Partia Demokratike nuk është që asnjë version të deklaratës ta trajtojë. Faleminderit!

KRYETARI: Ismet Beqiri, kryetar i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, kryetar!

Propozimin realisht të mocionit nga zoti Reçica, që është mocion sipas rregullores, që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës, meqenëse nuk ka konsensus, ne kontaktuam edhe me zotin Pal Lekaj, shefin e Grupit Parlamentar të AAK-së, pastaj u bisedua meqenëse nuk ka konsensus, nuk ka edhe të mos them logjikë, po edhe vlerë, vlerësimi nuk do të dalë ashtu siç kemi dëshirë ne që të votohet, të mos them njëri apo tjetri version.

Kështu që ne si Grup Parlamentar e mbështesim mocionin dhe të votojmë pro që të hiqet nga rendi i ditës kjo deklaratë sot dhe të mos votohet asnjëri variant. Faleminderit!

KRYETARI: Grupi Parlamentar Lëvizja “Vetëvendosje”, Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Tregomë në fillim a do të ma ndalësh fjalën a të vazhdoj?

KRYETARI: Po, pasi kërkoje qartësim, krejt çka është në Rregullore, si keni kërkuar, kurrë s’do t’i ndalet fjala askujt, çka është jashtë Rregullores jam i detyruar ta ndal.

VISAR YMERI: Herën e kaluar ma ndale pa rregullore.

KRYETARI: Visar, nuk jam këtu privatisht për të mbajtur qëndrim, në bazë të rregullores, e thashë, je i lirë të flasësh çka të duash, po në bazë të Rregullores do të mbaj edhe qëndrim, me gjithë se vetë po kërkon, të gjithë.

VISAR YMERI: Pra, draft-deklarata, të cilën e kanë paraqitur tri grupet parlamentare, Lëvizja “Vetëvendosja”, AAK-ja dhe “Nisma”, ka pasur për qëllim të votohet në Kuvend, në mënyrë që të arrihet pikërisht kjo për të cilën u fol deri më tash. Pra, që të arrihet një lloj zotimi konsensual i të gjitha subjekteve parlamentare të Kuvendit të Republikës së Kosovës se do të angazhohemi në mënyrë që ta gjejmë një zgjidhje të duhur për shënimin e vijës kufitare në mes të Kosovës dhe të Malit të Zi dhe ky zotim pastaj institucional të shkojë edhe në Bashkimin Evropian, po edhe si bazë e fillimit të procedurave të trajtimit të kësaj çështjeje.

Po këtu nuk u arrit ky konsensus, sepse tri grupet parlamentare, ose më mirë të thuhet dy grupet parlamentare të koalicionin qeverisës, kishin qëndrim tjetër, të shprehur në deklaratën e mëhershme që e kemi parë këtu, e cila për mendimin tim nuk bën asgjë, përveç se konstaton faktin që ka mendime të ndryshme për sa i përket një çështjeje në Kuvendin e Republikës së Kosovës, po nuk ofron kurrfarë zgjidhje për këtë që mendoj unë do të ishte absolutisht e pavlerë edhe për Parlamentin Evropian, edhe për Komisionin Evropian, e që besa aq më shumë për vendet anëtare.

Do ta kemi parasysh që pajtim për liberalizimin e vizave natyrisht që ka nga secili subjekt politik, ne kemi mospajtim për shënimin e vijës kufitare, mënyrës si është bërë ajo mes Kosovës dhe Malit të Zi, me ç’ rast Kosova e humb një pjesë të territorit të vet. Ky është mospajtimi që e kemi këtu në Kuvend dhe prandaj edhe e kemi këtë çështje, të cilën e kemi diskutuar për një kohë të gjatë, për të cilën prapë koalicioni qeverisës ose, më mirë të thuhet Qeveria nuk po do që ta trajtojë.

Mua po më duket pak e çuditshme, sepse pjesët e këtij teksti që janë prezantuar sot rrjedhin nga një tekst, i cili është diskutuar të martën, ku keni qenë edhe ju në cilësinë e kryetarit të PDK-së dhe me të cilën aty, siç e mora vesh unë, ju jeni pajtuar. Kam qenë edhe unë, në fund ju u pajtuat me atë tekstin e propozuar për të nënshkruar si deklaratë e përbashkët të subjekteve politike, ku

thelbi i asaj deklarate tash është bartur në këtë. Tash unë po e di pse është e papranueshme kjo për Partinë Demokratike të Kosovës, kur kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës praktikisht u pajtua aty me një propozim që e patët ju atë ditë dhe që e përmendët edhe sot që të hiqet fjala “shqyrtim”, mirëpo thatë në fund unë e nënshkruaj edhe me fjalën “shqyrtim”, apo jo, në hotelin “Swiss Diamond” dhe tash po thua nuk pajtohem me këtë tekst. Është pak e çuditshme se si po pajtoheni e nuk po pajtoheni, varësisht prej klimës edhe motit.

Po, sido qoftë, ne jemi dakord që të tërhiqet kjo, meqenëse nuk ka dakordancë, të mos votohet asnjë prej deklaratave dhe të vazhdojmë me pika të tjera të seancës.

KRYETARI: Faleminderit! Për korrektësi, kemi qenë jo vetëm unë dhe ju si kryetar të partive, kanë qenë edhe ambasadat e huaja, dhe unë qëndroj prapë në atë çfarë kemi biseduar atje. Kam qenë dhe jam i bindur se më e mira për këtë vend është të tejkalohen dallimet tona për mënyrën që të krijohet një shpresë për liberalizimin e vizave.

Kam kërkuar që të paktën në qoftë se ishte qëndrimi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, shqyrtimi, përkatësisht insistimi, ja ku janë edhe kolegët e Aleancës, të ketë rishqyrtim, tash të paktën pse nuk e leni edhe “shqyrtimin”, të keni parasysh, isha i gatshëm, jo për hir të korrektësisë. Kanë qenë disa ambasadorë aty, nuk dua t’ua përmend emrat, keni qenë edhe ju, vetëm për korrektësi. Unë kam thënë pse nuk po e leni të paktën “shqyrtimi”, edhe “shqyrtimi i marrëveshjes”, të keni parasysh, cili është sot propozimi.

Për opinionin publik, në zgjidhjen e kontestit të demarkacionit me Malin e Zi përmes “rishikimit”, dallon “shqyrtim, rishqyrtim, shikim, rishikim”, thjesht, sido që të jetë, krejt çka jam duke u munduar ta bëj edhe nga cilësi si kryetar i Kuvendit, edhe si kryetar i PDK-së kam qenë në gjendje, edhe në qoftë se dëmtohem politikisht, ta arrijmë një konsensus të përbashkët për të dalë një marrëveshje. Po e shoh se as sot në Kuvend, e po frikohem as nesër me liderët e partive politike se s’do të mundë të arrijmë, edhe do t’i dënojmë qytetarët tanë në liberalizim vizash, si do të jetë. Kjo është Visar, në qoftë se nuk ka qenë kështu, fjala është juaja. Vetëm dëshirova ta qartësoj tek “shqyrtimi”. “Shqyrtimin” e kam pranuar.

Visar, jo vetëm, se është për hir të opinionit publik.

VISAR YMERI: Po, po kështu ka qenë, edhe kështu edhe unë e thashë. Mbase më ke keqkuptuar, po ashtu thashë unë. Aty “rishqyrtimi” unë e kam pranuar në atë takim “rishqyrtim” të jetë, sepse më duket plotësim i tekstit aktual, domethënë këtu ka qenë ndryshimi, edhe ju në fund keni thënë që e pranoni edhe “shqyrtimin”.

Pjesa tjetër e tekstit ka qenë e njëjtë.

KRYETARI: A e pranoni ju, se jemi publikisht, a e pranoni “shqyrtimin” të jetë, se ne do të takohemi prapë.

VISAR YMERI: Po, po, ne e kemi pranuar deklaratën para se të vijmë të martën në takim, ne kemi qenë të gatshëm ta trajtojmë atë.

KRYETARI: “Shqyrtimi”, mirë në rregull, mirë..

VISAR YMERI: Po, po dua të them që teksti i dakorduar ose gati sa i dakorduar i së martës dhe teksti që është paraqitur nga Komisioni për Politikë të Jashtme sot në Kuvend janë diametralisht të kundërta, pra nuk kanë asnjë ngjashmëri, këtu është thelbi i çështjes që do ta diskutojmë sot, jo çka kemi pranuar, çka s’kemi pranuar të martën. Atë e mora vetëm të tregoj se ka pasur dakordancë për një tekst deklarate të përbashkët, të cilën ju në fund e keni pranuar, i vetmi që s’e ka pranuar ka qenë Isa Mustafa, në cilësinë e kryetarit të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Sot e kemi këtu një tekst që është paraqitur nga Komisioni për Politikë të Jashtme, i cili është plotësisht i ndryshëm me atë që është diskutuar të martën.

KRYETARI: Faleminderit! Është korrektësi e Visarit çka tha. Ai që nuk u pajtua e ka qëndrimin jashtëzakonisht të qartë, burrëror, për këtë punë është kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj edhe s’ka ekuivokë, të mos ngatërrohet, ja ku është edhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, po ai nuk është pajtuar dhe kjo ka qenë situata. Pal Lekaj e ka fjalën.

PAL LEKAJ: Faleminderit, kryetar!

Sa i përket kësaj, të gjithë po pajtohem që jemi për liberalizim të vizave, jemi që qytetarët tanë të lëvizin lirshëm dhe të mos u mohohet kjo e drejtë.

Mirëpo, prapë më çudit fakti pse për dy shkronja kaq tepër po debatojmë, si “shqyrtim” si “rishqyrtim” i procesit, është njëjtë. Prandaj, në këtë drejtim bëhuni pak tolerantë dhe nëse doni konsensus me opozitën, me të vërtetë kjo do të ishte për të mirën e qytetarëve dhe ne, nëse e votoni këtë, hajde po e qesim dhe jemi, a e votoni? Po, atëherë hajde. Unë po të isha në vendin tuaj e kisha pranuar për dy shkronja. Prandaj, në këtë drejtim të jeni pak tolerantë. Faleminderit!

KRYETARI: Pal, shumë korrekt! Vetëm të kesh parasysh, në opinionin publik shumë shpejt do të lëshohen dy deklarata, unë nuk po i lexoj t’ju lodhim se janë shumë gjatë. Nuk kemi dakordancë, t’i tërheqim të gjitha grupet parlamentare. Zafir, nga “Nisma”, a dëshiron apo është ky pozicion. T’i tërheqim dy draft-rezolutat në qoftë se mundemi të merremi vesh ndonjëherë, merremi vesh, s’merremi vesh, e lëmë kështu. Zafir Berisha e ka fjalën.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryetar!

Në fakt, kërkoj ndjesë nga kolegët që u vonova pak.

Unë e thashë që këtë deklaratë as nuk është dashur ta futni hiq, po me që e keni futur, unë thashë që kjo nuk do të përfundoj dhe po shihet rezultati i saj.

Sido që të jetë, zoti kryetar i Parlamentit të Kosovës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë në emër të Grupit të “Nismës” do ta shfrytëzoj momentin, duke ju kërkuar ndjesë edhe një herë, për të folur për një çështje, të cilën po mendojmë se e kemi përmbyllur paradite.

Fjala është për “gjahun e shtrigave” kundër luftëtarëve të lirisë. Siç e keni vërejtur para pak momenteve në emër të drejtësisë vazhdon të bëhet padrejtësi ndaj luftëtarëve të UÇK-së, veçanërisht ndaj komandantëve të dëshmuar.

Kundër zotit Fatmir Lima vazhdon përndjekja e poshtër idiote e mbeturinave të regjimit të Serbisë me ndihmën e shqipfolësve, të kurdisin dosje për të cilët gjithë deputetët dje u pajtuan se në emër të drejtësisë vazhdon padrejtësia e madhe të bëhet luftës së lavdishme dhe ajo që është vlerë e këtij vendi.

Siç e keni parë, është ngritur edhe një aktakuzë pa kurrfarë baze, një aktakuzë për një përgjegjësi të kohës së luftës, të cilën nuk e ka pasur. Sipas logjikës të atyre mbeturinave që përgatisin dosje, komandanti i Policisë në Rahovec duhet të arrestohet pse s’e ka ndaluar vrasjen e Elvis Pistës. Sipas logjikës së atyre që po përpilojnë dosje për të zhvlerësuar luftën e drejtë të UÇK-së, vrasësi i Xhemajl Mustafës, komandanti i Policisë, Stacioni Pesë, duhet të arrestohet dhe të përgjigjet pse s’e ka parandaluar vrasjen. Kjo logjikë e poshtër, kjo injorancë që po bëhet në emër të drejtësisë në raport me luftën e lavdishme të UÇK-së mendoj se duhet urgjentisht zoti Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, të ndërpritet.

Përndryshe, ju dhe ne të gjithë në këtë rast, duke e përfshirë edhe veten, në rast se nuk marrim masa, ne këtë vend jemi duke e fundosur. Një vend fundoset kur nuk i ka themelet dhe ne themelet e këtij shteti jemi duke dashur që me qëllim t’i dëmtojmë që ky shtet të bëhet jofunksional, siç është dëshira e Serbisë dhe e vendeve jomike të Kosovës.

Prandaj, unë po mendoj se ky parlamentar, pavarësisht një rezolute pa ndonjë përgjegjësi dhe obligim që e kemi nxjerrë paradite, unë po besoj se seriozisht duhet rikthyer kësaj çështjeje.

Këtë rast nuk duhet marrë si rast i huaj, i ka ndodhur Fatmir Limajt e inshalla nuk më ndodh mua. Në rast se ne nuk ndërhyjmë, jo në drejtësi, po në padrejtësi që po bëhet, të mos harrojmë se të gjithëve mund të na vijë rendi në kuptimin e atyre që kanë luftuar. Nëse dje edhe vetë kryetari i parlamentit dhe dikush nga deputetët ka thënë se në kuadër të këtyre shantazheve dhe gjyqimeve të padrejta në emër të luftës dënohen edhe njerëzit që nuk janë hiq në luftë, imagjinoni 17 mijë luftëtarë të vërtetë, jo për ata që kanë hyrë në lista të fryra, për 17 mijë

luftëtarë të vërtetë çdo njëri është potencial i politikave të poshtra të dënohet, të dënohet edhe me një ëndërr që ka mundur ta shohë një skizofren apo edhe një mbeturinë ose barkqitje e sistemit të Serbisë që sot është duke punuar në organet e drejtësisë.

Apeli im edhe si deputet, edhe si qytetar, edhe si ish-luftëtar i UÇK-së, jo vetëm për Fatmir Limën, i cili ju e dini që nga paslufta është njëri më i përndjekur vetëm e vetëm për t'u eliminuar politikisht dhe qëndrimi i tij stoik për përbërjen e shtetit funksional, shtetit në shërbim të qytetarëve dhe shtetit model në rajon, domethënë me çdo çmim të eliminohet, si vazhdimin e rezistencës që e ka pasur para luftës, gjatë luftës dhe që e ka pas luftës për bërjen e shtetit.

Unë mendoj se aktakuza e kësaj prokurorie është në vazhden e pjellave të Serbisë që u bëhen luftëtarëve të lirisë dhe në rast se s'kemi qëndrim të qartë, ta dini se këto gjëra nuk do të përfundojnë kaq lehtë, siç dikush mund të pretendojë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në fakt, ne dje e kemi pasur një debat, i cili ka qenë shumë i rëndë, kemi kaluar një debat të rëndë pikërisht për këto çështje. Dua të jem shumë jashtë çështjeve të gjyqësisë, ajo çka ka qenë deklarata ndoshta më e veçantë e krejt seancës së djeshme ka qenë pikërisht deklarata e Fatmir Limës. S'do t'u ndihmojmë pikërisht atyre të cilët janë duke u akuzuar, janë dënuar, thjesht me veprimet tona këtu. Do të thotë, dua ta mbaj qëndrimin shumë larg interferimit, vetëm pak e rëndë në këtë aspekt, mund të kritikohem, ra menjëherë të nesërmen, kjo është e rëndë pak një farë forme. Nuk e di, të mos përshtjellim në interferim, sido që të jetë, zonja Mufera Serbica-Shinik, fjala për ju.

MÜFERA SERBICA-ŞINIK: Faleminderit, kryetar!

Vize muhafiyeti zaten çok gecikti. Ortaklaşa bir deklarasyon çıkarmadığından dolayı, "6+" Parlamenter Gurubu olarak gündemden bu konunun çekilmesinde fayda var diye düşünüyoruz. Teşekkür ederim.

KRYETARI: Nuk kemi një konsensus të plotë, do të tërhiqet për një herë tjetër kjo pikë e rendit të ditës. Ganimete Musliu, urdhëro, shpejt veç të lutem, se jemi në votim.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Sinqerisht edhe unë desha të ngre shqetësimin tim në lidhje me atë çka lexuam nëpër medie për deputetin Fatmir Lima dhe sinqerisht po them, u tha shumë herë gjatë kësaj kohe që po ndërhyjmë në drejtësi dhe konsideroj që edhe drejtësia ka filluar që të përzihet në fjalën e lirë.

Është komplet e pakuptueshme se të vijë një aktakuzë ose të ngrihet një aktakuzë pikërisht sot, pas fjalës së lirë që e foli Fatmir Limaj në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe shtrohet pyetja, a duhet ne që ta mbyllim gojën dhe ta ulim kokën dhe të mos guxojmë asnjëherë të flasim për fakte dhe të vërteta.

Prandaj, konsideroj që kjo që po ndodh në Kosovë me ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës është një e padrejtë që është duke ndodhur. Faleminderit!

KRYETARI: A e kryejmë një herë këtë pjesën e votimit, se jemi në vazhdim të seancës. Zonja Valdete, jemi në vazhdim të seancës, thjesht. Ta kryejmë këtë pjesë, formale është, vetëm ta përfundojmë.

Atëherë, a jemi të gjithë për, me ngritje dore për largimin nga pika e rendit të ditës të draft-rezolutave, të cilat i kemi pasur. Nuk ka kundër. Me shumicë absolute, më vjen keq!

Atëherë ajo pikë e rendit mbetet për ndonjë rast tjetër.

Zonja Valdete Bajrami, e ke fjalën.

VALDETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetar!

Në lidhje me deklarin dhe fjalimin e Zafirit, unë dua të jap një sqarim. Ju e dini që zoti Limaj, pikërisht është ai i cili i është përgjigjur çdo herë drejtësisë dhe ka kërkuar çdo herë që politika të jetë jashtë drejtësisë, Dhe sot po ashtu ne e paraqitëm një shqetësim tonin, të cilin e keni pasur edhe dje si debat, po ashtu edhe fjalimin e kryetarit Limaj, të cilët ju e potencuat.

Prandaj, kërkoj nga ju që të mos shtrihemi në debat në lidhje me këtë çështje dhe të jetë puna e drejtësisë. Mirëpo, kjo ishte një reagim i Grupit Parlamentar të “Nismës” në kuadër të aktakuzës, të cilën sot e keni marrë vesh të gjithë ju.

Prandaj, ju kisha lutur që ta ndërprisni këtë debat dhe të mos hyjmë më tutje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ide shumë e mençur, faleminderit! I kisha lutur edhe kolegët deputetë, se vetëm e dëmtojnë.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për faljen e borxheve publike

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Ftoj ministrin e Financave, zoti Abdullah Hoti, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin. Urdhëroni, zoti ministër!

MINISTRI ABDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

I nderuar kryeministër, ministër,

Të nderuar deputetë,

Ligji për faljen e borxheve publike ka hyrë në fuqi më 3 shtator 2015 dhe nga ajo datë personat fizikë dhe juridikë kanë mundur të përfitojnë nga falja e borxheve për një vit sipas dispozitave të parapara me këtë ligj.

Sipas të dhënave të raportuara në Ministrinë e Financave, borxhet e akumuluar deri më datë 31. 12. 2014 janë afër një miliard euro.

Konkretisht borxhet për periudhën 2000-2008 janë 632 milionë euro, ndërkaq për periudhën 2009-2014 janë 341 milionë euro.

Gjatë kësaj periudhe kanë përfituar 455 mijë e 276 persona fizikë dhe juridikë nga falja e borxheve nga Administrata Tatimore, nga komunat në tatim pronë, nga kompanitë rajonale të ujit dhe mbeturinave dhe ndërmarrjet e tjera që kanë qenë subjekt i këtij ligji.

Një numër i konsiderueshëm i personave kanë arritur ose të shlyejnë borxhet e tyre ose të bëjnë marrëveshje për riprogramimin e borxheve për pagesën e atyre borxheve në dy ose në tre vjetët e ardhshme.

Për periudhën 2009-2014 janë inkasuar mjetet në shumë prej 45.8 milionë euro si rezultat i këtij ligji, ndërkaq janë falur 214 milionë euro borxhe për këtë periudhë.

Gjatë këtyre dy muajve, shtator dhe tetor, ne vazhdimisht kemi pranuar kërkesa nga personat fizikë, nga qytetarët e vendit dhe nga kompanitë, ndërmarrjet private për vazhdimin e vlefshmërisë së këtij ligji edhe për një periudhë të caktuar.

Prandaj, duke pasur në konsideratë këto, ne kemi analizuar në Qeveri dhe propozojmë që të miratoni këtë projektligj për zgjatjen e afatit për faljen e borxheve deri më 15 prill 2017. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër!

Të nderuar deputetë,

Pas prezantimit të projektligjit, hap debatin për diskutim në parim. Në emër të Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa, zoti Naser Osmani, kryetar, e ka fjalën.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër, ministra,

Kolegë deputetë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 05/L-03 për faljen e borxheve publike dhe ka vlerësuar se projektligji i plotëson kushtet formale-juridike të përcaktuara me Rregulloren e Kuvendit për shqyrtim në lexim të parë.

Siç dihet, projektligji përmban tri nene që ka të bëjë me zgjatjen e afatit të mundësisë së aplikimit të faljes së borxheve publike edhe për 6 muaj, domethënë deri më 15 prill të vitit 2017.

Por meqenëse projektligji është proceduar me vonesë në Kuvendin e Kosovës, komisioni ka diskutuar se është e nevojshme që të zgjatet afati deri më 1 qershor dhe kjo do të propozohet gjatë amendamentimit.

Një çështje tjetër e rëndësishme që është diskutuar edhe në Komisionin për Buxhet dhe Financa që duhet rregulluar është çështja e institucioneve shtetërore, respektivisht ndërmarrjeve publike edhe përkundër faljes së borxheve, ato nuk mund të lirohen nga obligimet e tyre që ka të bëjë me tatime të ndryshme që janë krijuar si rezultat i këtyre borxheve dhe komisioni në diskutim e sipër ka vlerësuar që falja e borxheve duhet të jetë edhe ndaj këtyre institucioneve në proporcion me shumën e borxheve të falura dhe konsiderojmë që ne duhet në komision ta shqyrtojmë këtë mundësi që të hyjmë në ligjin bazik që të rregullohet kjo çështje në mënyrë që ndërmarrjeve publike të mos u mbeten borxhet e pamërituara.

Prandaj, komisioni u bën thirrje të gjithë deputetëve që ta aprovojnë projektligjin në fjalë, në kuptimin e saj që gjatë amendamentimit të kemi një ligj të mirë dhe të aplikueshëm. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Tani është radha e kryetarëve ose përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Nga Partia Demokratike e Kosovës, zonja Safete Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Ligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit numër 05/L043 për faljen e borxheve publike.

Në këtë ligj, në fakt, kemi të bëjmë vetëm me një nen që ka të bëjë me shtimin e afatit për faljen e borxheve publike.

Ne si grup parlamentar e përkrahim që të ndryshohet afati, domethënë pajtohemi me rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe me ligjin që e parasheh ndryshimin.

Megjithatë, ne si grup parlamentar do të japim kontributin tonë në Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe të bëjmë ndryshimet, të cilat është e nevojshme për t'u bërë në këtë projektligj, edhe pse ndoshta procedurat na e kufizojnë pak mundësinë që të ndërhyjmë edhe në nenet e tjera.

Unë po flas edhe si deputete, për të mos e marrë fjalën në mënyrë të veçantë për këtë projektligj.

Ne është dashur që edhe në momentin kur është miratuar në ligji si ligj, unë kam shprehur shqetësimin tim në Komisionin për Buxhet dhe Financa në lidhje me faljen e borxheve sidomos të disa bizneseve, të cilat kanë krijuar borxhe të mëdha në një periudhë duke mos paguar asgjë për shtetin e Kosovës dhe në momentin e caktuar ato janë falur nga borxhet që i kanë pasur për vite të tëra.

Atëherë, nëse duhet t'i falim disa, ngase nuk kanë paguar borxhet e tyre, atëherë a duhet t'i shpërblejmë disa të tjera, të cilat që nga dita e themelimit i kanë paguar të gjitha obligimet ndaj shtetit të Kosovës. Duhet të mendojmë edhe në këtë drejtim dhe të mos bëjnë favore të caktuara për disa biznese dhe për disa të tjera t'i dënojmë, ngase ata faktikisht kanë qenë shumë të përgjegjshëm dhe i kanë hequr të gjitha obligimet. Kanë menduar për shtetin e Kosovës, për forcimin e shtetit të Kosovës dhe i kanë kryer të gjitha obligimet, të cilat i kanë pasur ndaj shtetit.

Dua ta ngre edhe një çështje që mua më ka ardhur nga shoqatat e prodhuesve të materialit ndërtimor nga argjila. Këtu një numër i bizneseve janë ankuar, Shoqata prodhuese të materialit ndërtimor nga argjila është e shqetësuar me faktin se Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, si institucion shtetëror, nuk është i përfshirë në listën e institucioneve për faljen e borxheve.

Unë nuk e di arsyen pse këtu nuk janë përfshirë edhe këto biznese, meqenëse pjesa kryesore e këtyre borxheve janë gjopa administrative dhe ka të tilla që datojnë mbi 10 vjet, të cilat janë bërë pengesë shumë serioze për funksionimin normal të procesit të prodhimit të bizneseve, të cilat janë marrë me një biznes të tillë. Ndoshta kemi nevojë këtu për sqarime dhe nëse duhet të bëjmë ndryshime dhe të ndërhyjmë në ligjin bazë, atëherë duhet të ndërhyjmë edhe në këtë drejtim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nga Lidhja Demokratike e Kosovës, zoti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit! Unë në cilësinë e deputetit, në emër të grupit, e përkrah.

KRYETARI: A, në cilësinë e deputetit, atëherë jo, të kaloj njëherë radhën te grupet parlamentare. Nga LDK-ja nuk ka, do të thotë, e ka bartur qëndrimin kryetari i komisionit.

Atëherë nga Lëvizja "Vetëvendosje" i kam tre të lajmëruar, zonja Shqipe Pantina.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit!

Ministër, para dy-tre ditësh unë ju kam dërguar me shkrim një kërkesë lidhur me këtë projektligj, për të na sjellë fillimisht një raport për zbatueshmërinë e këtij ligji deri tani.

Arsyeja pse kam bërë kërkesë është se neve nuk na është prezantuar, siç prezantohet zakonisht në secilin projektligj, i cili kërkohet të plotësohet apo të ndryshohet, materiali përcjellës, ku është një memorandum në të cilin Qeveria shpjegon pse dëshiron ta ndryshojë atë ligj dhe dokumentet shtesë, siç janë opinionin nga Ministria e Financave për implikimet buxhetore.

Nuk është ligj i thjeshtë, ligji prek si qytetarët, ashtu edhe ndërmarrjet publike. Prandaj, para se na ta diskutojmë zgjatjen e afatit të faljeve të borxheve, është me rëndësi të diskutojmë përveç shumëve që është inkasuar deri më tani, që ju e thatë që është diku mbi 45 milionë, ne duam ta dimë cilat janë kompanitë, të cilat kanë përfituar nga falja e këtyre borxheve. A janë këto borxhe të falura vetëm taksa, apo tatime që i ka falur ATK-ja dhe doganat, apo edhe kompanitë publike.

Dhe, kur vjen puna te kompanitë publike, të cilat po ashtu do të falin borxhe, çështja është se këto kompani tashmë ka mundësi që kanë bërë planet e tyre, ku përfshihen, ta zëmë, planet investuese, ku do të mund të llogarisnin edhe nga të hyrat, nga borxhet që ata do t'i inkasonin.

Tash shtrohet pyetja se kush do t'i mbulojë këto borxhe? Çka do të ndodhë me këto kompani publike, të cilat presin ose kanë pritur të inkasojnë të hyra, por tashmë në to nuk mund të llogarisin, sepse janë të falura. Kush do t'i mbulojë ato? A do të jetë Qeveria përmes taksave të tjera që do t'i mbulojë? A do t'u ofrojë ndonjë kredi të butë apo si do të mund t'i mbulojnë humbjet që do të mund t'u shkaktohen këtyre kompanive nga falja e këtyre borxheve.

Por, mbi të gjitha ne duam të dimë se cilat janë këto kompani që kanë përfituar më së shumti nga falja e borxheve dhe pse kërkohen edhe gjashtë muaj shtesë. Një vit kanë pasur kohë si qytetarët, ashtu edhe kompanitë që të aplikojnë, nëse ju kërkoni të zgjatet vetëm afati i shqyrtimit të këtyre kërkesave, është një çështje tjetër, por nëse kërkoni që të shtyhet edhe afati dhe të mundësohen aplikime të reja, atëherë pse, ku ka qenë problemi? Nuk është bërë fushatë si duhet i njoftimit apo nuk ka pasur interesim për arsye të ndryshme.

Prandaj, pa na e sjellë një raport të detajuar se si ka shkuar ecuria e zbatimit deri më tani, ne nuk mund të japim pëlqimin tonë për zgjatjen e afatit të faljeve të borxheve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Bali Muharremaj, nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

BALI MUHARREMAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës e ka shqyrtuar këtë projektligj, megjithëse kemi dilema pak te personat juridikë dhe te personat fizikë, qysh mundemi, për shembull, tash t'i ndëshkojmë njerëzit që nuk kanë paguar dhe ata që kanë paguar.

Duhet ta gjejmë një metodë që këta që kanë paguar rregullisht të ketë një dallim mes tyre që s'kanë paguar. Është një dallim i madh mes personave juridikë dhe personave fizikë, megjithëse ne si grup parlamentar kontributin do ta japim në leximin e dytë, mirëpo ne jemi në parim për ta përkrahur. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Valdete Bajrami, bëhet gati zoti Damka.

VALDETE BAJRAMI: Gjithashtu edhe Grupi Parlamentar "Nisma për Kosovën" në parim do ta përkrahë këtë projektligj dhe kontributin e saj do ta japë përmes deputetit Enver Hoti, i cili është edhe anëtar i komisionit. Andaj, gjithë punën do ta japim gjatë leximit të dytë, kontributin dhe vërejtjet tona. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Damka, nënkryetar i Kuvendit.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

"6+" Parlamenter Gurubunun Kamu Borçların Affıyla ilgili Yasa Tasarısını incelediğini ve desteklediğini ifade etmek isterim. Özellikle, 1 Hazirana kadar bu borçların ödenmesi belki de önümüzdeki ikinci okunuşuna dek sunacağımız öneriler arasında sadece halkın ödemesiyle ilgili önerimiz olabilir. Bugüne kadar ödememiş olan şirketlerin bir daha bu fırsattan haksız bir şekilde faydalanması için önüne geçilmesi gerekir. Bu önerimizi "6+" Parlamenter Gurubu olarak Komisyona sunacağız.

KRYETARI: Faleminderit! Tani radha është e deputetëve, Armend, emri yt më nuk është, atëherë ArmendZemaj. Bëhet gati Visar Ymeri.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Është e qartë se ligji ka dhënë efektet e veta pozitive dhe ka pasurim pakt qoftë në pastrimin e borxheve të vjetra dhe riprogramimin e tyre, pavarësisht dilemave që ngrihen, se normalishtqë dikush mund të ndjehet edhe i diskriminuar, sepse ka qenë i rregullt në pagesën e tatimeve, por edhe të obligimeve që kanë derivuar nga ligjet pozitive.

Unë personalisht kam pasur shumë takime me njerëzit që jetojnë në diasporë dhe kërkesa e tyre ka qenë që t'i përshtatet edhe kohës, kur edhe ata janë për pushime në Kosovë, sidomos me pronat, të cilat i kanë blerë dhe kanë trashëguar edhe borxhe. Ky vit ka qenë një vit jo tamam efektiv, për të pasur një qasje pozitive dhe konstruktive që ata të mund të bëjnë riprogramimin e

borxheve dhe pagesat e tyre. Kërkesa ime është edhe propozim që do ta bëj me amendament, që afati të shtyhet deri më 1 shtator të vitit 2017.

Kjo arsye mbizotëron, sepse nga qershori ata fillojnë të jenë këtu dhe janë në mënyrë intensive dhe mund të kenë kohë, pavarësisht obligimeve, sepse të gjitha obligimet dhe lidhjet që i kanë me Kosovën ata mundohen që t'i kenë në atë periudhë kohore gjatë pushimeve të tyre. Kështu që unë do t'i propozoj Komisionit për Buxhet dhe Financa edhe tash, por edhe në mënyrë të amendamentit, sigurisht në harmoni edhe me sponsorizuesin dhe me politikat e tyre që ky afat të zgjatet deri më 1 shtator 2017. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Visar Ymeri e ka fjalën, Naser Osmani bëhet gati.

VISAR YMERI: Qëndrimet e Grupit tonë Parlamentar për sa i përket ligjit i shpalosi deputetja Shqipe Pantina. Unë vetëm dua ta bëj një propozim që mendoj se e bën seancën pak më interesante. Mendoj që tash meqenëse u kthyen edhe kryeministri, edhe ministrat, do të duhej që t'i kthenim edhe pyetjet parlamentare, që s'patëm mundësi t'i shtronim, sepse këta nuk ishin këtu. Këtë e them për dy arsye: një konsideroj se kjo Qeveri e cila qartazi as nuk ka vizion afatgjatë e as ndonjë qëllim për të bërë ndonjë të mirë në vend, po shihet se po i përsërit ligjet vazhdimisht me plotësim-ndryshime.

Pra, ne sot po e diskutojmë një ligj, i cili ka kaluar vitin e kaluar tash po duhet me plotësim ndryshim. Ky aspekti legjislativ nuk është duke ecur mirë për shkak të Qeverisë dhe mendoj që për ta bërë Kuvendin më efektiv, do të bëhej përmes monitorimit pra të pyetjeve parlamentare dhe, e dyta, arsyeja e dytë, pra, ka të bëjë me juve, Kadri Veseli. Mendoj që do të duhej pak ta balancojmë këtë, t'i gjuhemi pak edhe Isa Mustafës, se shumë t'u kemi gjuajtur ty.

Pra, kjo është arsyeja e dytë pse po i kërkoj pyetjet parlamentare për t'i kthyer.

KRYETARI: Visar, sot kah fundi e kemi rregulluar, u pajtuam edhe me deklaratë, mirë është puna. Në fakt, zoti Naser Osmani e ka fjalën, Faton Topalli pastaj.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Qëllimi i marrjes së fjalës sime për së dyti është për të bërë një sqarim. Shtyrja e afatit ka të bëjë vetëm me aplikim, që të aplikojnë për ata që s'kanë pasur mundësi të aplikojnë.

Ndërsa, falja e borxhit është vetëm deri më datën 31 dhjetor 2008. Po, kjo shtyrje me fjalën që e pati Armend Zemaj, vetëm më forcon që duhet të jepet një periudhë të mundësisë së aplikimit edhe për ata, të cilët s'kanë qenë në Kosovë për këtë periudhë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Topalli, fjala për ju.

FATON TOPALLI: Faleminderit!

Ajo që dua të shtroj është, dhe për këtë e kam pyetur edhe Agjencinë e Tatimit të Kosovës, fjala është për 185 milionë të arkëtuara, të cilat nuk janë paraqitur në pasqyrat e vitit 2014, ndërsa Dogana e Kosovës nuk ka paraqitur 10,1 milionë.

Pyetja ime për auditorin ka qenë: A janë pasqyruar këto mjete në raportet e vitit 2011-2012-2013? Pra, fjala është për tre vjet, të cilat këto mjete në njëfarë mënyre janë fshehur, sepse nuk janë pasqyruar fare në pasqyrat financiare.

Thjesht, ekziston një dyshim apo një dilemë që kjo fshehje e tatimit ka qenë e qëllimshme për të favorizuar ndoshta ndërmarrje, të cilat ndoshta kanë qëndruar afër pushtetit, ndoshta jo, por kjo fshehje më duket që është gabim, është e qëllimshme fshehja e mjeteve, të cilat nuk janë vendosur në pasqyrat financiare. Tjetra, që dua të them është kjo që po flasim për konkurrencën e lirë, ndërsa ndërmarrjet e caktuara po i favorizojmë, po flasim për një lloj barazie, por përpara ligjit nuk po dalin të gjithë të barabartë dhe, e fundit që dua të them është që po lejojmë që pikërisht ata që nuk e respektojnë ligjin, ata që nuk i respektojnë normat e caktuara të përfitojnë më shumë se sa qytetarët dhe ndërmarrjet e ndershme në Kosovë.

KRYETARI: Faleminderit! Ndërkohë Ismajl Kurteshi u lajmërua, urdhëro! Daut Haradinaj bëhet gati.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit! Ky ligj që në fillim ka qenë diskriminues për qytetarët dhe kompanitë e ndërgjegjshme, prandaj edhe atëherë nuk është dashur absolutisht të kalojë dhe tash unë jam shumë kundër që ky ligj të vazhdohet kështu edhe për gjashtë muaj.

Me këtë ligj janë inkurajuar ata të papërgjegjshmit që vazhdimisht kanë qenë të interesuar dhe tani janë të interesuar që vetëm ta shfrytëzojnë vendin dhe kurrë të mos i kryejnë obligimet ndaj tij. Mendoj që Qeveria është mirë këtu të raportojë se cilat janë efektet e këtij ligji edhe në kategori të caktuara, edhe në terriore të caktuara. Mua, për shembull, më intereson shumë se cilat janë efektet e këtij ligji në pjesën veriore të Kosovës dhe po ashtu nëse vetëm është vendosur t'i falen dikujt borxhet, atëherë do të duhej që të bëhet një klasifikim i borxhlinjve dhe borxhet t'i falen vetëm kategorisë e cila vërtet është në gjendje të rëndë ekonomike dhe jo secilit të papërgjegjshëm, i cili shpenzon shumë për luks, por nuk i kryen obligimet e tij ligjore. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Daut Haradinaj e ka fjalën.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryetar!

Në fakt, unë nuk desha të kyçem rreth ligjit ose propozimit, më shumë desha ta uroj kryeministrin për zëvendësin e ri dhe besoj që do të ketë lehtësime në të ardhmen, për zotin Ramiz Kelmendi. Suksese!

KRYETARI: Hajdar Beqa e ka fjalën dhe s'ka deputetë të tjerë për projektligjin.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryetar!

Përsëritje për Kabinetin qeveritar,

Kryeministrin,

Për kolegët deputetë,

Realisht unë konsideroj që ky ligj ka qenë me rëndësi të veçantë edhe kur ka qenë herën e parë për zgjatjen e afatit për faljen e borxheve, mendoj edhe tash duhet ta përkrahim formën qysh e ka propozuar Komisioni për Buxhet dhe Financa. Ndoshta ka qenë mirë, ishte ide e mirë ajo që tha edhe zoti Zemaj që të shtyhet afati i aplikimit deri në shtator. Ne e dimë që është pak diskriminues ndoshta për ata paguesit e rregullt, por megjithatë ky ligj ka pasur impakt te kompanitë apo te personat, të cilët kanë pasur gjendjen më të rëndë ekonomike dhe ndoshta shumë subjekte nuk kanë mundur të aplikojnë, sepse arsyeja pse s'kanë mundur të aplikojnë ka qenë se duhet t'i paguajnë borxhet nga 2008 deri në ditën kur aplikojnë.

Kjo ndoshta ka qenë edhe arsyeja se një pjesë nuk kanë mundur të aplikojnë. Unë mendoj që edhe ata të cilët i kanë pasur kushtet që të bëjnë pagesa nuk ndjehen diskriminues, sepse ne si legjislativ duhet t'i ndihmojmë kompanitë edhe personat, të cilët kanë nevojë për ndihmë dhe e përkrahim këtë ligj, me një zgjatje të mandatit. Mendoj që komisioni duhet ta harmonizojë ndoshta deri më 1 shtator apo 30 shtator që t'u jepet mundësia edhe qytetarëve, të cilët jetojnë në diasporë, ngase në kohën e verës ata i kanë pushimet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka më deputetë, kolegë të Qeverisë nuk kanë kërkuar fjalën. Po, ministri i Financave ndërkohë e dëshiron fjalën.

MINISTRI ABDULLAH HOTI: Po e ndjej për obligim vetëm një sqarim për deputeten Pantina. Ka dërguar kërkesën më 25 tetor 2016, e cila ka mbërritur në Ministrinë e Financave më datë 26 tetor 2016, dje e keni marrë përgjigjen me shkrim për kërkesën që keni bërë.

Besoj që sekretaria e Kuvendit ju ka dhënë përgjigjen me shkrim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Pantina, urdhëro!

SHQIPE PANTINA: Nuk e di si shkon procedura në Kuvend, sa kohë i duhet një letre. Unë para se të vij këtu e kontrollova edhe njëherë kutinë time, nuk ka ardhur përgjigja.

Kështu që deri tash nuk kam marrë përgjigje, por megjithatë, ministër, të faleminderit, por unë mendoj që atë përgjigje ndoshta duhet ta jepni për të gjithë deputetët, sepse secili do ta votojë. Pyetjet e mia nuk janë shqetësime personale, por janë shqetësime si deputete për të krijuar mandej vendimin a ta përkrahim zgjatjen e afatit apo jo.

KRYETARI: Faleminderit! Ministër, a dëshiron, po, po, urdhëro, ministër. Kuvendi punon ministër ekspres, veç ta kesh parasysh.

MINISTRI ABDULLAH HOTI: Ju e keni kërkuar përgjigjen si deputete, keni marrë përgjigje si deputete. Cilido deputet që kërkon përgjigje, e merr me shkrim, nëse flet ti në emër të Kuvendit, i përgjigjem normalisht secilit deputet në CC ia dërgojmë, por unë s'mund të bëhem sekretari e Kuvendit që t'ju sjell përgjigje juve.

Dje është protokolluar në Ministrinë e Financave dhe ju e keni marrë ose duhet ta keni marrë në bazë të evidencës. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, deputetët janë mësuar se ne punojmë ekspres. Faleminderit!

Atëherë, në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të këtij projektligji. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash.

67 deputetë kanë votuar. 53 janë për. 14 kundër. Asnjë abstenim. Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për faljen e borxheve publike.

Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Para se të kalojmë në pikën e radhës, zonja Valdete Bajrami ka kërkuar fjalën për një njoftim.

VALDETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetar!

Nëse më lejohet, kisha kërkuar nga ju një mirëkuptim, Grupi Parlamentar i "Nismës" e ka një kërkesë të ndërrimit të anëtarëve të komisionit dhe po mundët ta bëni, ta sillni në votim do të ishte mirë. Pasi pritët të ndërrohet Shukrija në atë pjesë.

KRYETARI: A ka mundësi veç ta lexosh, edhe unë e sjell menjëherë në votim.

VALDETE BAJRAMI: Po, Grupi Parlamentar i "Nismës për Kosovën" bën kërkesë të ndërrohen anëtarët e komisioneve parlamentare. Propozimet janë si në vijim: në Komisionin për

të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione tërhiqem unë, pra Valdete Bajrami dhe në vend timin propozohet deputetja Shukrije Bytyqi.

KRYETARI: Faleminderit! Të nderuar kolegë deputetë, duhet vetëm votim.

A ka kush kundër? Abstenim? Aprovohet!

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kamatë-vonesat në transaksionet tregtare

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Ftoj kryetarin e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, zotin Muhamet Mustafa, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin me rekomandime.

Para se ta marrësh fjalën, profesor, dëshiroj edhe një njoftim dhe t'i shprehim ngushëllime familjes së ish-drejtorit të Radiotelevizionit të Kosovës, Agim Zatriqi.

MUHAMET MUSTAFA: Raportin do ta paraqesë deputeti Raif Qela, në emër të komisionit, ashtu ka punuar në komision.

KRYETARI: Urdhëroni, zoti Qela. Zonja Shala Berisha-Shala e ka fjalën, e paraqet raportin.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Para se të flas për raportin, dëshiroj ta ndaj një gëzim me ju se Gjykata Kushtetuese e ka dhënë përgjigjen pozitive për Ligjin për “Trepçën”. Dëshiroj t'i uroj të gjithë minatorët e “Trepçës” në këtë rast. Me fat! “Indeks Online” po shkruan dhe të gjitha portalet.

Tani po hyj te raporti për Projektligjin për kamatë-vonesat. Projektligji për kamatë- vonesat, transaksionet tregtare është hartuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, ndërsa është aprovuar nga Qeveria. Qëllimi i këtij projektligji është parandalimi i vonesave të pagesave në transaksionet tregtare, si dhe përcaktimi i rregullave për afate dhe mënyrën e llogaritjes së kamatë-vonesave në raste të furnizimit me mallra dhe shërbime në mes të shoqërive tregtare ndërmjet veti ose në mes të shoqërive tregtare dhe autoriteteve publike, në mënyrë që të sigurohet funksionimi i duhur i tregut, duke nxitur aftësi konkurruese të shoqëritë tregtare.

Në këtë projektligj pritet të bëhet zvogëlimi i rasteve të vonimit të pagesave në transaksionet tregtare në mënyrë që të kontribuojnë në funksionimin e duhur të tregut dhe në konkurrencën e shoqërive tregtare. Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Tregti, Industri ka punuar në

këtë projektligj, grupi punues. Ky projektligj i ka kaluar të gjitha komisionet sipas procedurave të parapara me Rregulloren të Kuvendit. Prandaj, komisioni vlerësoi se Projektligji për kamatë-vonesa, transaksione tregtare në bazë të raportit të vetë amendamentues, të datës 20 shtator 2016 dhe në bazë të raporteve të komisioneve të përhershme, më 6 tetor 2016, vendosi t'ia paraqesë Kuvendit këtë raport me rekomandime.

Ky projektligj i ka 9 amendamente, prandaj i ftoj të gjithë deputetët që t'i votojnë amendamentet që parashihen me këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Të nderuar kolegë deputetë, në këtë projektligj nga Komisioni Funkcional janë propozuar 9 amendamente. Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhës së paraqitur në raportin e Komisionit Funkcional.

Aktualisht, sa deputetë janë? Thërrisni deputetët, ju lutem! 65 deputetë janë aktualisht në sallë. Janë 9 amendamente, nëse ka dikush vërejtje reagon. Unë do t'i vë të gjitha amendamentet së bashku.

Kush është kundër? A ka abstenim? Kalojnë nëntë amendamentet. 67 deputetë janë në sallë.

Votojmë tekstin e projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash.

Kanë votuar 69 deputetë, të gjithë janë për. Kuvendi e miratoi Ligjin për kamatë-vonesat në transaksionet tregtare.

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shërbimin mjekësor emergjent

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimi e tij me amendamentet e propozuara. Ftoj kryetaren e komisionit, zonjën Flora Brovina, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin me rekomandime.

FLORA BROVINA: Faleminderit, kryetar!

Ligji për emergjencat ishte për një kohë të gjatë në Komisionin për Shëndetësi, sepse që në fillim ne kishim dilemat tona që u shfaqën edhe në shqyrtimin e parë. Dhe, gjatë kësaj kohe ne ia mundësuam vetes që të konsultohemi me shumë ekspertë vendorë, qofshin të lëmit të mjekësisë, qofshin të lëmenjve të tjerë që mendonin se duhet të kyçen në çështjen e emergjencave edhe shëndetësore.

Pastaj vizituam disa vende të tjera që të shohim praktikën e tyre, si: Shqipërinë, Malin e Zi, Turqinë dhe konsultuam ligjet e shteteve që këtë çështje e kanë më të rregulluar, sikurse janë

shtetet e Bashkimit Evropian. Andaj, pas një pune shumë të gjatë dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, në konsultime me Ministrinë e Financave dhe me kryeministrin, ne nxorëm 42 amendamente që këtë ligj ta bëjmë sa më funksional dhe në favor të kujdesit shëndetësor emergjent të të sëmurëve, pacientëve, të lënduarve ose në raste të tjera emergjente më se të nevojshme.

Ky është një ndër ligjet strategjike dhe harmonizon disa ministri, siç janë: Ministria e Punëve të Brendshme, zjarrfikësit dhe Ministrinë e Forcave Mbrojtëse, bashkë me shërbimin shëndetësor dhe ka për qëllim që të ketë një qendër thirrëse që të mund të funksionojë së bashku. Gjithashtu, me këtë ligj parashihet që të mbizotërohet tërë territori i Kosovës, të ketë kujdesin emergjent shëndetësor, paraspitalor, që nuk e kishte në formën e parë. Dhe, mendohet se ky ligj në konsultim edhe me përvojat e të tjerëve, në konsultim me Ministrinë e Financave, u morëm vesh dhe me Komisionin për Financave, sigurisht, që ky ligj sipas përvojës së të tjerëve të ketë faza të implementimit, sepse është e pamundur që përnjëherë të realizohen të gjitha kërkesat.

Do të ketë një qendër thirrëse, në të cilën do të funksionojnë edhe Ministria e Mbrojtjes, edhe zjarrfikësit, edhe Ministria e Brendshme dhe shërbimi shëndetësor.

Janë 42 amendamente, të gjitha të harmonizuara edhe nga anëtarët e Komisionit për Shëndetësi dhe unë pres sikurse që kemi punuar në harmoni të plotë dhe në bashkëpunim edhe me Ministrinë e Shëndetësisë, ky ligj të votohet unanimitisht. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Besa Baftija e ka kërkuar fjalën.

BESA BAFTIJA: Faleminderit! Në parim ne pajtohemi që vendit tonë i nevojitet një ligj për shërbimin mjekësor emergjent. Ligj, i cili rregullon funksionimin e sistemit të emergjencave në tërë Republikën e Kosovës, ashtu siç e parasheh edhe projektligji, siç e tha edhe kryetarja e komisionit.

Mirëpo, para se të dalim te ky projektligj, vlen të theksohet se ky projektligj, siç tha edhe kryetarja, është fund e krye, është bërë një ndërrim në krahasim me projektligjin që e ka sjellë Qeveria në lexim të parë. Sa për informim, në lexim të parë, si subjekt, e kemi kundërshtuar dhe i kemi thënë Qeverisë që ta tërheqë këtë projektligj, po ashtu kemi kërkuar edhe nga pjesëtarët apo nga deputetët e Kuvendit që të votojnë kundër, për arsye se nuk i ka plotësuar kriteret që të jetë një projektligj apo një ligj për emergjencën.

Mirëpo, siç e dimë, ka kaluar në lexim të parë me 45 vota për, 19 kundër dhe 4 abstenime.

Pas leximit të parë komisioni, gjatë amendamentimit ndërmjet dy leximeve, në punën që e ka bërë, për të cilën e vlerësojmë, ka kuptuar se ky projektligj duhet të ndryshohet në tërësi. Kështu

që ka diku 42 amendamente, të cilat janë të ndryshuara dhe që do të thotë se qind për qind ligji është ndryshuar dhe nuk i përket ky projektligj Qeverisë, tanimë këtë e ka bërë Komisioni i Shëndetësisë.

Siç thashë edhe në fillim, të cilin e vlerësojmë. Mirëpo, siç e thashë, versionin e parë e kemi kundërshtuar, mirëpo tani po dua t'i paraqes disa hezitime, të cilat ne i kemi sa i përket këtij projektligji në votimin e tij apo jo, për të cilat pres përgjigje qoftë nga kryeministri, qoftë nga ministri i Shëndetësisë.

Ky version që e ka përgatitur komisioni, siç thashë, ka shumë për të konkretizuar dhe lë shumë për të dëshiruar. Kur e them këtë, po bazohem në atë se në memorandumin shpjegues të ndikimi buxhetor thuhet se kjo formë e këtij projektligji në aspektin financiar vlerësohet se përmban kosto shtesë buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës. Ku kostoja shtesë e paraqitur nga Ministria e Shëndetësisë nuk është e planifikuar në kornizën buxhetore 2015-2017. Prandaj, kjo kosto shtesë duhet të mbulohet nga institucionet përgjegjëse, nga Ministria e Shëndetësisë dhe SHSKUK.

E, në anën tjetër, projektligji qartë e precizon nenin 34, ku thuhet se shërbimi mjekësor paraspitalor financohet nga buxheti i Republikës së Kosovës, kontributet vullnetare dhe donacionet. Po ashtu, edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa gjatë shqyrtimit të këtij projektligji ka dhënë arsyetimin se kostoja buxhetore për zbatimin e këtij ligji është e papërbalueshme për buxhetin e Republikës së Kosovës dhe nuk mund të mbulohet nga buxheti i Republikës së Kosovës për tre vjetet e ardhshme.

Kështu që edhe pse e ka pasur komisioni një premtim apo një zotim të kryeministrit Mustafa, se ky projektligj do të implementohet shumë shpejt dhe do të zbatohet. Nuk e di si do të zbatohet, kur nuk ka implikime buxhetore, kur nuk dihet se sa do të kushtojë. Prandaj, unë këtu kisha dashur nga kryeministri ato zotime që i ka dhënë para komisionit, ta dimë në çfarë afati do të implementohen, sa është kosto buxhetore e këtij projektligji, në mënyrë që ne të vendosim se si do të veprojmë, a do ta votojmë apo jo?

Duke e ditur se edhe ligjet e mëparshme, siç është Ligji për odat, ka tre vjet që është votuar, mirëpo s'është implementuar ende. Kemi Ligjin për sigurimet shëndetësore që po ashtu janë bërë tre vjet. Prandaj, duam këtu nga ju që të na tregoni se kur do të implementohen, sa është kostoja buxhetore e këtij projektligji? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Brovina, fjala është për ju.

FLORA BROVINA: Faleminderit! Edhe pse është leximi i dytë dhe ndoshta nuk kemi nevojë për debat, ndoshta ka nevojë t'ju shpjegoj deputetëve, të cilët nuk kanë marrë tërë kohën pjesë në

punën e komisionit, por janë njoftuar se ligji duhet të shkojë si një ligj strategjik për vendin tonë, i cili, domethënë, jo vetëm që të ketë një shëndetësi emergjente, ashtu si e kanë shtetet e njohura kudo në botë, që kanë një shëndetësi të mirë, por është një ligj i domosdoshëm edhe për reformat në shëndetësi.

Ne kemi biseduar me kryeministrin dhe me ministrin e Financave dhe e dimë që ky ligj është i kushtueshëm. Por, njëherësh jemi marrë vesh që ligji do të zhvillohet etapë pas etape, në marrëveshje edhe me ministrinë e tjera, siç është Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Forcave Mbrojtëse, të cilat e kanë sistemin e informimit shumë mirë dhe do t'i bashkëngjitet edhe Ministria e Shëndetësisë. Do të këmbëjnë përvojat e tyre në një qendër të thirrjes.

Ndërkaq, qendrat emergjente nëpër regjione ashtu-ashtu janë dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Pushtetit Lokal, sa për fillim këto qendra edhe janë. Kuadrot, siç ju informuam dhe siç e dimë, po shkollohen në kuadër të ndarjes së specializimeve për emergjencë. Zaten, për çdo qendër janë ndarë nga 1 ose 2 specializime dhe po bëhen gati. Ne nuk kemi kohë të presim edhe shumë vjet që të organizohet ky shërbim, prandaj është në fillim të nisjes.

Nuk kemi mundur gjithashtu ta bëjmë buxhetin, por është në konsultim me Ministrinë e Financave që të shkojë fazë pas faze. Edhe shtetet e tjera, e përmend Suedinë, që ka filluar këtë sistem të organizimit, nuk e ka bërë gjithë zbatimin e ligjit në tërë territorin e vet menjëherë, por ka vetëm katër qendra të emergjencës. Edhe ne mund t'ia fillojmë prej disa qendrave, në mënyrë që ato pastaj të zhvillohen.

Në terren i kemi parë se disa qendra të tilla ekzistojnë, në kuadër të Qendrave Spitalore. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, zoti Ali Berisha nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e ka fjalën, jemi në përfundim, edhe zonja Bytyqi pastaj.

ALI BERISHA: Faleminderit, kryetar!

Rëndësia e këtij ligji dihet që është shumë e madhe dhe Komisioni Parlamentar i Shëndetësisë ka punuar gjatë në këtë ligj. Edhe ne si grup i deputetëve të Aleancës i kemi dilemat tona rreth mundësisë së implementimit të këtij ligji. Pasi që kostot financiare të zbatimit të këtij ligji janë jashtëzakonisht të mëdha, gjithashtu nevojitet një impakt bukur i madh dhe i rëndësishëm edhe i komunave dhe është një ligj që kërkon implikime multidisiplinare në zbatimin e tij.

Megjithatë, për shkak të rëndësisë dhe për shkak të mundësisë së zbatimit faza-faza të këtij ligji, Grupi Parlamentar i Aleancës do ta mbështetë këtë ligj.

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Shukrije Bytyqi, fjala për ju, zonja Baftija e ke kërkuar prapë fjalën apo gabimisht.

SHUKRIJE BYTYQI: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar “Nisma për Kosovën” e ka shqyrtuar me shumë vëmendje Projektligjin për shërbimin mjekësor emergjent dhe duke e ditur rëndësinë e këtij ligji dhe barrierat e deritanishme që ne t’ju dalim në ndihmë qytetarëve në rastet emergjente, pavarësisht implikimeve buxhetore dhe pengesave që do t’i ketë ky ligj, ne shpresojmë se institucionet, të cilat janë zotuar në përkrahje të këtij ligji vërtet t’i mbajnë zotimet e tyre.

Dhe, mendojmë se ky ligj është më se i nevojshëm për qytetarët e Republikës së Kosovës, prandaj Grupi Parlamentar “Nisma për Kosovën” do ta përkrahë këtë projektligj.

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Baftija, t’u kisha lutur që ta përfundojmë.

BESA BAFTIJA: Faleminderit! Unë nuk mora përgjigje qoftë nga kryeministri, qoftë nga ministri i Shëndetësisë, e ato që i tha deputetja Brovina ndoshta i ka marrë me fjalë si premtime, mirëpo ato nuk qëndrojnë këtu në projektligj.

Prandaj, unë kisha dashur që fazat e implementimit, koston buxhetore dhe pse në afat pas tre vjetësh do të implementohet. A do të implementohet pas tre vjetëve, ne jemi dëshmitarë se edhe ato projektligje që tanimë i kemi votuar po mbeten vetëm në sirtarë.

Nëse kanë mundësi të na japin këtë përgjigje, është shumë e nevojshme ta dimë. Edhe një fjalë, po dëgjoj nga deputetët që është në lexim të dytë. Po ju them se ky projektligj komplet është ndryshuar. 42 amendamente, prandaj është sikurse të ishte në lexim të parë. Ne kemi kërkuar që t’i kthehet Qeverisë dhe prapë të shkojë në dy lexime, mirëpo këtë nuk e keni bërë. Prandaj, është dashur që një vit e tepër të punojë komisioni që ta sjellë këtu në Kuvend. Faleminderit!

KRYETARI: Bota e mjekëve po lajmërohen sa më shumë, zoti Fadil Beka, zoti Baxhaku u lajmërua para jush kolegu juaj Fadil Beka, pastaj zoti Baxhaku, edhe zonja Time Kadrijaj. Është komunitet i fuqishëm, ka të drejtë, ende kemi për t’u forcuar me doktorë.

FADIL BEKA: Faleminderit, kryetar!

Unë kisha kërkuar që të shkojmë në votim, mirëpo para se të shkojmë në votim, në nenin 3 është përvjedhur një gabim teknik, kështu që është mirë të përmirësohet.

Domethënë te neni 3, pika 1.10, ku shkruan: “Infermierë i reanimacionit, personi i cili përveç shkollimit të mesëm ose të lartë është i trajnuar dhe i certifikuar me trajnimet e kujdesit themelor për shpëtimin e jetës për dhe kujdesin e avancuar kardiak për shpëtimin e jetës”. Këtu

domethënë, te versioni anglisht, te shkurtesat në gjuhën angleze është bërë gabim, nuk duhet të jetë “ASLL”, por “ASLS”. Domethënë, “Advance Cardiac Life Support”. Domethënë është përvjedhur ky lëshim teknik, përndryshe u bëj thirrje të gjithë deputetëve që ta votojnë.

KRYETARI: Faleminderit! Sa për korrektësi, versioni në gjuhën shqipe, në gjuhën serbe... urdhëro, zoti Baxhaku, edhe zonja Kadrijaj pastaj e keni fjalën.

HATIM BAXHAKU: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë nuk desha të marr pjesë në diskutim, meqenëse kryetarja e Komisionit Funkcional shumë mirë e sqaroi. Vetëm për hir të korrektësisë desha t’ju them që edhe në shumë vende evropiane të zhvilluara ky proces ka kërkuar 6 deri 10 vjet për t’u implementuar në tërësi në tërë vendin.

Dhe, ne nuk mund të fillojmë reformën në shëndetësi pa ekzistuar një bazë ligjore dhe organizimi i shërbimeve mjekësore emergjente moderne nuk mund të fillohet pa ekzistuar një bazë ligjore. Baza ligjore, e cila ekziston, nuk lejon asnjë mundësi që të modernizohet dhe të ndryshohet ky shërbim mjekësor emergjent. Sa i përket problemeve gjatë implikimit, mendoj që ne kemi paraparë edhe këtë problem dhe në nenin 31, pika 2 thuhet: “Deri në funksionalizimin e plotë të Qendrës Kombëtare të Shërbimit Mjekësor Emergjent dhe njësive të saja, shërbimet mjekësore emergjente paraspitalore ofrohen në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në komunat përkatëse”.

Prandaj, unë mendoj që nuk do të ketë asnjë problem në funksionimin e këtij sistemi dhe këtyre shërbimeve deri në funksionalizimin e plotë të këtij shërbimi të integruar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Time Kadrijaj, fjala për ju, dhe jemi në votim.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar!

Edhe herën e parë kur ka ardhur ky projektligj në komisionin parlamentar, vërtet kemi punuar shumë. Gjithë grupi parlamentar dhe gjithë komisioni parlamentar kemi organizuar edhe dëgjim publik, i kemi dëgjuar të gjithë ata mjekë, të cilët punojnë në kushte të vështira nëpër emergjencat e Kosovës.

Sadopak jemi munduar ta rregullojmë dhe të kërkojmë që të rregullohet infrastruktura në emergjencat e Kosovës, sepse e dimë se në çfarë gjendjeje është shëndetësia. Ky nuk është as ligji i parë kur të miratohet që nuk po gjen zbatim në praktikë, por është edhe mundësia e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit dhe, edhe ne si deputetë, por edhe komisioni parlamentar ka mundësi që pas 6 muajve të nënshkrimit të këtij projektligji t’i shohë fazat e zbatimit në praktikë të këtij ligji dhe në fakt të kërkojë përgjegjësi edhe prej Qeverisë, edhe prej dikasterit, pse s’po implementohet ky ligj në praktikë.

Andaj, unë po mendoj që sido që të jetë, ligji duhet të votohet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ky është mesazhi më i mirë.

Të nderuar kolegë deputetë, për këtë projektligj nga Komisioni Funkcional janë propozuar 42 amendamente, vazhdojmë me votimin e amendamenteve. Në qoftë se pajtoheni, shkojmë me 42 amendamentet përnjëherë.

Zoti Beka, doktor, versioni anglisht po thonë kompletohet me këtë shqip, se në gjuhën shqipe qenka në rregull. Në qoftë se është vetëm në gjuhën angleze, nuk vlen. Është standard. Merret edhe vërejtja parasysht.

Atëherë kemi 42 amendamente përnjëherë. Kush është kundër?

Abstenim?

Kalojnë 42 amendamente. 71 deputetë janë aktualisht në sallë.

Votojmë tekstin e projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

70 deputetë kanë votuar. 63 për, 7 abstenime. Kuvendi e miratoi Ligjin për shërbimin mjekësor emergjent.

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për profesionet e rregulluara në Republikën e Kosovës

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Ftoj kryetarin e Komisionit për Arsim, zotin Nait Hasani, që të paraqesë dhe të arsyetojë raportin me rekomandime. Zoti Salih Morina, në emër të komisionit, e merr fjalën.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Arsim, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport në pajtim me nenet 56,67 dhe 68 të Rregullores së Kuvendit, në disa mbledhje të mbajtura shqyrtoi Projektligjin për profesionet e rregulluara në Republikën e Kosovës.

Komisioni ka punuar dhe ka mbajtur disa takime, njëkohësisht ka mbajtur edhe dëgjime publike sa i përket këtij projektligji dhe kryesisht ndryshimet kanë ndodhur pikërisht tek neni 4, ku përpos profesionit, të cilat kanë qenë të rregulluara dhe të miratuara në leximin e parë të këtij

ligji, ne kemi marrë edhe përvojat e vendeve që i kemi në region, sidomos përvojën e Ligjit për profesionet e rregulluara të Republikës së Shqipërisë.

Si komision kemi futur edhe dy profesione të tjera, që ka të bëjë me ekonomistët dhe po ashtu, juristët. Dhe kanë ndodhur disa ndryshime të vogla, të cilat kanë qenë në disa amendamente, andaj unë i ftoj të gjitha grupet parlamentare që të miratojnë në lexim të dytë këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Përfaqësuesi i Qeverisë nuk ka kërkuar fjalën. Vetëm në votim, 15 amendamente. Zoti Bekim Haxhiu e ka kërkuar fjalën dhe e vëmë në votim pastaj.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit!

I nderuar kryetar, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike me ekspertët e saj të arsimit ka shqyrtuar këtë projektligj. Është një projektligj shumë me rëndësi, të cilin Ministria e Arsimit e ka sjellë dhe kemi shqyrtuar dhe përmes anëtarëve tanë të komisionit kemi dhënë kontributin tonë.

Është një projektligj, i cili vërtet pas përfundimi të shkollimit, qoftë në sektorin publik apo në sektorin privat, e krijon baraspeshën e studimeve dhe kërkon nevojën që t'i nënshtrohet provimit shtetëror për profesionet e rregulluara. Gjithsesi, me këtë projektligj që do të jetë një ligj i të ardhmes, parashihet që në të ardhmen të krijohet edhe Agjencia Shtetërore për Provime që vërtet do ta rritë cilësinë dhe kualitetin në përgjithësi në arsim.

Prandaj, ftoj të gjitha grupet parlamentare që ta mbështesin këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Teuta Haxhiu, ndërkohë ka kërkuar fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Edhe ne si grup parlamentar e përkrahim, edhe pse thjesht nuk kemi qenë pjesë gjatë punës në komision. Unë dyshoj në ekspertët apo në gjithë atë profesionalizëm që është bërë.

Megjithatë, po them qysh tani që unë jam Teuta Haxhiu për ata që nuk e dinë, Selvije. Kam të drejtë të dyshoj, sepse qysh tani ju them që zbatueshmëria e këtij ligji do të jetë shumë e vështirë, po ju them tash, për Selvijën dhe për ata që kanë dilema le ta caktojnë datën. Dyshoj në zbatimin e tij, thashë nuk kemi marrë pjesë, dihet edhe arsyeja jonë pse s'kemi marrë pjesë, nuk them që tani në mungesë, sepse ne kur kemi ardhur veç ka qenë përfundimi edhe në punën e komisionit. Jemi munduar të ndërhyjmë tek neni 4, por megjithatë thamë se zbatueshmëria e tij do të jetë shumë e vështirë.

Prandaj, janë dilemat e mia personale, në këtë rast, dhe të shohim në qoftë se me të vërtet do të gjejë zbatim ky ligj.

KRYETARI: Zoti Kurteshi nga Lëvizja “Vetëvendosje” ka kërkuar fjalën dhe zonja Shukrije Bytyqi. S’ka të tjerë. Në qoftë se, ka dikush le të lajmërohet, ose futemi në votim.

ISMAJL KURTESHI: Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” do ta përkrahë dhe do ta votojë këtë ligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Bytyqi e ka fjalën.

SHUKRIJE BYTYQI: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar “Nisma për Kosovën” me ekspertët e tij e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe mendojmë, se ky projektligj është më se i nevojshëm dhe me insistimin tonë, duke parë që pengesat më të mëdha janë pikërisht te konkurrenca jo shumë e mirë në mes kolegjeve private dhe Universitetit Publik, sidomos në mes juristëve dhe ekonomistëve dhe me kërkesën e Grupit Parlamentar të “Nismës për Kosovën” kanë hyrë, që edhe këto dy profesione në fund t’i nënshtrohen provimit përfundimtar.

Prandaj, ne si grup parlamentar do ta përkrahim këtë ligj, pavarësisht dilemave në të, por është mundësia e monitorimit dhe do të jemi shumë vigjilentë në atë, se sa do të implementohet ky ligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Jemi te votimi i amendamenteve të propozuara. Janë 15 amendamente. Në qoftë se, askush nuk ka kundër shkojmë në votimin e të pesëmbëdhjetave përnjëherë.

Sa deputetë janë në sallë aktualisht? 69 deputetë janë në sallë. A është dikush kundër? Abstenim? Kalojnë të gjitha amendamentet.

Votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

67 deputetë kanë votuar. 67 janë për. Kuvendi e miratoi Ligjin për profesionet e rregulluara në Republikën e Kosovës.

10. Emërimi i anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave

Komisioni për zhvillim ekonomik ka shqyrtuar propozim-vendimin e Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Përfaqësuesi i Qeverisë nuk ka kërkuar fjalën. Kryetari i Komisionit nuk ka kërkuar fjalën. Askush nga deputetët.

Kryetari i Komisionit, e dëshiron fjalën? Atëherë, të nderuar deputetë vazhdojmë me votimin e propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, si në vijim:

1. Arsim Berisha, kryesues;
2. Shkumbin Hyseni, anëtar;
3. Hilmi Ahmeti, anëtar; dhe
4. Gëzim Qerimi, anëtar.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Shkojmë edhe një herë të gjithë, do ta përmirësojmë votimin.

Të nderuar kolegë deputetë, do të votojmë edhe një herë. Regjia, të lutem të përgatitemi. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

69 deputetë kanë votuar, 59 për, 9 kundër, një abstenim. Kuvendi emëroi kryesuesin dhe 3 anëtarët e Bordit të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave me mandat 5-vjeçar.

Të nderuar kolegë deputetë,

Do të doja ta kem vëmendjen tuaj. Vendimmarrja juaj na krijon mundësinë të procedojmë në këtë propozim, i cili është pak më i veçantë për praktikën e votimit në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Ne kemi mundësi, kemi disa votime të cilat janë të fshehta. Kemi mundësi të shkojmë, në qoftë se ju pajtoheni, në maksimum Kuvendi ka mundësi teknike të procedojë përnjëherë tre votime të fshehta, janë tre fletëvotime, janë me ngjyra të ndryshme dhe janë tre pako, po ashtu që votohet për secilën ndaras.

Kryetarët e grupeve parlamentare dhe unë do ta vë në fund në votim përmes deputetëve, sado formale të jetë.

Kryetarët e grupeve parlamentare, në qoftë se u duhet pak konsultim, një minutë pauzë, vetëm sa për konsultim dhe pastaj ma jepni përgjigjen, po votimin do ta bëjmë gjithsesi, të gjithë deputetët, për arsye se është përgjegjësi.

(Dy minuta pauzë)

Kolegë deputetë, e vazhdojmë seancën. E di se jeni lodhur, por pastaj e kemi votimin e fshehtë. Menjëherë është edhe mundësia më e madhe edhe për të pasur pushim.

Kisha lutur edhe deputetët të kthehen në sallë, se në fund prapë do të votojmë, sido që të jetë. Ose, në qoftë se kryetarët e grupeve parlamentare, thonë se s'shkojmë në votim hiç, merret fjala e tyre dhe për këtë na jepni përgjigje.

Zoti Zenun Pajaziti nga Partia Demokratike e Kosovës.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryetar!

Ne mbështesim propozimin tuaj, që të shkohet me një votim të përbashkët, në mënyrë që edhe të kursejmë kohën dhe të jetë i njëjti komision, që pastaj t'i numërojmë votat për të gjitha propozimet.

KRYETARI: Jemi për pikën 11, 12 dhe 13, ta keni parasysh. Do të shkojmë në votim apo s'ka nevojë fare për votim. Qëndrimi juaj është për tërë grupin? Zoti Salih Morina.

SALIH MORINA: Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike mbështet këtë propozim tuajin, që të shkohet me të gjitha përnjëherë, po që se është mundësia.

KRYETARI: Atëherë, dy grupe nuk duan votim. Zoti Driton Çausi, në emër të "Vetëvendosjes".

DRITON ÇAUSHI: Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes "Vetëvendosje" është dakord, që të shkojmë me të tri votimet përnjëherë.

KRYETARI: Faleminderit! Pal Lekaj nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

PAL LEKAJ: Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës është që të shkohet në votim të përbashkët.

KRYETARI: Zonja Valdete Bajrami nga "Nisma".

VALDETE BAJRAMI: Po, kryetar. Edhe “Nisma për Kosovën” është për këtë shpejtim të procedurës.

KRYETARI: Faleminderit! Kujtim Paqaku, në emër të “6+”-it.

KUJTIM PAQAKU: Po, kryetar! Edhe Grupi Parlamentar “6+” propozon që të shkohet me tri votimet përnjëherë.

KRYETARI: Faleminderit. Atëherë, e kemi një procedurë dhe po e shoh se nuk dëshironi ta vëmë në votim. E kemi një procedurë, për të cilën është mirë që kryetarët e grupeve parlamentare vetëm të na japin anëtarët e komisionit. Komisioni formohet edhe për pikën e 14-të, ta keni parasysh pastaj, se 11-shin, 12-shin dhe 13-shin e përfundojmë tani. Këto janë mundësitë teknike, por pastaj vazhdon edhe për pikën e 14-të.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, anëtarin e komisionit?

ZENUN PAJAZITI: Propozojmë zotin Hajdar Beqa që të jetë anëtar i komisionit dhe kryetar njëkohësisht.

KRYETARI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i LDK-së?

SALIH MORINA: Grupi Parlamentar i LDK-së e propozon Murat Hoxhën, që të jetë anëtar i komisionit.

KRYETARI: Faleminderit! “Vetëvendosja”, zoti Çausi. Albulena Haxhiu. Zoti Pal Lekaj.

ALBULENA HAXHIU: Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e propozon deputetin Driton Çausi.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Pal Lekaj.

PAL LEKAJ: Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e propozon zotin Rrustem Berisha.

KRYETARI: Faleminderit! “Nisma për Kosovën”, zonja Valdete.

VALDETE BAJRAMI: “Nisma për Kosovën” e propozon deputeten Shukrije Bytyqi për komision.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Paqaku, urdhëro!

KUJTIM PAQAKU: Grupi Parlamentar “6+” e propozon zotin Fikrim Damka.

KRYETARI: Faleminderit! Le të zënë vendin anëtarët e komisionit. Ndërkohë, unë do t’ju mërzis. Më duhet për hir të protokollit vetëm t’i lexoj, me një ngritje dore.

Deputetë të nderuar kthehuni në sallë, vetëm që ta kemi votimin formal për komisionin, sepse duhet të kemi kuorum.

Ju lutem deputetëve, veç një minutë le të kthehen, na duhet për kuorum, pastaj janë të lirë.

(Ndërprerje e incizimit)

Të nderuar kolegë të komisionit,

(Ndërprerje e incizimit)

Ju lutem, vetëm uluni një minutë, se s’po mund të ju numërojnë, për shkak të kuorumit. Vetëm një minutë, që të mos vonohemi, as ju, as ne.

(Ndërprerje e incizimit)

64 deputetë janë në sallë. Jemi në votimin e anëtarëve të komisionit. A jeni për? A ka dikush kundër? Abstenim? Nuk ka. Të gjithë janë për, 64 deputetë.

Jemi në votimin e një anëtari të Këshillit Prokurorial të Kosovës; zgjedhjen e kryesuesit të Komisionit Shqyrtues në Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit dhe zgjedhja e zëvendës drejtorit të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit.

Shkojmë në votim. Deputetët për komision, ju lutem, komisioni le të zërë vend.

Zafir Berisha, Abdyl Ymeri, Adem Grabovci, Adem Hoxha, Adem Salijaj, Agim Ademaj...

Ismajl Kurteshi, Aida Dërguti, Agim Aliu, Agim Çeku, Agim Kikaj, Albin Kurti, Albulena Haxhiu, Ali Berisha, Ali Sadriu, Anton Çuni...

Arben Gashi, Armend Zemaj, Bali Muharremaj, Bardhyl Metaj, Bekim Haxhiu, Besa Baftiu, Besa Gaxherri, Besim Beqaj, Bislim Zogaj, Blerim Grainca, Blerta Deliu-Kodra, Bojan Mitiq, Qerim Bajrami, Danush Ademi, Daut Haradinaj, Donika Kadaj-Bujupi...

(Drejtimitin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti.)

KRYESUESI: ...Doruntina Maloku, Driton Çaushi, Duda Balje, Elmi Reçica, Enver Hoti, Ethem Arifi, Fadil Beka, Fatmir Limaj, Fatmir Rexhepi, Fatmir Xhelili, Faton Topalli, Fikrim Damka, Fisnik Ismajli, Flora Brovina, Ganimete Musliu...

Tutje: Gëzim Kelmendi, Glauk Konjufca, Hajdar Beqa, Hatim Baxhaku, Haxhi Shala, Ilir Deda, Ismajl Kurteshi, Ismet Beqiri, Jasmina Zhivkoviq, Jelena Bontiq, Kadri Veseli, Kimete Bytyqi, Kujtim Paçaku, Labintotë Demi-Murtezi, Lahi Brahimaj, Lirije Kajtazi, Luljeta Veselaj-Gutaj, Margarita Kadriu-Ukelli, Melihate Tërmkolli, Mexhide Mjaku-Topalli, Milazim Haliti, Milena Miliçeviq, Milka Vuletiq, Mirjeta Kalludra, Myfera Serbica-Shinik, Muhamet Mustafa, Murat Hoxha, Mytahir Haskuka, Naim Fetahu, Naim Hasani, Naser Osmani, Nenad Rashiq, Nezir Çoçaj, Njomza Emini,...

Nuredin Ibishi, Nuredin Lushtaku, Pal Lekaj, Puhije Demaku, Rafet Rama, Raif Qela, Rexhep Selimi, Rustem Berisha, Sabri Hamiti, Sadri Ferati, Safete Hadërgjonaj, Sala Berisha-Shala, Salih Morina, Sali Salihu, Salihe Mustafa, Sasha Milosavljeviq, Selviqe Halimi, Shaip Muja, Shpejtim Bulliqi, Shqipe Pantina, Shukri Buja, Shukrije Bytyqi, Sllavko Simiq, Slobodan Petroviq, Sërgjan Popoviq, Synavere Rysha, Teuta Haxhiu, Teuta Rugova, Time Kadrijaj, Valdete Bajrami, Veton Berisha, Visar Ymeri, Vjosa Osmani, Xhavit Haliti, Xhevahire Izmaqu, Zafir Berisha, Zenun Pajaziti.

Vëmendje, deputetë!

A ka dikush që është këtu e s'ka votuar ende. Ec, ec... Unë i kam thirrur të gjithë emrat, por ke mundur të mos e dëgjosh. Tjetër, a ka? A ka deputet që s'ka votuar, e është këtu?

(Pas votimit)

RRUSTEM BERISHA: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Për zgjedhjen e 1 anëtarit të Këshillit Prokurorial kanë votuar gjithsej 76 deputetë. Rezultati është ky:

- Naim Krasniqi,
- E pavlefshme,
- Shemsi Jashari,
- Ilir Dukolli,
- Naim Krasniqi,
- E pavlefshme,
- Shemsi Jashari,

- Shemsi Jashari,
- E pavlefshme,
- E pavlefshme,
- Shemsi Jashari,
- Shemsi Jashari,
- Shemsi Jashari,
- E pavlefshme,
- Shemsi Jashari,
- E pavlefshme,
- Shemsi Jashari,
- E pavlefshme,
- Ilir Dukolli,
- E pavlefshme,
- E pavlefshme,
- E pavlefshme,
- Shemsi Jashari,
- Shemsi Jashari,
- Naim Krasniqi,
- E pavlefshme,
- E pavlefshme,
- E pavlefshme,
- Shemsi Jashari,
- Ilir Dukolli,
- E pavlefshme,
- Naim Krasniqi,
- Shemsi Jashari,
- Shemsi Jashari,
- Ilir Dukolli,
- Shemsi Jashari,
- Naim Krasniqi,
- Shemsi Jashari,
- E pavlefshme,
- Shemsi Jashari,
- Shemsi Jashari,
- Shemsi Jashari,
- E pavlefshme,
- Ilir Dukolli,
- Naim Krasniqi,
- Ilir Dukolli,
- Shemsi Jashari,

- E pavlefshme,
- Shemsi Jashari,
- Shemsi Jashari,
- Naim Krasniqi,
- Ilir Dukolli,
- E pavlefshme,
- Naim Krasniqi,
- E pavlefshme,
- E pavlefshme,
- Ilir Dukolli,
- Shemsi Jashari,
- E pavlefshme,
- Shemsi Jashari,
- E pavlefshme,
- Naim Krasniqi,
- Shemsi Jashari,
- E pavlefshme,
- Shemsi Jashari,
- Shemsi Jashari,
- Shemsi Jashari,
- E pavlefshme,
- E pavlefshme,
- E pavlefshme,
- E pavlefshme,
- Shemsi Jashari,
- E pavlefshme,
- E pavlefshme,
- Shemsi Jashari.

KRYESUESI: Komisioni kurdo e kryeni punën, vazhdoni! Urdhëroni, paraqiteni raportin e Komisionit!

RRUSTEM BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Do t'i komunikojmë rezultatet e votimit për zgjedhjen e 1 anëtari të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Komisioni votues, pas procedurës së votimit të fshehtë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit për zgjedhjen e 1 anëtari të Këshillit Prokurorial të Kosovës, në seancën plenare, të mbajtur me 28 tetor 2016, konstaton:

- Në votim kanë marrë pjesë 76 deputetë.
- Të pavlefshme kanë qenë 29 vota.

Votat e fituara për kandidatin e propozuar, janë si në vijim:

- Kandidati Shemsi Jashari ka fituar 29 vota,
- Kandidati Ilir Dukolli i ka fituar 8 vota,
- Naim Krasniqi i ka fituar 9 vota.

Në bazë të procedurës, nuk kalon asnjëri kandidat në këtë rundë dhe shkojmë me rundin e dytë, me 2 kandidatë që janë të votuar. Në këtë rast janë Shemsi Jashari dhe Naim Krasniqi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Vazhdojmë tutje!

(Pas votimit)

KRYESUESI: Komisioni, urdhëro!

MURAT HOXHA: Atëherë, po vazhdojmë me numërimin e fletëvotimeve për zgjedhjen e zëvendës drejtorit të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit.

Pra, rezultati i votimit është, si vijon:

- Xhelal Selmani,
- Bashkim Halabaku,
- Xhelal Selmani,
- E pavlefshme,
- Xhelal Selmani,
- Bashkim Halabaku,
- Xhelal Selmani,
- Xhelal Selmani,
- Xhelal Selmani,
- Bashkim Halabaku,
- Xhelal Selmani,
- Xhelal Selmani,
- Xhelal Selmani,
- Bashkim Halabaku,
- Shelal Selmani,
- E pavlefshme,
- Xhelal Selmani,

- Xhelal Selmani,
- Xhelal Selmani,
- Xhelal Selmani,
- Xhelal Selmani,
- Xhelal Selmani,
- Xhelal Selmani,
- Xhelal Selmani,
- E pavlefshme,
- E pavlefshme,
- Bashkim Halabaku,
- E pavlefshme,
- Xhelal Selmani,
- Xhelal Selmani,
- Bashkim Halabaku,
- Xhelal Selmani,
- Xhelal Selmani,
- Xhelal Selmani,
- Xhelal Selmani,
- E pavlefshme,
- Bashkim Halabaku,
- Xhelal Selmani,
- Xhelal Selmani,
- Xhelal Selmani,
- Xhelal Selmani,
- Xhelal Selmani,
- Bashkim Halabaku,
- Xhelal Selmani,
- Bashkim Halabaku,
- Xhelal Selmani,
- E pavlefshme,
- E pavlefshme,
- Bashkim Halabaku,
- Xhelal Selmani,
- Bashkim Halabaku,
- Xhelal Selmani,
- Xhelal Selmani,
- Xhelal Selmani,
- Bashkim Halabaku,
- E pavlefshme,
- Xhelal Selmani,

- Xhelal Selmani,
- Bashkim Halabaku,
- Xhelal Selmani,
- Xhelal Selmani,
- Xhelal Selmani,
- Bashkim Halabaku,
- Bashkim Halabaku,
- Xhelal Selmani,
- E pavlefshme,
- Xhelal Selmani,
- Xhelal Selmani,
- Xhelal Selmani,
- Xhelal Selmani,
- Xhelal Selmani,
- Bashkim Halabaku,
- Xhelal Selmani,
- Xhelal Selmani,
- Xhelal Selmani,
- Xhelal Selmani.

Atëherë, Komisioni votues për zgjedhjen e zëvendës drejtorit të Autoritetit Rregullativ për Shërbimet e Ujit, pas numërimit të votave konstaton si vijon:

MURAT HOXHA: Votat e fituara për kandidatët e propozuar për zëvendës drejtor të Autoritetit Rregullativ për Shërbimet e Ujit, janë si në vijim:

- Bashkim Halabaku i ka fituar gjithsej 16 vota;
- Xhelal Selmani ka fituar gjithsej 50 vota, dhe
- 10 vota janë të pavlefshme.

Prandaj konstatojmë se Xhelal Selmani u zgjodh zëvendës drejtor i Komisionit Rregullativ për Shërbimet e Ujit. Urime!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë konstatoj se Xhelal Selmani u zgjodh zëvendës drejtor i Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit, me mandat pesëvjeçar.

(Ndërprerje e incizimit)

MÛFERA SERBICA-ŞINIK:

- Arsim Rashiti,

- E pavlefshme,
- E pavlefshme,
- Arsim Rashiti,
- Arsim Rashiti,
- E pavlefshme,
- E pavlefshme,
- Arsim Rashiti,
- E pavlefshme,
- Arsim Rashiti,
- Arsim Rashiti,
- E pavlefshme,
- Arsim Rashiti
- Arsim Rashiti,
- Arsim Rashiti,
- E pavlefshme,
- Arsim Rashiti,
- E pavlefshme,
- Arsim Rashiti,
- E pavlefshme,
- Arsim Rashiti,
- E pavlefshme,
- Arsim Rashiti,
- E pavlefshme,
- Arsim Rashiti,
- Arsim Rashiti,
- Arsim Rashiti,
- Arsim Rashiti,
- Arsim Rashiti,
- Arsim Rashiti,
- Arsim Rashiti,
- Arsim Rashiti,
- E pavlefshme,
- Arsim Rashiti,
- Arsim Rashiti,
- E pavlefshme,
- Arsim Rashiti,
- Arsim Rashiti,
- Goran Arsiq,
- Arsim Rashiti,
- Arsim Rashiti,
- Arsim Rashiti,

- Arsim Rashiti,
- Arsim Rashiti,
- E pavlefshme,
- E pavlefshme,
- Arsim Rashiti,
- E pavlefshme,
- E pavlefshme,
- Arsim Rashiti,
- Arsim Rashiti,
- Arsim Rashiti,
- Arsim Rashiti,
- Arsim Rashiti,
- Arsim Rashiti,
- Arsim Rashiti,
- Arsim Rashiti,
- Arsim Rashiti,
- Arsim Rashiti,
- Arsim Rashiti,
- E pavlefshme,
- E pavlefshme,
- Arsim Rashiti,
- E pavlefshme,
- E pavleshme,
- Arsim Rashiti,
- Arsim Rashiti,
- Goran Arsiq,
- Arsim Rashiti,
- Arsim Rashiti,
- E pavlefshme,
- Arsim Rashiti.
- E pavlefshme,
- Arsim Rashiti,
- Arsim Rashiti,
- E pavlefshme,
- Arsim Rashiti.

KRYESUESI: Urdhëroni!

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë, po i komunikojmë rezultatet nga votimi për zgjedhjen e kryesuesit të Komisionit shqyrtues të Autoritetit Rregullativ për Shërbimet e Ujit.

- Në votim kanë marrë pjesë 76 deputetë.
- Të pavlefshme ishin 24 vota.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar për kryesues të Komisionit Shqyrtues të Autoritetit Rregullativ për Shërbimin e Ujit, janë si në vijim:

- Arsim Rashiti ka fituar 50 vota,
- Goran Arsiq i ka fituar 2 vota.

Në bazë të rezultateve të votimit, në pajtim me nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 42 të Ligjit 05/L-042 për rregullimin e shërbimit të ujit dhe nenit 51 të Rregullores së Kuvendit, konstatohet se zoti Arsim Rashiti, zgjidhet kryesues i Komisionit Shqyrtues të Autoritetit Rregullativ për Shërbimet e Ujit me mandat trevjeçar.

Urime Arsim! Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit zoti kryetar i komisionit. Atëherë, në bazë të votimit konstatohet se zoti Arsim Rashiti zgjidhet kryesues i Komisionit Shqyrtues të Autoritetit Rregullativ për Shërbimet e Ujit, me mandat trevjeçar.

(Ndërhyrje)

Jemi duke pritur, të shohim sa deputetë janë të pranishëm! Pra, duhet të dimë a mund të vazhdojmë punën apo jo.

(Ndërprerje)

Të nderuar kolegë,

Në sallë janë 51 deputetë, prandaj nuk mund të vazhdojmë sonte. Në fillim të javës së ardhshme do të vendosë Kryesia do të vendosë kur do ta vazhdojmë mbledhjen. Faleminderit dhe mirupafshim!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, e filluar më 28 tetor 2016
Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Të nderuar zonja dhe zotërinj,
Ju lutem që t'i zini vendet tuaja! Pas betimit të dy deputetëve, ta jap fjalën.
Para se të fillojmë me rendin e ditës, ju njoftoj për zëvendësimin e dy deputetëve nga radhët e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës.

Me kërkesë të kryetarit të Kuvendit dhe me vendim të presidentit të Republikës së Kosovës është bërë zëvendësimi i dy deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, zoti Nehat Baftiu, kandidat i subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), zëvendëson ish-deputetin Fadil Demaku dhe zoti Fatmir Shurdhaj, kandidat i po të njëjtit subjekt politik, zëvendëson ish-deputetin Ramiz Kelmendi.

Betimi i deputetit është një veprim i paraparë me Kushtetutë dhe me Rregulloren e Kuvendit.

Tekstin e Deklaratës së betimit deputetët e kanë para vete dhe të njëjtit duhet ta nënshkruajnë personalisht.

Për të përmbushur detyrimin, u lutem deputetëve që të ngrihen në këmbë ta dëgjojnë tekstin që do ta lexoj unë dhe vetëm në fund ta shqiptojnë fjalën “betohem”.

“Unë, deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, betohem se me nder e me përkushtim do ta kryej detyrën time dhe do ta përfaqësoj me dinjitet popullin, do të punoj në interes të Kosovës dhe të gjithë qytetarëve të saj, do të angazhohem për mbrojtjen dhe për respektimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë, për mbrojtjen e tërësisë territoriale dhe të integritetit institucional të Kosovës, për garantimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, në përputhje me ligjet e vendit dhe me standardet evropiane. Betohem!” Faleminderit!

Unë ju uroj mirëseardhje në Parlamentin e Kosovës dhe uroj që të jeni aktivë gjatë gjithë kësaj legjislature dhe të keni konsideratë në Rregulloren e Kuvendit dhe Kushtetutën e Kosovës. Faleminderit!

Para se të hyjmë në rendin e ditës, fjalën e ka kërkuar zoti Visar Ymeri, kryetar i “Vetëvendosjes”.

VISAR YMERI: Qytetarë të Republikës së Kosovës!

Këtu sot në këtë sallë janë mbledhur deputetët që ta vazhdojnë punën normalisht, për të pretenduar se vërtet situata në Kosovë është normale, gjë që është maskim i asaj se çfarë vërtet

është duke ndodhur në Kosovë, edhe me ndjenjën që qytetarët e Republikës së Kosovës e kanë dhe po e ndërtojnë për çdo ditë karshi këtyre institucioneve.

Sot jemi në ditën e 10-të që kur Astrit Dehari, aktivist i Lëvizjes “Vetëvendosje”, i paraburgosur, ka vdekur në burg dhe tash e 10 ditë nuk kemi asnjë përgjegjësi më të vogël nga institucionet shtetërore, të cilat e arrestuan padrejtësisht, pa kurrfarë baze Astritin dhe e mbajtën në burg të privuar nga liria e pa minimumin e sigurisë. Pra, sot Astriti nuk jeton më sepse ishte i arrestuar, mbahej në burg dhe aty vdiq.

Përgjegjësia e shtetit këtu është e pashmangshme, përgjegjësia e institucioneve shtetërore është e pashmangshme. Pavarësisht rrethanave, shteti këtu duhet të japë përgjegjësi. Po ja që asnjë prej institucioneve shtetërore deri tash nuk e dha një përgjegjësi të tillë dhe ky Kuvend këtu dështoi edhe sot që të ngrihet në nivel të detyrës që si Kuvend përfaqësues i këtyre qytetarëve, e ne pretendojmë se i përfaqësojmë këta qytetarë, nuk diskutojnë gjënë më të rëndësishme dhe më të preokupuar sot në mendjet, zemrat dhe sytë e qytetarëve. Pra, vdekjen e një studenti, një të riu, një djali, një burri, një kapaciteti të jashtëzakonshëm në burg nën mbikëqyrjen e shtetit, ku qartazi ai nuk kishte siguri.

Astriti ishte arrestuar nën akuzën për terrorizëm, por asnjëherë arrestuesit dhe akuzuesit e tij nuk publikuan asnjë provë të vetme kredibile që do ta dëshmonte një gjë të tillë.

Astriti 68 ditë u mbajt në burg, asnjëherë nuk u intervistua nga hetuesi për akuzën, të cilën donin t’ia vishnin.

Pra, Astriti mbahej në burg vetëm që të mbahej në burg një aktivist politik, një kundërshtar i këtij regjimi kriminal.

Astriti në punën e tij i jepte zë popullit, ndërkohë që ky institucion, ky regjim antipopullor Astritit donte t’ia ndalte zërin, në mënyrë që ai të mos i jepte zë popullit.

Menjëherë pas vdekjes së Astritit kemi pasur deklaratat e para të institucioneve shtetërore, i pari ka folur Komandanti rajonal i Policisë në rajonin e Prizrenit, në burgun e të cilit mbahej Astriti dhe deklarata e tij ishte skandaloze.

Nexhmi Krasniqi tha që Astrit Dehari ka vdekur për shkak të përdorimit të mbidozuar të medikamenteve dhe kjo paska qenë shkak i vdekjes, një orë e gjysmë pas vdekjes së Astritit.

Raporti i obduksionit pastaj e dëshmoi këtë deklaratë të rreme, pra kjo ishte gënjeshtër e Nexhmi Krasniqit, Komandantit rajonal të Policisë dhe kjo gënjeshtër nuk ishte e rastësishme, nuk është se i rrëshqiti goja këtij. Ky këtë e tha që ta orientonte opinionin publik, pra e tha që ta fshehte të

vërtetën, sepse Nexhmi Krasniqi ishte i pari që doli në front për ta mbuluar të vërtetën për vdekjen e Astritit. Që prej atëherë kemi pasur deklarata kontradiktore dhe të tjera. Shërbimi Korrektues e thoshte një gjë, prokurori e thoshte një gjë tjetër dhe të gjitha këto më shumë donin propagandë mediatike sesa që shprehnin interesim për ta zbuluar dhe zbardhur të vërtetën për vdekjen e Astritit.

Pastaj, kjo vazhdoi me rrjedhje të informatave. Përkundër faktit që prokurori, kryeprokurori i Prokurorisë Themelore të Prizrenit deklaroi publikisht dhe u zotua që provat dhe dëshmitë për vdekjen e Astritit janë të siguruara, ato filluan të dalin nëpër medie pa iu dorëzuar as avokatit të angazhuar nga familja, pa iu dorëzuar as familjes, askujt tjetër, por u publikuan në medie.

Kështu, pra, Prokuroria, hetuesia në këtë rast, u bë pjesë e propagandës politike, pjesë e propagandës për ta çorientuar opinionin publik dhe kështu për ta vazhduar avazin e kryerjes së gjyqimeve në publik, në vend se ato të ndodhin aty ku duhet.

Kjo e bën këtë hetim absolutisht jokredibil dhe të papranueshëm. Mënyra se si është administruar ky hetim deri tash tregon qartë që hetuesit aty nuk janë të interesuar ta zbardhin të vërtetën, por janë të interesuar ta orientojnë opinionin publik andej kah ata duan dhe, natyrisht që opinionin publik këtë gjë nuk është duke e blerë.

Qytetarët e Republikës së Kosovës sot e kanë humbur absolutisht besimin në një mundësi të hetimit të pavarur dhe të drejtësisë për Astritin nga këto institucione.

Dhe, ky Kuvend këtu sot po ua dëshmon të njëjtën gjë. Pengesat që janë vendosur për ta organizuar, për ta thirrur një seancë të jashtëzakonshme, të iniciuar nga Lëvizja “Vetëvendosje”, ku do të diskutojmë për këto çështje, ku do të diskutojmë për administrimin e provave, ku do të diskutojmë për përgjegjësinë e shtetit, nivelin e kësaj përgjegjësie karshi rastit, shtojnë edhe më shumë dyshimet se e vërteta për vdekjen e Astrit Deharit duhet të fshihen. Pra, këto institucione, kjo hetuesi, ky shtet i kapur nuk mund të prodhojë drejtësi për Astritin, sepse ky shtet i kapur faktikisht nuk po prodhon drejtësi për qytetarët e Republikës së Kosovës, ky shtet i kapur është përgjegjësi e këtyre njerëzve që e kanë veshur veten me pushtet dhe e kanë kapur shtetin.

Fatkeqësisht, edhe ky Kuvend sot dështoi të jetë Kuvend, i cili i përgjigjet zërit të qytetarëve, por u bë Kuvend i manipuluar nga Kadri Veseli me shokët e tij. Kjo është fatkeqësia e këtij vendi. Pra, ku qytetarët nuk e kanë as minimumin e përfaqësimit, as minimumin e realizimit të cilësdo të drejtë përmes sistemit politik dhe juridik, të ndërtuar në këtë vend.

Prandaj, ky regjim ka instaluar një administratë publike, e cila çdoherë e më shumë po shndërrohet në një shtet antipopullor, jo Republikë, po shtet që e lufton popullin e vet, që vihet kundër këtij dhe i cili, siç ishte në rastin me Astritin, e mbyti atë, e privoi nga jeta.

Këto do të duhej të ishin temat e diskutimit për këtë seancë, të cilën ju e penguat, të cilën ju nuk deshët ta mbani dhe kjo situatë, kjo gjendje në të cilën ka ardhur Republika e Kosovës dhe institucionet shtetërore të saj. Natyrisht që qytetarët e Republikës së Kosovës do të insistojnë në drejtësi për Astritin dhe drejtësia për Astritin do të bëhet, mirëpo jo me këtë shtet të kapur, sepse kjo është e pamundur.

Prandaj, edhe një herë Kuvendi i Republikës së Kosovës e ka për obligim që ta diskutojë këtë çështje, e ka për obligim të kujdeset që institucionet e tjera nuk po ua shkelin të drejtat qytetarëve të Republikës. Tek e fundit, ky Kuvend i Republikës e ka një obligim të vetëm dhe ne si deputetë, si pjesë e tij, e obligimi është që t'i përfaqësojmë interesat, që ta përfaqësojmë zërin e qytetarëve. Zëri i qytetarëve në rrugë kërkonte drejtësi për Astritin, ju po doni ta fshihni atë drejtësi, ta pamundësoni atë drejtësi ose ta fshihni shkeljen që institucionet që do të duhej të prodhonin drejtësi për qytetarët nuk po e bëjnë një gjë të tillë, përkundrazi po duan që përmes luftës propagandistike ta bindin ndryshe qytetarin. Dhe, ky Kuvend nuk duhet të bëhet pjesë e këtij shteti të kapur. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar edhe zoti Daut Haradinaj.

DAUT HARADINAJ: Kryetar, nuk po e zgjas shumë.

Por e vërteta është edhe për opinion publik se ne edhe si Aleancë, por edhe unë personalisht e kam dhënë nënshkrimin dhe jemi për një debat, sepse mendoj që transparenca i ndihmon edhe Kuvendit, edhe drejtësisë.

I kemi shprehur shqetësimet tona qysh ditën e parë kur ka ndodhur rasti dhe mendoj që sa më shpejt organet e drejtësisë duhet ta japin fjalën e vetë për shkak se po krijojnë amulli, e para. E dyta, edhe sot këtu ku jemi, do të ishte mirë që ministrja e Drejtësisë të ishte në sallë këtu dhe të na tregonte se deri ku kanë shkuar procedurat, çfarë ka ndodhur, sepse qëndrimet mish-mash, nëse guxoj t'i quaj ashtu, herë të zyrtarëve policorë, herë të Prokurorisë, herë të hetuesve, herë të drejtorit të burgut, kanë krijuar amulli, e cila me të drejtë ngre shqetësim te qytetarët.

Prandaj, mendoj dhe dëshiroj edhe unë, jo t'i bashkëngjitëm, por mendoj që drejtësia i bën nder edhe Kuvendit edhe Kosovës, edhe mendoj që krejt deputetët e Parlamentit të Kosovës duhet ta hapin diskutimin, le të debatohet, le të kërkohej e vërteta rreth këtij rasti. Nuk po zgjatëm më shumë, por krahas indinjatës që të gjithë e kemi, që si njerëz dhe si prindër e kemi bashkë ndjerë humbjen e Astritit, mendoj edhe për familjen e tij, sepse i është bërë dëm i madh, sepse kemi dëgjuar dhe besoj edhe ju e dini që ajo familje e ka humbur edhe një djalë një vit më herët, por në mungesë të drejtësisë sot po krijohet një pasiguri, jo vetëm për rastin "Dehari", por për të gjithë ata burra dhe gra që sot janë nëpër qendrat e sigurisë në mbajtje.

Në rast se shteti ka diçka që të fshehë, atëherë mbylleti debatin. Në rast se nuk për të fshehur diçka, hapeni debatin, le të diskutojnë deputetët, le të vijnë zyrtarët e qeveritarët këtu, le t'i ftojnë edhe përfaqësuesit e sigurisë, qofshin ata të korrektësisë, apo të policisë, dhe ta marrim një përgjigje sa më të shpejtë që të jetë e mundur. Në rast se kanë përgjegjësi ata zyrtarë atje, edhe ata le të përgjigjen para drejtësisë, sepse drejtësia, në fund të fundit, duhet të jetë e barabartë për të gjithë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, Daut! Fjalën e ka kërkuar edhe zoti Zafir Berisha, në emër të "Nismës".

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Natyrisht se edhe ne si grup parlamentar kemi qenë shumë të interesuar që të mbahet një debat rreth rastit, i cili e ka tronditur çdo qytetarë normal të këtij vendi dhe unë e mora fjalën për të thënë atë se edhe ne jemi pjesë e këtij Kuvendi, por nuk jemi pjesë e asaj që e ka bllokuar debatin, sepse zoti Ymeri iu referua Kuvendit.

Ne deputetët e "Nismës" sigurisht që jemi të interesuar baras si të gjithë qytetarët, familja Dehari dhe Lëvizja "Vetëvendosje" që çështja e studentit që e humbi jetën në Burgun e Prizrenit të bëhet publike, transparente, me idenë që qytetarët e këtij vendi të ndihen komodë kudo që janë, e veçanërisht kur janë në duart e institucioneve. Moszgjidhja tash e sa ditë e kësaj enigme natyrisht se lë vend për të dyshuar, prandaj përgjegjësit e institucioneve të sigurisë, të burgjeve, Ministria e Drejtësisë e kështu me radhë është mirë që të përgjigjen para opinionit dhe kërkesa jonë për një debat ka të bëjë me atë që të hapet ajo Kutia e Pandorës karshi opinionit që të mund ta kuptojmë të vërtetën e madhe rreth rastit "Dehari". Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Zenun Pajaziti, në emër grupit parlamentar, e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të nderuar të Republikës së Kosovës,

Dëshiroj të shpreh dhimbjen tonë për vdekjen e zotit Astrit Dehari. Dëshiroj po ashtu t'i shpreh ngushëllime familjes Dehari. Duhet ta përkujtojmë që familja Dehari është një familje patriotike që ka kontribuar shumë për ditët e sotme.

Është një tragjedi që i ka ndodhur asaj familje dhe një dhimbje e madhe për të gjithë ne dhe qytetarët. Unë sot kërkoj që, duke ndjerë po ashtu, jemi të interesuar të gjithë që sa më shpejt të ndriçohet nga organet përkatëse kompetente vdekja e Astrit Deharit dhe kërkojmë nga Ministria e Drejtësisë, nga të gjitha institucionet në zinxhir që kanë përgjegjësi, që të dalin sa më shpejt me të dhënat, me provat, argumentet, me përfundimin për të sqaruar gjithçka rreth kësaj vdekjeje.

Po ashtu, shfrytëzoj rastin të kërkoj edhe nga institucionet përkatëse: Policia, prokurorët, avokatët, të gjithë, që të përmbahen nga deklaratat që nuk i kontribuojnë kësaj situatë. Gjithçka që duhet të bëhet duhet të lihet dhe duhet të kërkohet që sa më shpejtë organet kompetente të dalin me sqarime. Edhe ne jemi të interesuar të debatojmë, por do të ishte keq, nuk do t'i ndihmonim as familjes në këto ditë të rënda për të, nëse ne sot bëjmë politikë, ose politizojmë, ose bëjmë anime politike, ose e bëjmë drejtësinë para organeve të drejtësisë.

Unë jam i prirë që t'u besoj institucioneve të drejtësisë, kërkoj mbështetje edhe nga institucionet tjera që mund t'i ndihmojnë institucionet e drejtësisë, në mënyrë që këto rezultate të sqarojnë gjithçka dhe ne këtu të mos e bëjmë organin e drejtësisë dhe po ashtu të mos ndikojmë, qoftë në sqarimin e këtij rasti, qoftë edhe në procedurat ose proceset gjyqësore që janë ndaj atyre, që mund të jenë të hetuar ose të trajtuar nga institucionet e drejtësisë.

Edhe një herë po them, me kërkesën që sa më shpejtë të dalin rezultatet nga institucionet përkatëse, i shprehim edhe një herë ngushëllime familjes Dehari. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, Visar debat nuk ka. Ju e keni dhënë fjalën në emër të grupit parlamentar, për procedurë po. Për procedurë ka të drejtë, më fal! Le ta kryejë edhe Ismet Beqiri në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së.

Zotit Beqiri, ju lutem!

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Edhe unë, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, sigurisht që shpreh dhimbjen dhe bashkëndejmë me familjen dhe e shfrytëzojmë rastin që t'i shprehim ngushëllime familjes Dehari për një rast që është tragjik dhe i dhimbshëm dhe po ashtu kërkojmë që organet kompetente sa më shpejt të dalin me rezultatet e autopsisë dhe ato që janë në përgjegjësinë e tyre dhe pa dyshim që puna profesionale dhe angazhimi që këto rezultate të dalin sa më shpejt bën që të ketë sa më pak mundësi nga kushdo qoftë që rasti si i tillë, shumë i dhimbshëm, shumë i ndjeshëm, në një mënyrë të përdoret, gjë që është shumë e rëndë dhe nuk dëshiroj as ta them për qëllime tjera, sepse jam i bindur shumë dhe të gjithë ne të tjerët që rastet e tilla janë raste shumë të rënda, për të cilat organet kompetente kanë përgjegjësi, kanë obligim t'i zbardhin deri në fund.

Nuk ka qytetarë të Kosovës dhe as ne si subjekte politike që nuk ka interesim që të dalë e vërteta. Dhe, e vërteta do t'i bartë me apo pa përgjegjësi të gjithë ata që në këtë zinxhir të punës së tyre institucionale e kanë obligim përkujdesjen ndaj të gjithë atyre qytetarëve brenda apo jashtë burgut. Por, edhe një herë e them me kompetencë të plotë, që ne dëshirojmë, kërkojmë dhe apelojmë njëkohësisht që kjo të ndodhë sa më shpejt dhe kjo e vërtetë të bëjë sa më shumë që është e mundur qetësimin në një mënyrë, edhe pse jo heqjen e dhimbjes për familjarët dhe të tjerët, por sqarimin e të gjithë asaj se çfarë në realitet ka ndodhur.

Prandaj, zoti nënkryetar, këtë e thashë në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Beqiri! Zoti Konjufca e keni fjalën për procedurë.

GLAUK KONJUFCA: Unë vetëm dua të filloj që çështjen ta shtroj nga domosdoshmëria që ky Kuvend të diskutojë për rastin "Dehari".

Dhe kam dëgjuar këtyre ditëve shumë mendime, si ky që e dha Ismet Beqiri, apo më herët Zenun Pajaziti, por edhe nëpër medie të ndryshme, se nuk bën të politizohet kjo çështje dhe nuk bën të përfitojë askush nga kjo. Mendoj që kjo e fsheh një interpretim të gabuar dhe qëllimisht të devijuar të çështjes, të cilën ne duhet ta diskutojmë për Astritin. Pse?

Për arsye se Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet të diskutojë dhe ka të drejtë të diskutojë për çdo institucion në Republikën e Kosovës, i cili funksionon me ligje. Në momentin kur ekziston një institucion për të cilin ky Kuvend, ne vetë si deputetë, kemi nxjerrë ligj se si të funksionojë ai institucion, nëse në atë institucion ndodh diçka, siç ka ndodhur në burgjet e Kosovës, të cilat janë në administrim të drejtpërdrejtë të Qeverisë, në këtë rast të Ministrisë së Drejtësisë, Parlamenti me urgjencë, jo vetëm që ka të drejtë, por e ka të domosdoshme që të diskutojë për atë çështje.

Dhe, kjo nuk është përzierje e pushteteve, sepse ne nuk po diskutojmë a t'i përzihemi në vendimmarrje drejtësisë. Ky nuk është diskutimi, a do të marrim ne vendime në vend të gjykatave? Kush e thotë këtë, e thotë me qëllim, për ta devijuar çështjen dhe nuk ia donë të mirën rastit dhe zbardhjes së rastit. Nëse Policia funksionon me ligj, a e kemi nxjerrë ne vetë si Kuvend Ligjin për Policinë? Nëse ndodh atje një problem i madh shoqëror, a duhet Kuvendi të diskutojë nëse Policia e ka shkelur ligjin e vet. Nëse gjykatat, për të cilat ne kemi nxjerrë ligje, kanë administruar gabimisht me rastet? Nëse hetuesia nuk i ka administruar mirë provat dhe i kanë rrjedhë provat, a duhet të diskutojë dikush në këtë shtet?

KRYESUESI: Glauk, unë nuk e kam hapur debatin, ju lutem! Në qoftë se është për procedurë...

GLAUK KONJUFCA: Vetëm në lidhje me atë, se këtu shumë diskutime u bënë, Kuvendi nuk ka të drejtë që të merret me këtë çështje! Veç pak, zotëri, se jo vetëm që ka të drejtë, por e ka të domosdoshme të merret me këtë çështje.

KRYESUESI: A ka mundësi të të sqaroj veç diçka? Ju si grup parlamentar keni të drejtë të shtroni kërkesë për debat dhe ta hedh në votim. Kjo është mundësia e sotme që e kemi në Kuvend. Tjetër mundësi s'kemi.

GLAUK KONJUFCA: E ja tash një kërkesë, pasi po do kështu. Nuk është e drejtë të thuhet ka vdekur një djalë i ri, një aktivist politik, me aktakuzë politike, e të montuar, për të cilën nuk është marrë në pyetje dhe nuk ka prova, e ka humbur jetën në burg dhe kjo është çështje vetëm forenzike. Qysh o zotëri çështje forenzike? Ky është problem shoqëror!

Ne, nëse kemi nxjerrë ligje për ato institucione dhe nëse dyshojmë që nuk janë institucione në përputhje me ligjet, nëse nuk flitet në këtë Kuvend, unë nuk e di ku do të flitet. Edhe nëse deputeti nuk e ka guximin që të prononcohet për këtë rast, unë nuk e di në këtë shoqëri kush do ta ketë tjetër guximin, nëse jemi të zgjedhur të drejtpërdrejtë të popullit.

E tash, sa i përket pikës 49 të Rregullores së Kuvendit, këtu thotë që kemi të drejtë ta ngremë një çështje urgjente. E ne po e konsiderojmë këtë fort urgjente dhe dëshiroj që të hedhet në votim, që të diskutohet për rastin “Dehari” në Kuvendin e Kosovës sipas pikës 49, dhe kjo të hedhet sot në votim në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

KRYESUESI: Atëherë, e kemi një kërkesë nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” që ta hedhim në votim çështjen e debatit në Parlament. Grupet parlamentare duhet të deklarohen. Zoti Pajaziti e keni fjalën, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Detyrohem të përsëris se ne këtu sot nuk i ndihmojmë drejtësisë dhe nuk mund ta bëjmë drejtësinë. Ne këtu mund vetëm t’i bëjmë presion drejtësisë për ta kryer punën e vet, edhe të forenzikës, edhe institucioneve tjera.

Ne jemi të interesuar dhe do të mbështetim gjithçka që del prej atij rezultati dhe duhet të marrim përgjegjësi dhe të shkojnë në përgjegjësi të plotë të gjitha organet të cilitdo nivel për vdekjen në përputhje me rezultatet që do të dalin. Por, të gjitha përgjegjësitë, edhe të atyre që e kanë nxitur, edhe të atyre që e kanë lejuar vdekjen, thjesht ne nuk duhet të paragjykojmë asgjë. Por, sot ne duhet të kemi kujdes edhe nga familja në dhimbjen e saj, të mos bëjmë debate politike, të mos e bëjmë drejtësinë, e cila nuk na takon ne këtu. Ne e bëjmë politikën, por duhet ta presim drejtësinë.

Edhe një herë po e përsëris, Grupi Parlamentar i PDK-së pret dhe kërkon që sa më shpejt institucionet e drejtësisë të dalin me rezultate dhe pastaj mund të bisedojmë dhe ta trajtojmë këtë çështje, e në përputhje me rezultatet edhe qëndrimet tona pastaj do t’i shfaqim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, nënkryetar!

E thashë në fillim dhe, meqenëse është rast i ndjeshëm, nuk dëshiroj as të polemizoj me askënd, por do të kem rast, po e them qëndrimin e grupit tonë parlamentar.

Ne, edhe një herë kërkojmë të dalin rezultatet e mbi bazën e rezultateve, dokumenteve, ne absolutisht asnjëherë nuk i ikim gatishmërisë që të debatohet, pra vetëm mbi bazën e argumenteve dhe fakteve, kurdo që dalin. Ndërkaq, sot ne nuk shohim mundësi të ketë një debat të tillë, në mungesë të rezultateve dhe të një rasti që është nën hetim, po e përsëris, të një rasti që është nën hetim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i AAK-së, në emër të grupit, zoti Pal Lekaj.

PAL LEKAJ: I nderuar kryesues,

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Është një çështje që në këtë Kuvend ne duhet ta diskutojmë dhe nuk kemi pse të frikohemi prej diskutimeve, sepse nuk është një gjë që nuk dihet dhe nuk ka ndodhur. Prandaj, për të gjitha çështjet që janë me rëndësi, që procesi të shkojë dhe të jetë transparent, ne duhet të diskutojmë.

Prandaj, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e mbështet që të diskutohet sot për këtë çështje, që është së pari dhembje për familjen, dhembje për studentët, dhembje për rininë dhe dhembje për të gjithë qytetarët e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Berisha, në emër të Grupit Parlamentar “Nisma”.

ZAFIR BERISHA: Ne jemi që të bëhet një debat pa tentuar që të kontestohen provat eventuale që mund të vijnë, sepse mendojmë se ky debat mund t’i shërbejë sqarimit të shumë dilemave që janë ngritur nga ekzekutivi dhe njerëzit përgjegjës të institucioneve. Dhe, përpos debatit që duhet të zhvillohet, pa diskutim, është mirë të jetë edhe kryeministri i vendit, si njeriu më përgjegjës për zbatimin e ligjeve dhe ligjshmërisë në të gjitha institucionet bashkë me vartësit e tij.

Unë besoj se edhe PDK-ja, edhe LDK-ja, të cilat kanë dilema për debatin, është mirë të pranojnë të debatohet, sepse në debatet publike që janë zhvilluar është e vërtetë se është krijuar një mjegull dhe këtë mjegull, që dikush ndoshta me qëllim e ka krijuar, është mirë ta sqarojmë para opinionit, e veçanërisht para familjes Dehari. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! “6+”, a është paraqitur? S’është paraqitur. Nuk dëshirojnë të flasin. Atëherë, para se të hyjmë në votim, ne kemi një Kushtetutë, mbi bazën e së cilës pushtetet janë të ndara, e në përputhje me atë, shpresoj që do të funksionojmë dhe t’i instalojmë përgjithmonë këto rregulla. Kërkesa juaj është për të bërë debat. Unë e hedh në votim kërkesën e Grupit Parlamentar për të pasur një debat në Parlamentin e Kosovës lidhur me çështjen që është ngritur.

Votojmë... a doni votim të hapur apo elektronik? Me votim elektronik, votojmë tani.

Regjia, ju lutem! Unë konsideroj që s'kemi rezultat, sepse kanë votuar gjithsej 45 veta me kartelë dhe 3 janë pa kartelë, pra nuk konsiderohet votimi valid. Në qoftë se dëshironi edhe një herë ta qes në votim, unë e qes. Por me zor s'mund t'i shtyj të votojnë!

Vazhdojmë me rendin e ditës. Është pika e njëmbëdhjetë e rendit të ditës:

11. Zgjedhja e një anëtari të Këshillit Prokurorial të Kosovës

Kuvendi në seancën plenare më datë 28 tetor 2016 ka formuar Komisionin për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe një anëtari të Komisionit të Pavarur për Medie, në këtë përbërje: Hajdar Beqa; Murat Hoxha; Driton Çausi; Rustem Berisha; Shukrije Bytyqi dhe Mufera Shinik.

Ftoj Komisionin votues që të fillojë me procedimin e votimit, ndërsa deputetët do të ftohen të votojnë sipas listës. Ju njoftoj se për këtë pikë të rendit të ditës, në seancën e kaluar është zhvilluar rundi i parë i votimit të fshehtë, por asnjëri nga kandidatët nuk i ka fituar votat e nevojshme për t'u zgjedhur anëtar i Këshillit Prokurorial të Kosovës. Andaj, sot vazhdojmë në rundin e dytë të votimit të fshehtë, me të dy kandidatët që kanë marrë më shumë vota në rundin e parë të votimit, si në vijim: Shemsi Jashari dhe Naim Krasniqi, për ta zgjedhur një anëtar të Komisionit të Pavarur për Medie. Kjo është gjendja.

Lus kryetarët e grupeve parlamentare që t'i ftojnë deputetët në sallë.

Atëherë, unë e jap një pauzë gjysmë ore, deri në orën 12:00. Në qoftë se kemi kuorum, e vazhdojmë, në qoftë se jo... Ose, po presim, unë s'kam problem. Në rregull, po presim.

* * *

KRYESUESI: Zonja dhe zotërinj deputetë, kryetarë të grupeve parlamentare në veçanti, në bazë të marrëveshjes dhe bisedës që bëmë janë 3 deputetë në një aktivitet brenda në Kosovë. Ata mund të kthehen në Parlament dhe të bëjmë kuorumin.

Njëkohësisht, mendoj që edhe Grupi "6+" zonja Balje e një tjetër, dhe zonja Shinik dhe zoti Damka janë në vizitë zyrtare dhe kthehen vonë, që do të thotë se nuk mund të arrijnë për seancë, prandaj ne po e shtyjmë seancën për në orën 14:00 dhe pastaj të fillojë votimi.

Shpresoj që në orën 14:00 do të ktheheni në sallë!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Ju lutem, uluni dhe të shohim se a kemi kuorum, e pastaj të dimë a po vazhdojmë.

Tani jemi 60 deputetë. Në ndërkohë erdhi Ademi, jemi 61.

Mendoj që t'i propozojmë 2 nga të pavarurit në komision, i cili duhet të formohet, meqë Mufera Shinik, Rustem Berisha dhe Shukrije Bytyqi nuk janë këtu, kërkoj që të propozohen nga të pavarurit.

Pra, nëse më lejohet, do ta propozoja Margarita Kadriun dhe në vend të Mufera Shinik, zonjën Duda Balje.

Urdhëro, zoti Beqiri, merre fjalën!

ISMET BEQIRI: Ne propozojmë në vend të Murat Hoxhës, zonjën Mirjeta Kalludra.

KRYESUESI: Në rregull! Atëherë, a jeni dakord me këto propozime?

A është dikush kundër?

Pra, vazhdojmë, ju lutem t'i zëni vendet dhe të votojmë. Atëherë zini vendet, zoti Hajdar Beqa, Mirjeta Kalludra dhe zonja Kadriu.

Duda Balje nuk është e pranishme.

Po vazhdojmë me thirrjen e deputetëve për të votuar.

Abdyl Ymeri, Adem Grabovci, Adem Hoxha, Adem Salihaj, Agim Ademaj, Agim Aliu, Agim Çeku...

Ju lus, mos u vononi, sepse i kemi vetëm votimet.

Po u them të gjithë deputetëve, të mos largohen deri sa ta përfundojmë votimin!

... Agim Kikaj, Aida Dërguti, Albin Kurti, Albulena Haxhiu, Ali Berisha, Ali Sadriu, Anton Çuni, Arben Gashi, Armend Zemaj, Bali Muharremaj, Bardhyl Metaj, Bekim Haxhiu, Besa Baftija, Besa Gaxherri, Besim Beqaj, Bislim Zogaj, Blerim Grainca, Blerim Shala, Blerta Deliu-Kodra, Bojan Mitiq, Qerim Bajrami, Danush Ademi, Daut Haradinaj, Donika Kadaj-Bujupi, Doruntinë Maloku- Kastrati, Driton Çausi, Duda Balje, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enver

Hoti, Etem Arifi, Fadil Beka, Fatmir Limaj, Fatmir Rexhepi, Fatmir Xhelili, Faton Topalli, Fikrim Damka, Fisnik Ismajli, Flora Brovina, Ganimete Musliu, Gëzim Kelmendi, Glauk Konjufca, Hajdar Beqa, Hatim Baxhaku, Haxhi Shala, Ilir Deda, Ismajl Kurteshi, Ismet Beqiri, Jasmina Zhivković, Jelena Bontiq, Kadri Veseli, Kimete Bytyqi, Kujtim Paçaku, Labinotë Demi-Murtezi, Lahi Brahimaj, Lirije Kajtazi, Luljeta Gutaj-Veselaj, Margarita Kadriu-Ukelli, Melihate Tërmmkolli, Mexhide Mjaku-Topalli, Milazim Haliti, Milena Miliçević, Milka Vuletiq, Mirjeta Kalludra, Mufera Serbica-Shinik, Muhamet Mustafa, Murat Hoxha, Mytahir Haskuka, Naim Fetahu, Nait Hasani, Naser Osmani, Nenad Rashiq, Nezir Çoçaj, Njomza Emini, Nuredin Ibishi, Nuredin Lushtaku, Pal Lekaj, Puhije Demaku, Rafet Rama, Raif Qela, Fatmir Shurdhaj, Ramiz Kelmendi, Rexhep Selimi, Rustem Berisha, Sabri Hamiti, Sadri Ferati, Safete Hadërgjonaj, Sala Berisha-Shala, Salih Morina, Salih Salihu, Salihe Mustafa, Sasha Milosavleviq, Selvije Halimi, Shaip Muja, Shpejtim Bulliqi, Shqipe Pantina, Shukri Buja, Shukrije Bytyqi, Slavko Simiq, Slobodan Petroviq, Sergjan Popović, Synavere Rysha, Teuta Haxhiu, Teuta Rugova, Time Kadrijaj, Valdete Bajrami, Veton Berisha, Visar Ymeri, Vjosa Osmani, Xhevahire Izmak, Zafir Berisha, Zenun Pajaziti dhe Xhavit Haliti.

A ka ndokush që s'ka votuar? Askush!

Por, nëse ndokush s'ka votuar, mund të afrohet te Komisioni për të marrë fletëvotimin dhe të votojë, në të kundërtën, e mbylлим procesin.

Atëherë konstatoj se kanë votuar të gjithë dhe komisioni le ta kryejë punën e vet, të bëjë numërimin, regjistrimin e numrit të votave dhe shpalljen. Fjalën e ka kërkuar zoti Beqiri!

ISMET BEQIRI: Faleminderit, nënkryetar!

Ne propozojmë që si zgjidhje e përkohshme anëtar i Komisionit për Buxhet e Financa në vend të zotit Metaj të jetë zoti Salih Morina.

KRYETARI: Faleminderit! Njoftimi është i rregullt. Për këtë çështje s'kemi nevojë të votojmë, është vullnet i grupit parlamentar dhe mendoj se Parlamenti lidhur me këtë e ka të qartë dhe e miraton.

Tash fjalën e ka zonja Kadriu, si kryetare e komisionit që t'i paraqesë rezultatet e votimit.

MARGARITA KADRIU: Atëherë po fillojmë me numërimin e votave për zgjedhjen e një anëtarit të Këshillit Prokurorial të Kosovës:

- Shemsi Jashari,
- Shemsi Jashari,
- Shemsi Jashari,

- Shemsi Jashari,
- Shemsi Jashari,
- Shemsi Jashari,
- Shemsi Jashari,
- Shemsi Jashari,
- Shemsi Jashari,
- Shemsi Jashari,
- Shemsi Jashari,
- Shemsi Jashari,
- Naim Krasniqi,
- E pavlefshme,
- Shemsi Jashari,
- Shemsi Jashari,
- Shemsi Jashari,
- Shemsi Jashari,
- Shemsi Jashari,
- Shemsi Jashari,
- Shemsi Jashari dhe
- Shemsi Jashari.

Faleminderit!

KRYESUESI: Regjia, ia jepni fjalën kryetarës së komisionit, zonjës Kadriu.

MARGARITA KADRIU: Atëherë, po fillojmë numërimin për zgjedhjen e 1 (një) anëtarit të Komisionit të Pavarur për Medie:

- Fehmi Ajvazi,
- Fehmi Ajvazi,
- Fehmi Ajvazi,
- Xhemajl Krasniqi,
- Xhemajl Krasniqi,
- Xhemajl Krasniqi,
- Xhemajl Krasniqi,
- Fehmi Ajvazi,
- Fehmi Ajvazi,
- Xhemajl Krasniqi,
- Xhemajl Krasniqi,
- Xhemajl Krasniqi,
- Fehmi Ajvazi,
- Fehmi Ajvazi,

- Xhemajl Krasniqi,
- Xhemajl Krasniqi,
- Xhemajl Krasniqi,
- Fehmi Ajvazi,
- Xhemajl Krasniqi,
- Xhemajl Krasniqi,
- Fehmi Ajvazi,
- Fehmi Ajvazi,
- Xhemajl Krasniqi,
- Fehmi Ajvazi,
- Xhemajl Krasniqi,
- Xhemajl Krasniqi,
- Fehmi Ajvazi,
- Xhemajl Krasniqi,
- Fehmi Ajvazi,
- Fehmi Ajvazi,
- Xhemajl Krasniqi,
- Xhemajl Krasniqi,
- Fehmi Ajvazi,
- Xhemajl Krasniqi,
- E pavlefshme,
- Fehmi Ajvazi,
- Fehmi Ajvazi,
- Fehmi Ajvazi,
- Fehmi Ajvazi,
- Fehmi Ajvazi,
- Xhemajl Krasniqi,
- Fehmi Ajvazi,
- Xhemajl Krasniqi,
- Xhemajl Krasniqi,
- Xhemajl Krasniqi,
- Fehmi Ajvazi,
- Xhemajl Krasniqi,
- Xhemajl Krasniqi,
- Xhemajl Krasniqi,
- Xhemajl Krasniqi,
- Fehmi Ajvazi,
- Fehmi Ajvazi,
- Fehmi Ajvazi,
- Fehmi Ajvazi,

- Xhemajl Krasniqi,
- Xhemajl Krasniqi,
- Fehmi Ajvazi,
- Xhemajl Krasniqi,
- Xhemajl Krasniqi,
- Xhemajl Krasniqi,
- Fehmi Ajvazi dhe
- Fehmi Ajvazi.

Faleminderit!

KRYESUESI: Ju lutem, fjalën e ka zonja Kadriu për të komunikuar rezultatin e votimit.

MARGARITA KADRIU: Faleminderit! Në votimin për zgjedhjen e 1 (një) anëtari të Këshillit Prokurorial të Kosovës kanë marrë pjesë 62 deputetë, prej tyre të pavlefshme janë 3 fletëvotime.

Shemsi Jashari ka fituar 57 vota,
Naim Krasniqi, 2 vota.

Prandaj, në bazë të rezultateve të votimit, në pajtim me nenin 110 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 3.2 të Ligjit 05/L-035, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Numër 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe nenin 51 të Rregullores së Kuvendit, konstatohet se nuk zgjidhet asnjëri nga kandidatët për anëtar të Këshillit Prokurorial të Kosovës nga radhët e shoqërisë civile, prandaj do të përsëritet konkursi.

Ndërkaq, në votimin për zgjedhjen e një (1) anëtari të Komisionit të Pavarur për Medie kanë marrë pjesë 62 deputetë, prej tyre 1 votim është i pavlefshëm.

Dhe, në bazë të rezultateve të votimit, në pajtim me nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të neneve 10.1, 10.5, 11 dhe 13 të Ligjit 04/L-44 për Komisionin e Pavarur për Medie dhe nenit 51 të Rregullores së Kuvendit konstatohet se zoti Xhemajl Krasniqi zgjidhet anëtar i Komisionit të Pavarur për Medie nga radha e komunitetit shumicë shqiptar me mandat katërvjeçar. Urime!

KRYESUESI: Faleminderit!

MARGARITA KADRIU: Kërkoj falje! Prej 62 votave, Shemsi Jashari i ka fituar 57 vota dhe Naim Krasniqi i ka fituar 2 vota. Të pavlefshme janë 3.

Kjo ishte te e para, kurse Fehmi Ajvazi ka fituar 29 vota, ndërkaq Xhemajl Krasniqi 32 vota dhe 1 fletëvotim ka qenë i pavlefshëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Atëherë, rezultatin e dëgjuam të gjithë.

15. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e 1 (një) anëtari të Bordit të Ankesave për Medie

Po më duket se s'kemi kuorum, megjithatë unë po u referohem të dhënave.

Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 24 tetor 2016 ka kërkuar nga grupet parlamentare të Kuvendit që t'i propozojë deputetët për kryetar, zëvendëskryetar dhe anëtarë të Komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar në Bordin e Ankesave për Medie.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka propozuar Selvije Halimin kryetare, Xhevahire Izmakun, anëtare.

Grupi Parlamentar i AAK-së e ka propozuar Lahi Brahimajn, anëtar.

Grupi Parlamentar i "Nismës" e ka propozuar Zafir Berishën, anëtar.

Grupi Parlamentar i LDK-së nuk ka propozuar akoma. A i keni emrat, zoti Beqiri?

ISMET BEQIRI: Po, po i jap, meqenëse ka të bëjë me ankesa, e të tjera, duke i çmuar të gjithë deputetët për aftësitë e tyre dhe mundësinë që të kontribuojnë. Unë e kisha propozuar njërin Armend Zemaj dhe tjetrin Blerim Grainca. Faleminderit!

KRYESUESI: Armend Zemaj dhe Blerim Grainca.

Nga Grupi Parlamentar i "Vetëvendosjes" të propozohen deputetët. Nuk janë këtu.

Edhe Lista serbe nuk është këtu.

Grupi Parlamentar "6+", a keni propozim për 1 (një) anëtar të komisionit? Zoti Bajrami e ka fjalën.

ĆERIM BAJRAMI: Faleminderit! Kryesues, ne propozojmë Duda Balje të jetë anëtare e komisionit.

KRYESUESI: Faleminderit! Është pra Duda Balje e propozuar. Për të votuar, s'kemi kuorum, por mirë që është plotësuar me kandidatët.

I kemi 2 subjekte politike që akoma s'kanë propozim dhe në momentin kur të bëhet kuorumi, ne e zgjidhim këtë çështje.

16. Formimi i Komisionit hetimor parlamentar, sipas kërkesës së deputetes Shqipe Pantina, mbështetur nga 8 (tetë) deputetë të tjerë nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” lidhur me Radiotelevizionin e Kosovës

Deputetja Shqipe Pantina, e mbështetur nga tetë (8) deputetë të tjerë, nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”, në bazë të nenit 4, paragrafi 1 të Ligjit për hetim parlamentar, ka iniciuar procedurën për formimin e Komisionit hetimor parlamentar lidhur me punën dhe funksionimin e Radiotelevizionit të Kosovës.

Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 26 shtator 2016, ka kërkuar nga Grupi Parlamentar që t'i propozojnë deputetët për kryetar, zëvendëskryetar dhe anëtarë të Komisionit hetimor parlamentar.

Përbërja e komisionit, sipas propozuesit, duhet të jetë prej 11 anëtarësh.

Grupi Parlamentar i AAK-së ka propozuar 2 deputetë, Lahi Brahimaj, kryesues dhe Bali Muharremaj, anëtar.

Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” ka propozuar 2 deputetë: Shqipe Pantina, zëvendëskryesuese dhe Driton Çausi, anëtar.

Grupi Parlamentar “Nisma” e ka propozuar deputetin Enver Hoti, anëtar.

Grupet parlamentare që nuk i kanë propozuar akoma janë Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike që duhet t'i propozojë 2 anëtarë, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike 2 anëtarë, Grupi Parlamentar i Listës serbe 1 anëtar dhe Grupi Parlamentar “6+”, 1 anëtar.

Nëse i keni gati emrat, i paraqitni. Fjalën e ka zoti Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Zoti kryesues, kryeministër, ministra, Kolegë deputetë,

Meqenëse ne si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike nuk kemi dërguar dhe kemi vendosur të mos i dërgojmë emrat e përfaqësuesve në këtë grup hetimor, na duhet të japim një sqarim të shkurtër para jush dhe para opinionit.

E para, mendoj se jemi dakord me rekomandimet e EBIU-s për mosndërhyrje në televizionin publik. Pastaj ne i kemi pasur vitin e kaluar disa debate publike, disa aktivitete si deputetë dhe ajo që është më kryesorja, jemi në plotësim-ndryshimin e Ligjit për televizionin publik. Unë mendoj se gjithçka që bëjmë më shumë jashtë institucioneve që kanë përgjegjësinë për të shikuar gjithçka në zbatimin e ligjit atje, ne mund të bëjmë ndërhyrje dhe nuk ndreqim punë në televizionin publik.

Unë i ftoj deputetët që ta shfrytëzojnë pozicionin edhe përkatësinë e tyre nëpër komisione dhe të bëjnë punën e tyre, vizita, vëzhgime, të bëjnë kontakte, të hetojnë punën e secilit institucion, edhe të televizionit publik, por ne nuk mund të marrim ndonjë rol tjetër, aq më tepër në këtë kohë kur jemi në prag të gjetjes së një zgjidhje për financimin e transmetuesit publik.

Mendoj që puna më e mirë është nëse ne fokusohemi të gjithë në ligj, përpos financimit tash mund të bëjmë ndryshime të tjera cilësore që mund të rregullojmë edhe ndonjë send, është diçka tjetër që ka të bëjë edhe me funksionimin e bordit e të menaxhmentit dhe të gjithë transmetuesit publik.

Edhe një herë po e përsëris këto janë arsyt pse Partia Demokratike e Kosovës nuk merr pjesë në këtë Komision hetimor. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Pajaziti! Fjalën e ka zoti Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Sigurisht që për çdo institucion ne mund të kemi vërejtje, në këtë rast edhe në punën e RTK-së, por po ashtu ne konsiderojmë që organet kompetente, secila nga fushëveprimtaria e vet, duhet të bëjë punën për çfarëdo eventualisht parregullsie dhe lëshimi që mund të jetë prezent. Edhe ne nuk e shohim të arsyeshme të jemi pjesë e një grupi hetimor, sepse kjo është punë më shumë e dikujt tjetër se sa jona.

Ndërkaq është e qartë se ne mund të japim vërejtje edhe të debatojmë e të sugjerojmë, por jo në një Komision hetimor të tillë parlamentar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë mendoj që proceduralisht Lëvizja “Vetëvendosje” ka bërë kërkesën e rregullt ose zonja Pantina. Qëndrimi i dy grupeve të mëdha parlamentare u dha. Në qoftë se ka ankesa, ka mekanizma ligjorë që mund të trajtohet ky problem, mendoj që Komisioni për Rregullore dhe Imunitete mund të thotë ndonjë fjalë pastaj më vonë nëse ka ankesa ose komisioni i ligjeve.

Unë e mbyll me kaq, në qoftë se të dy grupet parlamentare dhe të tjerët janë të gatshëm që t'i tregojnë anëtarët e komisionit, ne procedojmë.

17. Debat parlamentar, sipas kërkesës së deputetes Margarita Kadriu-Ukelli, mbështetur edhe nga 9 (nëntë) deputetë të tjerë nënshkrues lidhur me detyrimet e mundshme financiare të Kosovës për pretendimet e kompanive që kanë ushtruar padi në Gjykatën Ndërkombëtare të Arbitrazhit

Deputetja Margarita Kadriu-Ukelli, mbështetur edhe nga nëntë (9) deputetë të tjerë ka kërkuar debat parlamentar lidhur me detyrimet e mundshme financiare të Kosovës për pretendimet e kompanive që kanë ushtruar padi në Gjykatën Ndërkombëtare të Arbitrazhit.

Ju njoftoj që Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e mbajtur më 26 shtator 2016 ka kërkuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të përgatisë një informatë para se të debatohet në Kuvend për çështjen e ngritur nga deputetja Margarita Kadriu-Ukelli. Deri më tani Qeveria e Kosovës nuk ka dërguar në Kuvend informatë për këtë çështje, por këtu janë dy më kompetentët, domethënë është kryeministri dhe ministrja e Ministrisë së Ekonomisë dhe Tregtisë që mund të diskutojmë bashkë. Sidoqoftë, edhe deputetët e kanë fjalën. Ia japim fjalën zonjës Margarita Kadriu-Ukelli në cilësinë e propozuesit të çështjes që të flasë lidhur me këtë çështje.

MARGARITA KADRIU-UKELLI: Të nderuar qytetarë,

Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër,

Zonja ministre,

Edhe përkundër faktit se kërkesa e nënshkruar nga 10 deputetë, për ta shtruar si çështje urgjente në seancën e Kuvendit, në bazë të nenit 49 të Rregullores së Kuvendit, rrezikun që po i kanoset buxhetit të Republikës së Kosovës, gjegjësisht buxhetit të qytetarëve nga arbitrazhet ndërkombëtare, edhe atë hiç më pak se gati 500 milionë euro, duke përfshirë edhe shpenzimet e avokatisë, kërkesë kjo e cila u dorëzua në Sekretarinë e Kuvendit më datë 26 shtator 2016, Kryesia e Kuvendit e vendosi këtë çështje dhe sot jemi mbledhur përfundimisht pas dy muajsh që ta diskutojmë.

Edhe pse me afro dy muaj vonesë, edhe pse bëhet fjalë për 500 milionë euro të qytetarëve të Republikës së Kosovës, së paku sot po diskutojmë për kontestet e ngritura në arbitrazhe ndërkombëtare, për shkak të aferave të ndryshme, të cilat mund ta rrezikojnë dhe ta gjymtojnë buxhetin, edhe ashtu të vogël të Republikës së Kosovës.

Në tri rastet e njohura për opinionin, atë të PTK-së me "AXOS"-in, pastaj të kompanisë "Z Mobile" dhe të tenderit korruptiv të pasaportave, në të cilin rast qytetarët tanimë i humbën 5 milionë euro, dhe nëse vendi ynë i humb edhe këto dy konteste të mbetura gjyqësore, gjë që është shumë e mundshme sipas rrjedhës që kanë marrë proceset, taksapaguesit kosovarë do të

dëmtohen më shumë se 500 milionë euro, përfshirë këtu edhe shpenzimet enorme për të paguar avokatë, këshilltarë transaksioni, e të tjera.

Në skandalin me pasaporta qytetarët tanimë janë sjellë para aktit të kryer dhe buxheti i qytetarëve dhe taksapaguesve kosovarë do të minusohet për 5 milionë euro.

Rasti tjetër në arbitrazh është dërguar më 25 janar të këtij viti, edhe atë nga kompania e shumëpërfolur “Z Mobile”, e cila kërkon mbi 42 milionë euro, edhe atë plus interesin për dëmet e pretenduara që i janë shkaktuar gjatë periudhës 2011-2014.

Sipas medieve, rasti i tretë dhe i fundit në arbitrazh është ai i privatizimit të Postëtelekomit, e cila u privatizua me një çmim të ofruar nga “AXOS”-i në vlerë prej 270 milionë eurosh, por pastaj u anulua i tërë procesi i privatizimit.

Të dyja këto kompani, si “Z Mobile”, po ashtu edhe kompania “AXOS”, sipas medieve dhe raporteve të OJQ-ve, dyshohen edhe për lidhjet e tyre me oligarkët e biznesit dhe politikën kosovare, për të cilët dyshohen se kanë qenë realisht pas këtyre kompanive, e të cilat kompani tani kërkojnë rreth 500 milionë euro, në paditë e tyre kundër Kosovës.

Çfarë duhet theksuar është që, po qe se këto dy vendime shpallen pozitive në anën e paditësve, kjo do t'i tronditë financat e Kosovës dhe shteti mund të kolapsojë.

Përderisa për rastin e pasaportave ka pasur edhe të akuzuar, në një shtet ku sundon ligji, në rastet e “Z Mobile” dhe “AXOS”-it, do të mjaftonte që Prokuroria t'i hetonte që nga fillimi të dyja këto procese, të zbardhte për nevojat hetimore të gjitha komunikimet mes faktorëve relevantë të përfshirë në proces, duke adresuar si duhet të dyja këto raste në tërësi.

Sa i përket rastit të dështimit të privatizimit të Postë-Telekomit të Kosovës, përgjegjësia nuk mund t'i lihet vetëm në aspektin politik një Kuvendi që nuk arriti ta mbështesë me vota shitjen e 75 për qind të aksioneve të Postë-Telekomit të Kosovës, por duhet të kërkohet nga zyrtarët që e iniciuan, e dizajnuan, e përzgjedhën, ndikuan dhe e shpallën në fund fituesin, sidomos pa u verifikuar as burimet financiare dhe pa pasur kurrfarë garancie për investimet e premtuara.

Është krejtësisht e ligjshme që të supozohet se dështimi për privatizimin e PTK-së mund të ketë qenë edhe i qëllimshëm, për ta detyruar pastaj shtetin të paguajë në arbitrazh ndërkombëtar shuma marramendëse për fuqinë ekonomike dhe financiare të Kosovës.

Në momentin që do të zhvillohej një proces hetimor për të dyja këto raste në tërësi, paditësit, pra kompanitë “AXOS” dhe kompania e “Z Mobile” do të ishin nën procese hetimore për të vërtetuar se a ka pasur shkelje eventuale ligjore, keqpërdorime eventuale të detyrës zyrtare dhe

duke qenë rastet në hetim, natyrisht se edhe qëndrimi i arbitrazhit do të relativizohet, me mundësinë për t'i hedhur poshtë si të pabaza paditë e ngritura.

A do të përfshihet Prokuroria e Shtetit në këto megaskandale që po i kushtojnë buxhetit të qytetarëve kosovarë mbi 500 milionë euro, sigurisht se i takon organit të akuzës ta thotë fjalën e tij, por duhet të potencohet se edhe indiferenca e organeve të drejtësisë është shkelje e rëndë dhe nuk do të na mundësojë që shtetin ta kthejmë në një shtet ku sundon ligji.

Nga ana tjetër, ne sot si Kuvend do duhet të hapim debatin për të tri rastet, njëra prej tyre tanimë është para aktit të kryer, në mënyrë që të nxirren rekomandime për të ardhmen, që askush të mos tentojë të kurdisë tenderë eventuale, padi në arbitrazhe apo çfarëdo dallaveresh të tjera eventuale, për të përfituar shuma të majme të parave mbi kurrizin e kosovarëve të varfër.

Pa e adresuar përgjegjësinë, varësisht prej pozicionit të secilit zyrtar, pavarësisht rangut që ka, nuk mund të kemi transparencë dhe drejtësi. Nëse dënohet dhe Kosova duhet të paguajë këto shuma të papërbalueshme, të nderuar, kush do të jetë fajtori? Drejtësia patjetër duhet ta thotë fjalën e saj, sidoqoftë Kosova duhet të lirohet nga këto ngarkesa të mëhershme, ndërsa përgjegjësit, kushdo qofshin ata, duhet të përballen me pasojat eventuale ligjore. Kështu do të krijohej një precedent pozitiv për më vonë, në mënyrë që të tilla raste të mos na përsëriten.

Pa e parë veprimin e Prokurorisë së pari, e cila fare lehtë mund ta zbulojë dyshimin për çfarëdo agjende eventuale që ka pasur prapa këtyre dy rasteve, nuk mund të shpresojmë se mund të kemi shembull të munguar si deri më tani.

Buxheti i taksapaguesve po rrezikohet për afro 500 milionë euro. Unë personalisht i kam bërë pyetje disa herë ministrit të Zhvillimit Ekonomik, në të cilat pyetje nuk kam marrë përgjigje dhe sot falënderoj Kryeministrin që është këtu dhe shpresoj të na japë përgjigjet në pyetjet që kanë qenë si në vijim: a është analizuar se kush në ministrinë përkatëse, gjegjësisht në institucionet përkatëse që ai e udhëheq ka qenë përgjegjës për rrezikun e humbjes edhe të gati 400 milionë eurove të tatimpaguesve?

Çka tash, nëse Kosova e humb kontestin si në rastin e tenderit të pasaportave dhe detyrohet të paguajë edhe 450 milionë euro?

Pse nuk emërtohen se kush janë personat eventuale përgjegjës juridikisht për këto padi?

Pse nuk bëhet publike se ku qëndron baza e padisë së "AXOS"-it dhe kë e kanë angazhuar për mbrojtje, si dhe sa para janë kontraktuar?

Këto pyetje deri më tani, së paku këto 2 muaj, kanë mbetur pa përgjigje. Po shpresoj se më në fund do të kemi transparencë këtu në Kuvendin e Kosovës dhe të japim maksimumin këto para të mos përfundojnë në xhepat e atyre që eventualisht qëndrojnë prapa gjithë këtyre proceseve të dyshimta, të cilat edhe mund të kenë “dështuar”, për t’u “kurorëzuar” pastaj me shpërblimin e pretenduar prej gati 500 milionë eurosh!

Unë mirëpres debatin tuaj, sepse bëhet fjalë për 500 milionë euro të tatimpaguesve kosovarë dhe, si të tillë, do të thotë në fund shpresoj të konkludojmë që të bëjmë rekomandime për Qeverinë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në qoftë se përfaqësuesi i Qeverisë dëshiron ta marrë fjalën, ia jap fjalën zotit kryeministër, Isa Mustafa e ka fjalën.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë po bëj përpjekje që t’ju njoftoj lidhur me përmbajtjen e këtyre lëndëve, dy prej të cilave vazhdojnë të jenë në arbitrazh ndërkombëtar, ndërkaq njëra ka vendimin e arbitrazhit.

Kam po ashtu një kërkesë para jush që lidhur me “AXOS”-in të mos hapet debat në Kuvend, për arsye se ekziston rreziku që pala e cila ka paditur Republikën e Kosovës mund të shfrytëzojë debatin e Kuvendit në procesin e arbitrazhit, sepse edhe ashtu pala është thirrur në një seancë të Kuvendit në këtë proces. Ndërkaq unë do t’ju njoftoj se ku jemi me atë proces, e njëjta gjë ka të bëjë edhe me Postë-Telekomin e Kosovës dhe me “DARDA Phone”-in, sepse janë dy procese, të cilat janë në vijim e sipër, prandaj do të jemi të kujdesshëm në këto procese.

Sa i përket rastit të arbitrazhit ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe shtypshkronjës shtetërore austriake, është një rast i cili është mbyllur në procesin e arbitrazhit. Ky rast është ngritur më 1 shtator 2013 dhe është përbërë nga dy pjesë. E para, ka të bëjë me kontestimin që Ministria e Punëve të Brendshme ia ka bërë juridiksionit, e dyta ka të bëjë me kërkesën meritore të shtypshkronjës shtetërore austriake dhe përkundër këtij kontestimi juridiksionit nga Ministria e Punëve të Brendshme, është zhvilluar procesi gjatë viteve dhe më datën 29 korrik 2016 është pranuar vendimi final i Tribunalit të Arbitrazhit.

Pala kosovare, sipas këtij vendimi, është shpallur përgjegjëse për kompensimin e shumë prej 5 milionë e 300 mijë euro, në të cilën shumë do të llogaritet edhe kamata prej 7% dhe shpenzimet e procedurës. Ministria e Punëve të Brendshme, përmes përfaqësuesit të saj, ka kundërshtuar këtë kërkesë të operatorit të bazuar në këto pika:

- kundërshtimi mbi bazën e mosrespektimit të detyrimit kontraktuale që i referoheshin detyrimit për pagesë të taksave shtetërore dhe regjistrimit të etnitetit në Kosovë,
- kundërshtimi mbi bazën e vonesave në furnizim si shkas për shkëputje të kontratës,

- kundërshtimi mbi bazën e mosfurnizimit sipas porosisë së fundit si shkas për shkëputje të kontratës,
- kundërshtimi mbi bazën e humbjeve ekonomike nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme si pasojë e vonesave, respektivisht mosfurnizimit,
- kundërshtimi mbi bazën kontraktuese të pëlqimit të parevokueshëm të shtypshkronjës shtetërore austriake, për shkëputjen e kontratës në rast të mosrespektimit të detyrimeve kontraktuese,
- kundërshtimi sipas përmbushjes me subrogim sipas Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve,
- kundërshtime sipas punëdrejtimit të padrejtë, sipas Ligjit për marrëdhënie të detyrimeve,
- kundërshtime sipas ushtrimit të punëve të huaja përkundër ndalesës, sipas Ligjit të marrëdhënieve detyrimore,
- kundërshtimi mbi mungesën e legjitimitetit pasiv në anën e Ministrisë së Punëve të Brendshme,
- kundërshtimi sipas konceptit juridik të shkëlqes thelbësore, të paraparë me Konventën e Kombeve të Bashkuara për shitjen ndërkombëtare të mallrave, e cila është pjesë përbërëse e legjislacionit të Republikës së Kosovës.

Dhe, në fund, si përmbledhje, Ministria e Punëve të Brendshme ka shfrytëzuar të drejtën ligjore që ta kundërshtojë vendimin për juridiksionin e Tribunalit të arbitrazhit. Ky kundërshtim është bërë para Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për çështje ekonomike. Kjo gjykatë në instancën e parë e ka refuzuar kërkesën e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe tani çështja është adresuar me ankesë në Gjykatën e Apelit.

Akoma nuk ka vendim të Apelit dhe pritet që pas këtij vendimi të veprohet sipas ligjit.

Rasti tjetër, i raportuar në medie që ka të bëjë me raportin ndërmjet “Darda Phone”-it dhe Telekomit të Kosovës. Pretendimet sipas kësaj i referohen kontratës operatorit të rrjetit mobil virtual të lidhur mes palëve më datën 6 janar 2009, dhe kryesisht pretendimet e paditësit i referohen mosrespektimit të kontratës nga ana e Telekomit të Kosovës, përkatësisht Postë-Telekomit të Kosovës.

Kërkesat e “Darda Phone”-it janë se ka pasur refuzim dhe vonesë liferimet të sim kartelave, alokimit të numrave shtesë mobilë, se është refuzuar sigurimi i shërbimeve 3G dhe 4G, si dhe është bërë reduktim në kualitetin e shërbimeve. Qëndrimet e Telekomit të Kosovës janë se vonesat jokualitative në liferimin e sim-kartelave janë si rezultat i aktivitetit të ndaluar “Sim to Sim”, i cili është zhvilluar në numeracionin e “Darda Phone”-it, për këtë është alarmuar edhe Monaco Telekom dhe ndalesa është bërë sipas kërkesës së kësaj të fundit.

Telekomi konstaton se refuzimi i alokimit të numrave shtesë mobilë është si rezultat i faktit se numeracioni shtesë nuk është i përfshirë në marrëveshje bazë dhe mund të bëhet vetëm në bazë

të dakordimit të dy palëve. Refuzimi i shërbimeve 3G dhe 4G po ashtu ndërlidhet me marrëveshjen bazë, e cila nuk ka paraparë që paditësi të ketë qasje në këtë lloj shërbimi, pasi që marrëveshja bazë parasheh vetëm shërbimet GSM.

Ndërsa, pretendimi i fundit, sipas konstatimit të Telekomit, se ka pasur reduktim të kualitetit të shërbimeve, konsiderohet se është plotësisht i pabazuar, i paargumentuar dhe është i pavërtetë. Sa i përket procesit, ky proces, të gjitha këto që po i them, po i them në bazë të vlerësimeve që ne i kemi marrë nga Telekom, jo si vlerësime të mia si kryeministër ose të ndonjë ministrie përkatëse.

Ky proces gjendet në fazën përfundimtare dhe brenda këtij viti pritet të dalë vendimi i arbitrazhit, përkatësisht deri në fund të dhjetorit të këtij viti. Telekom i Kosovës beson se padia e “Darda Phone”-it do të refuzohet, sepse asnjëra nga pretendimet e paraqitura në padi, sipas tyre, nuk janë të bazuara.

Duhet pasur parasysh se ky vendim nuk do të jetë i formës së prerë dhe palët mund ta sfidojnë vendimin edhe më tutje. Procedura është zhvilluar pranë Odës Ekonomike Ndërkombëtare në Paris. Telekom i Kosovës është përfaqësuar nga tri studio ligjore: një studio ligjore nga Austria, një studio ligjore nga Kosova dhe një studio ligjore nga Bullgaria.

Kërkesat e shprehura financiarisht nga paditësit janë: në variantin e parë, 53 milionë e 178 mijë euro, në rast se mbyllet veprimtaria, përkatësisht puna e paditësit. Varianti i dytë, nëse vazhdohet veprimtaria ose puna e paditësit, kërkesa financiare është 47 milionë e 909 mijë euro. Si në variantin e parë dhe në variantin e dytë, varësisht se cila palë fiton, do të thotë janë paraparë shpenzimet ligjore në shumë prej 1 milion e 397 mijë e 934, 97 euro dhe shpenzimet administrative të ICC-së, përkatësisht kësaj ode, në vlerë prej 712 mijë dollarë, plus 8% interes.

Rasti i tretë, rasti i “ACP, AXOS Capital GMBH” në procesin e privatizimit të PTK-së. Padia e “AXOS”-it mban datën 22 prill 2015, ndërsa i referohet privatizimit të 75% të aksioneve të Postë-Telekomit të Kosovës, i cili privatizim ka filluar me tenderin për këtë privatizim në muajin korrik të vitit 2012 dhe ka vazhduar më tutje sipas procedurave ligjore. Mund të them se ajo që ka qenë kompetencë e Qeverisë, përkatësisht e ministrive përkatëse të Republikës së Kosovës, për të siguruar një mbrojtje profesionale është ndërmarrë.

Jemi përkujdesur që të zgjedhim një kompani të njohur dhe të specializuar në këtë fushë, duke reduktuar maksimalisht edhe shpenzimet për përfaqësim në arbitrazh. Të dhënat lidhur me kontratën janë në faqen zyrtare të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, duke qenë se nga kompania “AXOS” është përdorur si argument debati i atëhershëm në Kuvendin e Republikës së Kosovës, për të provuar pretendimet e saj dhe për ta arsyetuar lartësinë e shumës që kërkon si dëm, dhe kjo shumë që kërkon si dëm kompania është 280 milionë euro, jam i detyruar të kërkoj

prapë mirëkuptimin tuaj që kjo çështje të mos trajtohet në debat, por që ju, secili veç e veç, mund të keni qasje ose në grupe ose si të doni, në ministrinë përkatëse ose në Kryeministri, në mënyrë që të keni qasje në dokumentacionin që e kemi ne atje.

Ajo çfarë unë mund të them se më datën 23 dhjetor 2016 kompania “Patenbox” nga SHBA-ja, e cila është përzgjedhur për përfaqësim pranë arbitrazhit, do ta dorëzojë përgjigjen lidhur me padinë e “AXOS”-it, me të cilën do të sfidohet juridiksioni dhe merita e kësaj padie.

Si Qeveri do të sigurohem që të kemi një grup mbikëqyrës të punës së përfaqësuesit të Republikës së Kosovës dhe po ashtu do t’ju mbajmë të informuar për çdo gjë që nuk ecën, por do të ruajmë prapë konfidencialitetin e procedurës sipas kërkesës së palëve, në mënyrë që të mos e dëmtojmë interesin e Republikës së Kosovës në fazën e zhvillimit të procesit të arbitrazhit.

Dëshiroj të nënvizoj se ky është një problem vërtet i trashëguar, pretendimet janë sa të rënda, aq edhe të padrejta, jo se jemi të bindur se e drejta duhet të fitojë dhe të provohet, por se jemi të bindur se “AXOS”-i nuk është i dëmtuar në këtë rast dhe nuk ka pasur asnjë dëm dhe se procedurat janë zhvilluar në mënyrë plotësisht ligjore dhe në mënyrë të pandikueshme, por është çështje të cilën e lëmë që ta vendosë arbitrazhi, meqenëse ka hyrë në procedurën e arbitrazhit. Prandaj, pa dashur të flas këtu për shumën, për të cilat flitet, për të cilat pretendojnë palët, unë nuk konsideroj në asnjë rast se shumën që pretendojnë palët janë shumën të arsyeshme, se ne rrezikohemi me këto shumën. Natyrisht, palët gjithmonë duan që të japin shumën të mëdha për të fituar diçka, mirëpo në këtë rast, unë mendoj plotësisht se ne duhet të përcjellim këtë proces, t’i japim mbështetjen tonë firmës e cila do të mbrojë interesat e Kosovës, veçmas tek “AXOS”-i dhe të lëmë që procesi të zhvillohet në mënyrë të pandikuar dhe në një proces krejtësisht ligjor, ashtu siç e rregullojnë ligjet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryeministër. Radha është e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Fjalën e ka, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, zoti Ymeri. A do dikush të diskutojë? Atëherë, pasi që s’ka të interesuar për diskutime, zonja Kadriu, a dëshironi ta thoni fjalën tuaj dhe pas jush prapë e ka të drejtën kryeministri dhe ministrja, në qoftë se dëshirojnë të flasin.

MARGARITA KADRIU: Uaaa! Të nderuar kolegë deputetë, jeni të paparë! Po e ngre zërin, jeni me të vërtetë të paparë!

Të flitet për rrezikun që po i kanoset buxhetit të Republikës së Kosovës, buxhetit të qytetarëve dhe të injorohet, kushtimisht, kaq shumë, unë nuk kam çka të komentoj. Mendoj që komentin ua lë njerëzve që u kanë votuar, asgjë më shumë. S’e shihni të arsyeshme, hiç mos flisni.

Unë, në bazë të Rregullores së Kuvendit, më së pari, para se ta përmend Rregulloren e Kuvendit, dua ta falënderoj kryeministrin edhe ministren që kanë gjetur kohë të japin shpjegimet e detajuara rreth të tri rasteve dhe që flet për transparencë, ky është për mua një hap shumë i qëlluar. Sërish ju falënderoj.

Ndërkaq, po qe se dikush s'ka të shtojë ose të flasë, unë e kam obligim që në bazë të nenit 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe neni 6.1 të Rregullores së Punës së Kuvendit të propozoj në seancën e sotme që t'i miratojmë këto rekomandime. Po i lexoj në vijim:

- Qeveria e Republikës së Kosovës të kërkojë nga Prokuroria që menjëherë të fillojë hetimin për të verifikuar nëse zyrtarët e përfshirë në këto procedura të prokurimit kanë vepruar në përputhje me ligjin dhe për këtë të njoftojë Kuvendin.

- Qeveria e Republikës së Kosovës të ndërmarrë të gjitha veprimet për të siguruar një mbrojtje profesionale pranë arbitrazhit dhe Kuvendin ta njoftojë për emrat e kompanive dhe shumatat konkrete që do t'u paguhen.

Nëse jeni dakord, shefat e grupeve parlamentare që jeni prezentë këtu, atëherë këtë mund ta bëjmë edhe me shkrim dhe ta hedhim në votim. Nëse nuk jeni dakord, mund ta thoni edhe se s'jeni dakord, është e drejtë juaja ekskluzive, mirëpo konsideroj që kjo duhet, ky i ashtuquajtur debat, që s'është debat fare, me informacionet së paku, që i morëm nga kryeministri, që të konkludojmë me së paku këto dy rekomandime. Nëse dikush ka rekomandime shtesë, i mirëpres. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Jo, tash... s'keni dashur të paraqiteni. Jo, veç Qeveria, në qoftë se dëshiron të thotë prapë diçka... jo, është kryer. Faleminderit! Kuorum për t'i votuar propozimet e zonjës Kadriu nuk ka. Në qoftë se mendoni që duhet të thoni diçka sa u përket propozimeve, unë jam dakord, nuk ka ndonjë problem, por mendoj se si çështje është mirë që është hapur. Kryeministri ka bërë raportimin e tij mjaft mirë dhe mjaft qartë. Zonja Kadriu i ka dhënë propozimet dhe ne i kemi parasysh dhe konsideroj që seanca e sotme ka përfunduar, është mbyllur. Dhe, seancën e ardhshme Kryesia do ta thërrasë prapë. Mirupafshim!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*